

**Katalog i**  
**Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës**



## Contents

<b>Part 1. Informacion i përgjithshëm</b>	5
1. Kalendari akademik	6
2. Informacion i Përgjithshëm	7
3. Hyrje	8
4. Roli dhe Misioni	9
5. Politika dhe procedura akademike	11
6. Politika Te tjera Akademike	17
7. Libraria e Universitetit	26
<b>Part 2. Fakultetet dhe Programet</b>	27
Chapter 1. Informacion i përgjithshëm	29
1. Departamentet	29
2. Diplomat	30
Chapter 2. Fakulteti i Shkencave Teknike	31
1. Kërkesa të përgjithshme	31
2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë Elektrike	31
3. Departamenti i Matematikës	36
4. Departamenti i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale	40
5. Departamenti i Navigacionit	45
6. Departamenti i Fizikës	49
7. Departamenti i Bio-Kimisë	49
Chapter 3. Fakulteti i Shkencave Shoqerore dhe Edukimit	53
1. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	53
2. Departamenti i Gjuhëve të Huaja	56
3. Departamenti i Edukimit	61
Chapter 4. Fakulteti i Ekonomisë dhe Drejtësisë	67
1. Departamenti i Administrim Biznesit	67
2. Departamenti i Turizmit	70
3. Departamenti i Drejtësisë	72
Chapter 5. Fakulteti i Shendet Publik	75
1. Stafi Akademik	75
2. Infermieri	76
3. Infermieri-Mami	78
<b>Part 3. Përshkrimet e lëndëve</b>	81

Chapter 6. Fakulteti i Shkencave Teknike	83
1. Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë Elektrike (01)	83
2. Departamenti i Matematikës (02)	89
3. Departamenti i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale (03)	91
4. Departamenti i Navigacionit (04)	98
5. Departamenti i Fizikës	101
6. Departamenti i Bio-Kimisë	101
Chapter 7. Fakulteti i Shkencave Shoqerore dhe Edukimit	105
1. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	105
2. Departamenti i Histori-Gjeografise	107
3. Departamenti i Edukimit	107
4. Departamenti i Gjuhëve të Huaja	109
Chapter 8. Fakulteti i Ekonomise dhe Drejtësisë	115
1. Departamenti i Administrim Biznesit	115
2. Departamenti i Turizmit	119
3. Departamenti i Drejtësisë	125
Chapter 9. Fakulteti i Shendetit Publik	131

Part 1

Informacion i përgjithshëm

## 1. Kalendar i akademik

Universiteti i Vlorës  
Kalendar i Akademik 2008-2009

### Vjeshtë 2008 (29 Shtator - 20 Janar)

Mësimi fillont	8:00, e Hënë	29 Shtator
Dita e parë e pushimevee	Martë	çfarëdo date
Provimet fillojnë	7:00, e Martë	15 Janar
Provimet përfundojnë	17:00, e Martë	20 Janar

### Dimër 2009 (2 Shkurt - 30 Maj)

Mësimi fillont	8:00, e Hënë	2 Shkurt
Dita e parë e pushimevee	Martë	çfarëdo date
Provimet fillojnë	7:00, e Martë	15 Janar
Provimet përfundojnë	17:00, e Martë	20 Janar

### Verë I, 2009 (1 Qershor - ??)

Mësimi fillont	8:00, e Hënë	29 Shtator
Dita e parë e pushimevee	Martë	çfarëdo date
Provimet fillojnë	7:00, e Martë	15 Janar
Provimet përfundojnë	17:00, e Martë	20 Janar

### Verë II, 2009 (30 Korrik - ??)

Mësimi fillont	8:00, e Hënë	29 Shtator
Dita e parë e pushimevee	Martë	çfarëdo date
Provimet fillojnë	7:00, e Martë	15 Janar
Provimet përfundojnë	17:00, e Martë	20 Janar

### Verë III, 2009 (1 Qershor - 30 Gusht)

Mësimi fillont	8:00, e Hënë	29 Shtator
Dita e parë e pushimevee	Martë	çfarëdo date
Provimet fillojnë	7:00, e Martë	15 Janar
Provimet përfundojnë	17:00, e Martë	20 Janar

## **2. Informacion i Përgjithshëm**

Më poshtë gjendet informacion në lidhje me disa nga zyrat e UV.

Zyra e Këshillimit Akademik

Zyra:

Telefoni:

Zyra e Burimeve Këshillimore

Zyra:

Telefoni:

Zyra e Mjeshtërive Akademike

Zyra:

Telefoni:

Dekani i Studentëve

Zyra:

Telefoni:

Komisioni i Vlerësimit të Sjelljes Akademike

Zyra:

Telefoni:

Komisioni i Vlerësimit të Pozitës Akademike dhe Titujve të Nderit

Zyra:

Telefoni:

Komisioni i Ripranimit

Zyra:

Telefoni:

### 3. Hyrje

Universiteti i Vlorës është universitet publik dhe i njohur në shkallë kombëtare, i cili u ofron studentëve një arsimim personal, me cilësi të lartë dhe kosto të ulët, përmes kombinimesh të shumëllojshme të studimeve vetjake, mësimdhënies profesionale dhe përvojës kulturore e sociale. I njohur si një nga universitetet kryesore të Shqipërisë, Universiteti i Vlorës u ofron 15,000 studentëve të tij mundësi për të marrë pjesë drejtpërdrejt në projekte kërkimore të drejtuara nga profesorë ekspertë, të cilët sjellin njohuritë më të freskëta nga terreni drejt e në klasë. Në të gjitha aktivitetet e tij, Universiteti i Vlorës synon të jetë shembull drejtimi në arsim. Duke pasur në qendër një program të fortë shkencash dhe inxhinierie, Universiteti është i organizuar në Fakultetin e Shkencave Teknike, Fakultetin e Ekonomisë dhe Drejtësisë, Fakultetin e Edukimit dhe Shkollën e Infermierisë. Stafi pedagogjik efektiv i Universitetit ka një rekord mbresëlënës të punës kërkimore dhe akademike. Studimet në fushën e shkencave të fizikës dhe të shkencave kompjuterike tërheqin vëmendjen kombëtare dhe ndërkombëtare drejt Universitetit të Vlorës. Shumë të mirënjohura janë Seria e Konferencave të Vlorës [Vlora Conference Series] dhe Gazeta Shqiptare e Matematikës [Albanian Journal of Mathematics], të cilat vazhdimisht sjellin një numër të madh vizitorësh ndërkombëtarë në Vlorë. Universiteti krenohet me shumicën e librave dhe artikujve shkencorë të shkruar nga anëtarët e fakultetit, si dhe me kontributet e tij në pedagogji dhe në artet krijuese. Studentët universitarë në Universitetin e Vlorës përfshihen në projekte kërkimore të nivelit të lartë dhe rezultatet e hulumtimeve dhe të studimeve të tyre integrohen në kurset përkatëse. Një proporcion i lartë përtej të zakonshmes i të diplomuarve të Universitetit të Vlorës kanë vazhduar më tej studimet e tyre duke fituar grada shkencore pasuniversitare e të tjerë tituj e merita nëpër fushat e tyre. Përveç programeve akademike, Universiteti i Vlorës bashkëpunon në mënyrë aktive me industrinë dhe biznesin me qëllim që të nxisë zhvillimin ekonomik dhe të arrijë standartet e një arsimi të nivelit të lartë, sipas kërkesave të tregut të punës në Ballkanin jugperëndimor. Universiteti ruan karakteristika të theksuara të mësimdhënies cilësore akademike, duke krijuar një ambjent dinamik me në qendër studentin, si dhe duke integruar studimin e lirë e profesional të studentit me përkushtimin e anëtarëve të stafit akademik. Vlora vetë ofron një eksperiencë të veçantë jo vetëm në studimet universitare, por ajo karakterizohet edhe nga programe të forta pasuniversitare dhe nga arritje të dukshme në punën kërkimore. Vlora përqëndrohet në bashkëveprimin me komunitetet e ndryshme për zhvillimin e partneritetit, për zgjerimin e programeve të veta të punës kërkimore, si dhe për sigurimin e mundësive për praktikë pune për të çuar më lart standartin e arritjeve profesionale. I lokalizuar në Gjirin e Vlorës, Universiteti i Vlorës mund të arrihet lehtë nga miliona njerëz që vijnë në Vlorë çdo vit për të vizituar qytetin. Qyteti i Vlorës është destinacioni kryesor turistik i Shqipërisë dhe mirëpret miliona vizitorë çdo vit. Marrëdhëniet e Universitetit të Vlorës me komunitetet e qytetit e pasuron mjaft jetën studentore. Përmes përpjekjeve për partneritet me qytetin e Vlorës dhe me të tjera komunitete përfaqëse, ekzistojnë shumë mundësi për praktikë profesionale, si dhe ulje çmimesh për blerje mallrash nga shumë tregtarë në dispozicion të studentëve, të diplomuarve dhe stafit të UV. Bukurisë natyrore të Gjirit të Vlorës, pjesa më e madhe e të cilit është ende e mbuluar me pyje dhe e pashfrytëzuar, i shtohen komplekse të gjera për çlodhje dhe pushim, si dhe një numër ndërtesash moderne, në të cilat zhvillohen programet e shumta të aktiviteteve akademike dhe



të shërbimeve publike të universitetit. Ngjitur me kampusin e universitetit ndodhet Parku Teknologjik i Vlorës, një vend ku kërkimet shkencore zhvillohen krahas krahas me arsimin e lartë të qytetit.

#### 4. Roli dhe Misioni

Përcaktimi i mëposhtëm i rolit dhe misionit të universitetit është përshtatur nga Senati i Universitetit të Vlorës në 2008. Në të theksohen katër përbërësit thelbësorë për drejtimin e universitetit:

- mësimdhënie e shkëlqyer dhe koherente; - punë kërkimore bazë dhe e aplikuar, si dhe punë akademike të cilësisë së lartë; - shërbime të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet; - si dhe programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh për zhvillimin e studentëve.

Si institucion i arsimit të lartë i mbështetur nga shteti, Universiteti i Vlorës ka një mision të dyfishtë:

- " Ai ofron programe mësimore të cilësisë më të lartë që kulminojnë në diplomat e nivelit universitar, të nivelit master dhe doktoratura, si edhe programe të tjera kualifikimesh profesionale;
- "Ai e çon përpara njohurinë dhe shkencën përmes punës kërkimore, punës akademike dhe aktivitetit kreativ.

Në të gjitha aktivitetet e tij, Universiteti synon të jetë shembull drejtimi në arsim.

**4.1. Mësimdhënia.** Universiteti i Vlorës ofron programe rigorozë edukimi. Kurrikulumi përmban një thelb të fortë të bazuar në shkencat dhe artet e lira; mbi këtë bazë studentët tanë universitarë zhvillojnë mjeshhtëritë, njohuritë, dhe aftësitë e duhura për të bërë një jetë aktive dhe të suksesshme si edhe për të qënë qytetarë të mirë. Një shumëllojshmëri profilizimesh dhe kurrikulash të specializuara i përgatisin studentët për arsim pasuniversitar, për shkolla profesionale, ose për karriera menjëherë pas diplomimit. Çdo program ofron një shumëllojshmëri kursesh dhe eksperiencash kurrikulare që sigurojnë një jetë më të pasur, së bashku me një përgatitje të shkëlqyer për karrierën. Universiteti ofron programe të nivelit master që përmbushin nevojat më thelbësore të qytetarëve shqiptarë dhe që njëkohësisht mbajnë lart shkëlqyeshmërinë e tyre. Programet e doktoraturës që ofrohen këtu janë programe që sjellin risi në fushat përkatëse dhe që u shërbejnë nevojave të paplotësuara me të tjera vende në Shqipëri. Universiteti i Vlorës është përzgjedhës në standartet e tij të pranimit dhe synon si studentët tradicionalë po ashtu edhe ata jotradicionalë, duke u siguruar mundësi të barabarta të gjithë atyre që mund të përfitojnë prej programeve të tij. Një përpjekje e veçantë është bërë për të lokalizuar dhe për të pranuar studentë me disavantazhe por që kanë një potencial të fortë për sukses akademik dhe për t'u siguruar atyre mbështetjen që do të çojë në realizimin e atij potenciali. Anëtarët e fakultetit dhe stafi bashkëpunojnë me fakultetet e tjera për të bërë të mundur që studentët e tyre, të cilët kërkojnë të transferohen në Universitetin e Vlorës, të jenë të përgatitur mirë për të vazhduar studimet në një gradë më të lartë. Në pranimin dhe regjistrimin e studentëve, kuotat nuk lejohen të tejkalojnë numrat e caktuar, me qëllim që të ruhet cilësia e lartë e

mësimdhënies. Universiteti synon të qëndrojë i përshtatur dhe i informuar përmes një programi të posaçëm kualifikimi në vazhdimësi të anëtarëve të fakultetit, si dhe eksplorimit të programeve të reja mësimore, metodave dhe skemave kurrikulare, të cilat janë të hartuara sipas nevojave të shumëllojshme të studentëve të tij, shumë prej të cilëve udhëtojnë për të ardhur në shkollë, punojnë, ose janë në moshë më të madhe se mosha tradicionale e një studenti universitar. Universiteti i Vlorës ofron dhe do të vazhdojë të ofrojë vetëm ato programe për të cilat burimet e duhura dhe anëtarë të përgatitur mirë të fakultetit janë në dispozicion, si edhe për të cilat ekziston një nevojë e dukshme dhe një potencial për studentë të kualifikuar.

**4.2. Puna kërkimore dhe akademike.** Universiteti i Vlorës i ka vënë vetes qëllim të çojë përpara njohurinë përmes hulumtimeve shkencore dhe punës akademike të anëtarëve të tij të fakultetit dhe të studentëve. Misioni i punës kërkimore dhe akademike të Universitetit gjen shprehje në një shumëlloshmëri formash, duke variuar që nga studimet bazë mbi natyrën e gjërave, tek hulumtimet e aplikuar dhe të drejtuara ndaj problemeve të veçanta, e deri tek kontribute në letërsi e në arte. Brenda mundësive të veta, Universiteti siguron mbështetje financiare për punë kërkimore dhe akademike. Njëkohësisht ai është vazhdimisht në kërkim të burimeve të jashtme të mbështetjes. Institucionet e kërkimit shkencor, të financuara kryesisht nga fondet e jashtme, përbëjnë një kontribut të rëndësishëm ndaj këtij misioni. Përveç vlerës së tyre të brendshme, puna kërkimore dhe akademike përfocojnë misionin mësimor të Universitetit. Sa herë që jepet mundësia, studentët përfshihen në projekte kërkimore dhe rezultatet e punës kërkimore dhe akademike integrohen në kurset përkatëse mësimore. Aplikimi i hulumtimeve kërkimore e shkencore ndaj problemeve dhe shqetësimeve të industrisë dhe biznesit të vendit, si dhe ndaj agjencive shkencore, arsimore, qeveritare, shëndetësore dhe të shërbimeve publike shërben gjithashtu për të përforcuar rolin e shërbimit publik të Universitetit.

**4.3. Shërbimi publik.** Universiteti i Vlorës u shërben anëtarëve të tij përmes një filozofie dhe programimi të atyre aspekteve të shërbimeve publike që përputhen me misionin e tij mësimor, kërkimor dhe akademik. Ai bashkëpunon me biznese, njësi qeveritare, grupe komunitare, si dhe të tjera organizata në aspekte të kërkimit shkencor të zhvillimeve teknike dhe të iniciativave për t'u dhënë zgjidhje problemeve të ndryshme, duke u përpjekur ta aplikojë ekspertizën e Universitetit ndaj çështjeve të shoqërisë në përgjithësi ose të rajonit në veçanti, në mënyrë që të përmirësojë më tej cilësinë e jetës, përmes shërbimeve të Universitetit. Ai synon të ruajë shkallën e duhur të fleksibilitetit që i nevojitet për të reaguar me mësimdhënie koherente, me hulumtime dhe të tjera shërbime ndaj nevojave gjithnjë në ndryshim të kohës. Universiteti i vë në dispozicion ambjentet e veta për një shumëllojshmëri aktivitete të agjencive dhe grupeve komunitare qëllimet e të cilave përputhen me misionin e Universitetit. Ai u jep këtyre hyrje në programet e veta dhe në kampus, përsa kohë që qëllimet e tyre janë në përputhje me rolin dhe qëllimin kryesor të institucionit, për pasurimin fizik dhe mendor të qytetarëve të zonës.

**4.4. Zhvillimi i studentit.** Në mbështetje të drejtpërdrejtë të misionit të tij akademik, Universiteti i Vlorës, ofron shërbimet bazë dhe ekpëriencat e duhura për të integruar të mësuarit kognitiv me rritjen personale të studentit si individ në aspektet emocionale, sociale, fizike, kulturore, etike dhe ndërpersonale. Duke vepruar kështu, Universiteti synon të nxisë zhvillimin e atyre aspekteve personale

që kanë vlerë në kontributin e një vendim-marrjeje të informuar dhe të një qytetarie frytdhënëse. Ky objektivi arrihet përmes një shumëllojshmërie iniciativash në kampus, duke përfshirë organizatat studentore, aktivitetet sportive, si edhe të tjera evenimente dhe aktivitete të sponsorizuara. Çelësi i arritjes së këtij objektivi është një i tillë sistem qeverisjeje i cili u lejon studentëve të kenë një rol domethënës në proceset institucionale të vendim-marrjes. Përmes ruajtjes së ekulibrit midis aktiviteteve akademike dhe ekstra-kurrikulare me të tillë mënyrë që ato të plotësojnë njëra-tjetrën, Universiteti i Vlorës u vjen në ndihmë studentëve në ndërgjegjësimin që jeta është një vazhdimësi rritjeje, ndryshimi dhe adaptimi, si dhe i pajis ata me mjeshtritë thelbësore për të arritur maksimumin e potencialit të tyre.

**4.5. Filozofia e Vitit të Parë.** Eksperienca e vitit të parë në Universitetin e Vlorës hedh themelet për suksesin e studentëve duke krijuar një ambjent që nxit rritjen intelektuale dhe e trajton të nxënit si një aktivitet që zgjat për gjithë jetën. UV thekson respektimin e përgjegjësiave personale, këmbënguljes, si dhe përfshirjes në kampus dhe në komunitetin e gjerë. Studentët nxiten për të pasur sjellje etike, për të eksploruar këndvështrime të ndryshme, si dhe për të zhvilluar formimin e përgjithshëm nëpërmjet programesh të forta akademike të pasuruara me aktivitete dhe evenimente.

## 5. Politika dhe procedura akademike

**5.1. Përgjegjësia e studentit.** Studentët duhet të mësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme të Universitetit, si dhe kërkesat specifike të programit në fushën që ata kanë zgjedhur. Studentët janë përgjegjës për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave dhe rregulloreve përkatëse në bazë të diplomave që ata synojnë. Kufizimet në ambjente mësimore dhe në staf pedagogjik bëjnë që disa programe profesionale të vendosin limite në numrin e studentëve të pranuar për studime të mëtejshme. Aty ku të tilla limite ekzistojnë, kriteri kryesor për pranim është paraqitja akademike e studentit në detyrimet e kursit deri në momentin e aplikimit për studime të mëtejshme. Informacion shtesë në lidhje me aplikimet për studime të mëtejshme të programet me limite në kuotat e pranimit mund të gjendet në përshkrimet individuale të lëndëve të përmendura më tej në këtë katalog.

**5.2. Udhëheqja Akademike.** Roli dhe misioni i udhëheqjes profesionale dhe akademike në fakultetet e Universitetit të Vlorës është të këshillojë studentët ndërsa këta të fundit përpiqen të arrijnë qëllime akademike, synime të jetës apo të karrierës, si dhe ndërsa përpilojnë plane për t'i arritur këto synime. Ky është një proces i vazhdueshëm zbulimi, qartësimi dhe vlerësimi, në të cilin udhëheqësit akademikë i ndihmojnë studentët të dallojnë mundësitë e paraqitura, duke vlerësuar alternativat e mundshme, si dhe duke peshuar pasojat e vendimeve të caktuara. Udhëheqësit akademikë të fakultetit janë në dispozicion në çdo departament. Për ndihmë në të kuptuarit e kërkesave të pranimit në programe të caktuara, limiteve në kuotat e pranimit, si dhe të kërkesave të Universitetit dhe të programit të diplomimit, studentët duhet të konsultohen me udhëheqësit akademikë të fakultetit. Ndërsa studentët marrin ndihmë gjatë këshillimit orientues fillestar, ata duhen nxitur që të kërkojnë ndihmë individuale sa më herët që të jetë e mundur në programet e tyre, si dhe që nga ai moment të shkojnë e të takohen rregullisht me udhëheqësit e tyre akademikë. Shumica e udhëheqësve akademikë takohen me studentët në mënyrë individuale nëpër orare të caktuara në marrëveshje me njëri-tjetrin, përveç

periudhave të ngarkuara gjatë fillimit të sezonit të regjistrimeve, në të cilat ndihma e dhënë do të jetë më e kufizuar. Në disa programe studentët duhet të paraqesin një program plani të shkruar. Udhëheqësit akademikë mund t'i ndihmojnë studentët të përpilojnë të tilla plane, si dhe të verifikojnë që të gjitha detyrimet e kursit po shlyhen në kohën e duhur. Studentët mund t'i gjejnë udhëheqësit e tyre akademikë duke konsultuar listën e zyrave të udhëheqjes akademike të çdo shkolle dhe departamenti.

**5.3. Vlerësimi.** Universiteti i Vlorës është i përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të programeve dhe shërbimeve të veta përmes një procesi të pandërprerë vetëvlerësimi të lidhur me hapa konkrete drejt përmirësimit. Shembuj të aktiviteteve më tipike të vlerësimit përfshijnë pyetësorë, para dhe post-teste, fokus grupe dhe intervista. Studentët pritet që të marrin pjesë në aktivitetet vlerësuese në lidhje me shërbimet e ndryshme akademike dhe shërbimet në ndihmë të studentëve, si gjatë kohës kur ata janë studentë, po ashtu edhe më vonë pas diplomimit të tyre nga programet e Universitetit të Vlorës.

**5.4. Vlerësimi i marrjes së dijeve të studentëve.** Universiteti i Vlorës është i përkushtuar ndaj përmirësimit të cilësisë së të gjitha programeve të tij të diplomimit. Një mënyrë në të cilën realizohet kjo është përmes vlerësimit të vazhdueshëm të marrjes së dijeve të studentit. Të gjitha programet e diplomimit kanë një strukturë të posaçme synimesh dhe objektivash të cilat studentët duhet të arrijnë në përfundim të programit. Përcaktimi deri në ç'masë studentët po i arrijnë objektivat e programit të tyre kryhet përmes aktiviteteve vlerësimi të zhvilluara përgjatë gjithë vitit akademik. Rezultatet e aktiviteteve të vlerësimit përdoren për të përmirësuar programet dhe për të bërë ndryshime në kurrikula në mënyrë që të maksimizohet marrja e dijeve nga ana e studentit. Rezultatet e vlerësimeve shërbejnë për të informuar departamentet deri në ç'masë kurrikulumi i tyre aktual (kurset, kushtet për diplomim, si dhe të tjera aktivitete të ofruara nga programi) i pajis studentët me mjetet e nevojshme për të pasur sukses në profilin e tyre.

Vlerësimi shërben gjithashtu edhe për të matur aftësinë e kurseve të Formimit të Përgjithshëm dhe të aktiviteteve të tjera për t'i dhënë studentit një shumëllojshmëri të gjerë njohurish të përgjithshme dhe mjeshtërisht të domosdoshme për sukses në çdo karrierë gjatë gjithë jetës. Aktivitetet e ndryshme të vlerësimit i lejojnë gjithashtu programet që të përcaktojnë e të krahasojnë cilësinë e programeve të tyre nga viti në vit, si dhe të masin suksesin e ndryshimeve kurrikulare që hartohen për të përmirësuar cilësinë e programit. Rezultatet e vlerësimit përdoren edhe për të identifikuar nevojat e programit, si dhe për të mbështetur kërkesa për burime shtesë. Studenti do të marrë pjesë herë pas here në aktivitete vlerësimi si pjesë e kërkesave të programit të diplomimit. Disa aktivitete vlerësimi mund të përfshijnë: pyetësorë për studentët, provime, vlerësime detyrash e projektesh kursi, intervista hyrjeje dhe daljeje, si dhe dosje të punës së studentit gjatë programit të diplomimit. Aktivitetet që zhvillohen janë të ndryshme për çdo program diplomimi, pasi secili program ka një strukturë të veçantë synimesh e objektivash. Këto aktivitete janë hartuar në mënyrë që të masin arritjen e objektivave të programit në mënyrën më të mirë të mundshme.

**5.5. Sistemi i Kurseve dhe i Krediteve.** Vlera në kredite për çdo kurs (numri në kllapa që pason titullin e kursit) përcaktohet në orë semestrale. Një orë semestrale është e barazvlefshme me një total prej 50 minutash mësimdhënieje të

programuar për çdo javë plus kohën e kërkuar për përgatitje të pavarur jashtë klase. Shumica e kurseve në Universitetin e Vlorës kanë 8 kredite. Me lejen e udhëheqësit të tyre akademik, studentët universitarë që kanë plotësuar 30 apo më shumë kredite në Universitetin e Vlorës mund të regjistrohen për kurse deri në 45 kredite, nëse totali i mesatares së notave (grade point average) është të paktën 2.60. Të gjithë studentët e tjerë mund të marrin më shumë se 36 kredite vetëm me aprovimin e Kërkesës për Rast të Veçantë. Edhe për më shumë se 42 kredite studenti duhet të ketë aprovimin e Sekretarisë. Studentët që janë të ardhur nga jashtë apo të ftuar në fakultet duhet të kenë gjithashtu aprovimin e Sekretarisë.

**5.6. Pozita e Studentit.** Për qëllime regjistrimi dhe pagesash të tarifave, pozita e studentit përcaktohet në bazë të këtij numri të krediteve: studentit quhet në pozicion sekondar (në vitin e dytë) nëse ka plotësuar 57 kredite, në pozicion kadet (një vit përpara vitit përfundimtar) nëse ka plotësuar 110 kredite, dhe në pozicion superior (në vitin e fundit të studimeve) nëse ka plotësuar 110 a më shumë kredite.

**5.7. Rregulla në lidhje me kurset.** Kurset janë të organizuar si më poshtë:

1. Një sekuencë kursi e bashkuar me vizë (Psh: FRH 114-115) duhet të merret sipas renditjes së përcaktuar. Kursi i parë në çdo sekuencë të tillë është prerekuiziti për të dytin.

2. Numrat e kurseve të cilat ndahen me presje (Psh: HST 114, 115) tregojnë kurse të lidhura me njëri tjetrin të cilat mund të merren në çfarëdo rendi. Gjithësesi, ndonjëherë kërkesat e departamentit apo të programit kërkojnë një renditje të përcaktuar të tyre.

3. Numrat e kurseve 000-049 janë përcaktuar për kurse të zhvillimit të mjeshtërive, të cilët janë të hartuar për t'u ardhur në ndihmë veçanërisht studentëve me mangësi të konsiderueshme në parapërgatitjen e tyre akademike; këto kurse i përgatisin ata për kurset 100 e lart. Kreditet e fituara në të tilla kurse nuk mund të përdoren për të përmbushur kërkesat minimale për diplomim në ndonjërin prej programeve akademike. Notat e fituara në këto kurse, megjithatë, përfshihen në mesataren e notave të studentit. Numrat e kurseve 050-099 janë për kurset e hartuara veçanërisht për të pasuruar mjeshtëritë akademike. Jo më shumë se 60 kredite të fituara në kurset me numër 050-099 llogariten për të përmbushur kërkesat e diplomimit. Kurset me numra 100-299 janë kurse universitare hyrëse kryesisht për studentë të vitit të parë dhe të dytë.

4. Kurset me numra 200-499 janë të hartuara për studentë që janë në një vit përpara përfundimit të diplomës dhe në vitin e fundit të diplomimit. Kurset me numër 500 e lart janë kryesisht për studentë pasuniversitarë. Studentët e nivelit universitarë që kualifikohen mund të regjistrohen në një kurs me numër 500-599 vetëm me kusht që të kenë marrë një leje me shkrim për të bërë këtë nga përgjegjësi i departamentit dhe pedagogu i lëndës. Vetëm studentët pasuniversitarë janë në gjendje të përzgjedhin kurset me numër 600 e lart.

5. Universiteti rezervon të drejtën për ta anuluar një kurs në të cilin ka regjistrime të pamjaftueshme.

6. Kurset prerekuizite duhet të plotësohen përpara regjistrimit në kurset për të cilat ato kërkohen. Kurse korekuizite duhet të merren njëkohësisht. Është përgjegjësia e studentit të plotësojë të gjitha kushtet prerekuizite përpara se të regjistrohet për një kurs që ka të tilla kërkesa dhe të regjistrohet për kurset prerekuizite sipas udhëzimeve të katalogut. Departamentet mund të vendosin të mos i marrin parasysh kurset prerekuizite, duke iu përmbajtur politikave të njësisë akademike.

7. Disa kurse janë të ndërthurur (dmth. mbulojnë të njëjtin material) midis departamenteve. Në raste të tilla përshkrimi i kursit ndodhet vetëm tek njëri departament. Shënimi mbi këtë kurs në departamentin tjetër tregon se ky kurs është identik me kursin në departamentin e mëparshëm. Kur të regjistrohen, studentët duhet të zgjedhin kursin tek programi në të cilin ata dëshirojnë të marrin kredite për diplomim.

**5.8. Kompetencat e Kursit.** . Studentët mund të marrin kredite për diplomim të përcaktuara si kredite për kompetencë (të klasifikuar si S/U) në listën e notave të tyre për kurset e Universitetit të Vlorës me kusht që të plotësojnë udhëzimet e mëposhtme:

1. Që ata të regjistrohen për kursin me lejen e shkruar të përgjegjësit të departamentit, dekanit, apo drejtorit të programit për njësinë akademike që është përgjegjëse për kursin.

2. Që ata të kalojnë një provim të përshtatshëm për vlerësim kompetence jo më shuume se gjashtë javë pas fillimit të semestrit. Kreditet për kompetencë nuk do të lejohen për një kurs kur një student ka marrë kredite për kurse më të avancuara në të njëjtën fushë.

3. Rregulli për përsëritje të kursit, aplikohet edhe për përsëritjen e provimeve për kompetencë (Shih Përsëritja e Kurseve). Kompetenca me anë të provimit në gjuhë të tjera përveç atyre të ofruara në Universitetin e Vlorës është e mundur.

4. Që ata të paguajnë tarifat e përcaktuara në këtë katalog (Shih Kompetencat e Kursit sipas tarifës së provimit).

Studentët mund të aplikojnë për deri në 120 kredite duke u bazuar në eksperiencë jashtë klase (Shih Kompetenca të Kursit, Vendosija e Avancuar dhe/ose kreditet CLEP) për një program diplomimi. Studentët që synojnë diploma të dyta janë të kufizuar deri në 30 kredite për eksperiencë jashtë klase.

**5.9. Përshtatja e Kurseve.** (Të lësh dhe të shtosh një kurs) Nëse studentët vendosin të lënë një kurs, ata mund ta lënë kursin pa penalizim akademik deri në javën e nëntë për kurset me kohëzgjatje 14 javë dhe deri në javën e pestë për kurset me kohëzgjatje shtatë javë. Shënimi me gërmën "W" që nënkupton tërheqje

(withdrawal) do të bëhet për kurset e lëna pas javës së dytë në semestrat e zakonshëm dhe pas javës së parë në semestrin e verës. Kurset e lëna për rimbursim të tarifës duhet të procedohen gjatë periudhave të publikuara të imbursimit (Shih edhe Imbursimi i Tarifës së mësimdhënies dhe pagesave të tjera). Nëse kursi lihet në ose pas datës së lejuar zyrtare të tërheqjes mund të rezultojë në regjistrimin e një note 0.0 në rregjistrin e studentit. Mundësitë për tërheqjet nga kursi janë të specifikuara në orarin mësimor për çdo semestër. Studentët që janë rregjistruar më parë për semestrin dhe që dëshirojnë të shtojnë një kurs duhet ta bëjnë këtë sa më herët të jetë e mundur gjatë semestrit apo sezonit. Kurset nuk mund të shtohen pasi kalon dita e dhjetë duke filluar nga dita e parë e mësimave (Dita e pestë për semestrin e verës dhe për kurset gjysmë-semestrale me dy kredite). Afatet për të lënë apo për të shtuar kurse janë të publikuara në faqen Web të zyrës së sekretarisë për çdo semestër.

**5.10. Auditimi i Kurseve.** Një opsion formal auditimi është në dispozicion të studentëve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në një kurs jo me qëllim marrje diplome. Me leje të shkruar nga pedagogu i lëndës, studentët mund të regjistrohen për të audituar një kurs gjatë periudhës së vonë të regjistrimit për secilin semestër apo sezon. Formularët për auditimin të kurseve mund të gjenden tek Zyra e Pranimeve dhe Orientimit, Zyra e Studimit Pasuniversitar dhe e Regjistrimit. Regjistrimet për auditim janë të organizuara në bazë të rregullave të mëposhtme:

1. Tarifat e zakoshme dhe pagesa për shkollim aplikohen për të gjitha kurset.
2. Sekretaria do të vendosë shenjën përfundimtare Z për të gjitha auditimet formale. Nëse një student paguan tarifën e shkollimit për kredite të rregullta, ai nuk mund të kalojë në auditim për atë kurs.
3. Ndryshimet në regjistrim nga kurse krediti në kurse auditimi apo nga kurse auditimi në kurse krediti nuk do të lejohen që nga momenti kur periudha e heqjes apo e shtimit të një kursi për një semestër të dhënë (dy javë pas fillimit) apo për një sezon (një javë pas fillimit) ka përfunduar.
4. Studentët që dëshirojnë të auditojnë kurset duhet së pari të jenë pranuar në Universitet nga Zyra e Pranimeve dhe Orientimit.
5. Studentët për të cilët i gjithë regjistrimi për një semestër apo sezon konsiston në auditime formale duhen të regjistrohen gjatë periudhës së vonë të regjistrimeve. Tarifat shtesë për regjistrime të vona do të anulohen për këta studentë.

**5.11. Përsëritja e Kurseve.** Studentët mund të përsërisin një kurs për të përmirësuar notën e fituar në një regjistrim të mëparshëm, por ata duhet ta bëjnë këtë në Universitetin e Vlorës. Kufiri është tre përsëritje për secilin kurs duke mos përfshirë lëniet apo tërheqjet nga kurset. Përsëritja e kursit duhet bërë duke u bazuar në të njëjtin sistem vlerësimi (Sistemi Numerik ose Sistemi kalim/ngelje) që ka pasur herën e parën kur është rregjistruar. Për shkak se disa programe kanë limite më të kufizuara, studentët duhen të konkludohen me një udhëheqës akademik përpara se të regjistrohen për të përsëritur një kurs. Studentët duhet të jenë në

dijeni që **nota më e fundit do të jetë nota përfundimtare e cila do të hidhet në rregjistër, pavarësisht nëse kjo është nota më e lartë apo jo.** Studentët, programet e të cilëve lejojnë që kurset të përsëriten në institucione të tjera, nuk do të marrin transferim kreditesh nëse kreditet e Universitetit të Vlorës janë fituar, dhe as do të kenë mundësinë të përmirësojnë mesataren e tyre të marrë nga Universiteti i Vlorës. Studentët duhen të konsultohen me një udhëheqës akademik në programin kryesor përpara se të përsërisin kursin diku tjetër. Transkriptet (lista e notave) nga Universiteti i Vlorës do të reflektojnë notat e marra në të gjitha kurset e Universitetit të Vlorës. Për kurse të përsëritura, përpjekjet e përjashtuara nga mesatarja e përgjithshme do të shënohen me gërmën "E". Dhe nota e vleshme do të shënohet me gërmën "I" për të treguar përfshirjen e kësaj të fundit në mesataren e përgjithshme të notave. Studentët e transferuar, të cilët kanë ardhur me kredite të transferuara për një kurs të caktuar, nëse e përsërisin këtë kurs me sukses në Universitetin e Vlorës, do t'i humbasin kreditet e mëparshme që i kishin të transferuara nga institucioni tjetër. Nuk jepen kredite për më shumë se një kurs i cili mbulon një përmbajtje specifike, gjë që do të thotë se shumica e kurseve mund të merren vetëm një herë. Disa kurse, megjithatë, të cilët paraqesin në mënyrë të përgjithshme tema të veçanta apo studime të pavarura, janë hartuar që të variojnë nga semestri në semestër. Katalogu Universitar përcakton limitin e aplikueshëm të krediteve për të tilla kurse.

**5.12. Detyrime për Diplomim.** Detyrimet për diplomë Universitare janë dy llojesh: Detyrime të përgjithshme për diplomim, të cilat përcaktohen nga Universiteti dhe janë të detyrueshme në të gjitha programet e Diplomës së Nivelit të Parë; si dhe detyrime specifike për diplomim të cilat vendosen nga njësitë e ndryshme akademike që ofrojnë këto programe. Studentët mund të zgjedhin që të përmbushin detyrimet për diplomim ashtu siç paraqiten në çdo katalog që është në fuqi që nga momenti i regjistrimit të tyre në Universitetin e Vlorës, me kusht që ky katalog të mos jetë më i vjetër se gjashtë vjet më parë në kohën e diplomimit. Studentët mund t'u referohen gjithashtu edhe katalogëve të veçantë për të parë detyrimet e përgjithshme dhe specifike me kusht që t'u nënshtrohen kufizimeve të përshkruara më poshtë. Një njësi akademike mund të kërkojë që studentët të cilët ndryshojnë profil dhe vijnë në programet e tyre nga një tjetër profil, ose kanë një status të pavendosur, janë detyruar të ndjekin edhe detyrimet e profilit dhe fakultetit edhe detyrimet e shkollës (nëse është e zbatueshme), të cilat ndodhen në katalogun që është në fuqi në kohën e ndryshimit. (Ndryshimi nga pozita e para - profilizimit në pozitën e profilizimit në të njëjtën fushë nuk përbën ndryshim profil). Katalogu i përzgjedhur për profilin e studentit do të përdoret gjithashtu për të përcaktuar detyrimet për çdo profil dytësor apo përqëndrim që studenti mund të synojë, përveç rastit kur një plan studimi i shkruar është aprovuar nga departamenti apo shkolla që e ofron atë program. Disa njësi akademike kërkojnë që studentët të dorëzojnë një plan të aprovuar studimi për një përqëndrim apo profil dytësor në mënyrë që të plotësojnë detyrimet e programit; ata që veprojnë në këtë mënyrë e përcaktojnë këtë detyrim në seksionin e posaçëm të këtij katalogu. Formularët për planifikim dhe aprovim të një profili dytësor apo përqëndrim janë në dispozicion tek zyrat e udhëheqjes akademike. Nëse njësi akademike nuk përcakton të tilla detyrime, studentët kanë përsëri të drejtën të diskutojnë për një profil dytësor apo përqëndrim të shkruar me koordinatoren e programit. Planet e shkruara janë të domosdoshme sidomos për ata studentë që përdorin kurse të transferuara për të



përmbushur ndonjë pjesë të programit. Një plan studimi mund të bazohet në çdo katalog në fuqi në kohën e dorëzimit por jo në një katalog që e pengon regjistrimin e studentit në Universitetin e Vlorës. Ndryshimet për një plan të aprovuar kërkojnë më parë autorizim me shkrim nga koordinatori i përqëndrimit apo profilit detyësor. Studentët mund të marrin kredite nga një kurs për të përmbushur detyrimet e diplomimit duke fituar një notë kaluese në atë kurse, duke kaluar një provim për kompetencë, ose duke marrë kredite të transferuara nga një institucion tjetër. Në disa rrethana një detyrim mund të anulohet në mënyrë formale me anë të aprovimit të një peticioni për rast të veçantë (Shih Peticion për Rast të Veçantë më poshtë). Të gjitha të dhënat në këtë katalog e reflektojnë informacionin ashtu siç ky informacion ofrohet në datën e publikimit. Universiteti i Vlorës rezervon të drejtën për të rishikuar të gjitha lajmërimet që përfshihen në këtë publikim dhe për të bërë të gjitha ndryshimet e arsyeshme nën detyrimet për diplomim, me qëllim për të përmirësuar apo për të çuar në një nivel më lartë programet akademike dhe joakademike.

## 6. Politika Te tjera Akademike

**6.1. Titujt e Nderit.** Në fund të çdo semestri vjeshte dhe dimri, studentët universitarë që kanë fituar një mesatare (GPA) të semestrit prej 3.00 apo më shumë në të paktën 12 kredite të punës universitare të vlerësuar me notën numerike dhe të cilët nuk kanë marrë notë 0.0, do të dallohen për arritje akademike. Këto kredite duhet të fitohen brenda limiteve të kohës së semestrit normal. Studentëve universitarë me mesatare GPA nga 3.00 deri në 3.59 do t'u lëshohen fleta lavdërimi. Studentëve universitarë me mesatare GPA nga 3.60 deri në 4.00 do t'u lëshohet fletë akademike nderi. Si fleta e lavdërimi ashtu dhe fleta akademike e nderit do të regjistrohet në transkriptet akademike (listën e notave) të studentit.

**Lista e Dekanit** Në fund të çdo semestri dimri studentët që marrin fletë akademike nderi (3.60-4.00) në semestra konsektivë vjeshtë/dimër dhe kanë plotësuar 12 kredite për çdo semestër do të vendosën në Listën e Dekanit. Përfshirja në Listën e Dekanit për një vit akademik do të regjistrohet në transkriptet akademike të studentit. Emrat e studentëve të vendosura në Listën e Dekanit, përveç atyre që kanë kërkuar privaci, do të publikohen në nj listë zyrtare dhe do të afishohen në kampus. Studentët do të marrin gjithashtu letra nga dekani i caktuar. Fletë Nderi nga departamenti ose shkolla. Fleta e Nderit nga departamenti ose shkolla mund t'u lëshohet studentëve të përzgjedhur atëherë kur u jepen diplomat. Kriteret për të fituar këta tituj nderi janë të përshkruar në seksionin përkatës të Katalogut të Studimeve Unviersitare. Fleta e Nderit nga departamenti dhe shkolla regjistrohet ne transkriptet e studentit.

**Titujt e Nderit nga Universiteti** Tre nivelet e titujve të nderit nga Univer-siteti:

**cum laude,**  
**magna cum laude,**  
**summa cum laude,**

mund të lëshohen sëbashku me diplomën universitare të fituar nga studenti, në bazë të mesatares së përgjithshme të notave si më poshtë:

- 3.60-3.74, cum laude;
- 3.75-3.89, magna cum laude; and
- 3.90-4.00, summa cum laude.

Lëshimi i një diplome me tituj nderi nga Universiteti do të bazohet veëtm në kreditet e Universitetit të Vlorës dhe studenti duhet të fitojë të paktën 62 kredite në Universitetin e Vlorës në mënyrë që të jetë i zgjedhshëm për të tillë tituj nderi.

**6.2. Politika e sjelljes akademike.** Të gjithë anëtarët e komunitetit akademik në Universitetin e Vlorës duhet të praktikojnë dhe të ruajnë standartet e integritetit akademik dhe ndershmërisë. Integritet akademik do të thotë të paraqesësh vet veten dhe punën tënde me ndershmëri. Prezantimi i keq i vetvetes dhe punës është mashtrim sepse do të thotë që studentët pretendojnë kredite për ide apo punë që nuk janë në të vërtetë vepër e tyre dhe në këtë mënyrë kërkojnë një diplomë që në të vërtetë nuk është fituar. Më poshtë janë disa shembuj pandershmërie akademike:

1. Mashtrim në provime. Këtu përfshihen të përdorësh materiale si libra dhe/ose shënime atëherë kur një gjë e tillë nuk është e autorizuar nga pedagogu, të kopjosh nga testimi apo detyra e dikujt tjetër, të ndihmosh dikë tjetër të kopjojë punën, të zëvendësosh punën e dikujt tjetër me punën tënde, të vjedhësh kopje të provimeve, ose të tjera forma shkeljesh në sjelljeje gjatë provimeve.

2. Plagjiaturë e punës së të tjerëve. Plagjiaturë do të thotë të përdorësh punën ose idetë e dikujt tjetër pa i dhënë atij personi kredit për punën e vet; duke bërë këtë studentët pretendojnë kredit për mendimin e dikujt tjetër. Studentët duhet të dokumentojnë gjithmonë burimin e informacionit qoftë atëherë kur e kanë lexuar edhe atëherë kur e kanë dëgjuar. Kur punohet me burime të shkruara, një dallim i qartë duhet bërë midis thonjzave (të cilat riprodhojnë informacionin fjalë për fjalë nga burimi dhe e vendosin atë midis thonjzave) dhe perifrazimeve (të cilat e përpunojnë burimin e informacionit dhe e paraqesin atë me fjalët e studentit. Qoftë citimet midis thonjzave, qoftë perifrazimet duhen të dokumentohen në çdo rast. Edhe në rastin kur studentët rishprehin, përmbledhin apo përzgjedhin pjesë nga puna e tjetrit, idetë i përkasin në çdo rast personit tjetër, dhe mosdhënia kredit punës së tij përbën prezantim të keq të punës aktuale të studentit dhe plagjiaturë e ideve të dikujt tjetër. Të blesh një detyrë kursi ose të përdorësh informacion nga Rrjeti Ndërkombëtar i Informacionit ose Interneti pa njohur burimin dhe ta dorëzosh atë si punë vetjake është plagjiaturë.

3. Mashtrim në raporte laborator duke fallsifikuar të dhëna apo duke dorëzuar të dhëna të pabazuara në punën vetjake të studentit është shkelje.

4. Fallsifikimi i dokumentave apo paraqitja dizinformuese e kredencialeve të një personi është shkelje.

5. Bashkëpunimi i paautorizuar në detyra kompjuterike dhe hyrje e paautorizuar dhe përdorimi i programeve kompjuterike duke përrshirë modifikimin e faileve

kompjuterikë të krijuar nga të tjerë dhe të paraqesësh atë punë si punën tënde është shkelje. Me përjashtim të rasteve kur japin udhëzime specifike, në të gjitha rastet pedagogët presin prej studentëve punë individuale pa ndihmën e të tjerëve në detyra kursi, provime, raporte laboratorit dhe ushtrime kompjuterike, si dhe dokumentacion të të gjitha burimeve në rastet kur këto vihen në përdorim. Nëse pedagogët caktojnë një projekt të veçantë përveç ose si shtesë ndaj provimeve, si për shembull detyrë kursi e bazuar në punë kërkimore, apo ese origjinale ose referatë e një libri, ata kanë përcaktuar që kjo punë është përmbushur vetëm për atë kurs. Studentët nuk duhet të dorëzojnë punën e kryer në një kurs që është marrë në të kaluarën apo për një kurs bashkëekzistues, përveç rasteve kur studenti ka leje të qartë për të bërë kështu nga të dy anëtarët e fakultetit që janë pedagogë të kurseve.

Pedagogët duhet të mbajnë standartet e mëposhtme në kontekstine sjelljes akademike:

1. Të informojnë dhe të udhëzojnë studentët mbi procedurat dhe standartet e punës kërkimore, si dhe mbi dokumentacionin e kërkuar për të kryer detyra në një kurs të caktuar apo në kontekstin e një disipline të caktuar.
2. Të ndërmarrin hapa konkretë për të dalluar dhe parandaluar mashtrimin.
3. Të raportojnë sjelljen akademike të dyshuar si të keqe tek Dekani i Studentëve për t'u konsideruar nga Komisioni i Sjelljes Akademike të Senatit të Universitetit.
4. Të paraqesin evidencë të plagjiaturës, të mashtrimit në provime apo raporte laboratorit, të fallsifikimeve të dokumentave apo të tjera forma sjelljeje të keqe akademike përpara Komisionit të Sjelljes Akademike.

Studentët duhet të mbajnë standardet e mëposhtme në kontekstin e sjelljes akademike:

1. Të jenë në dijeni të praktikave dhe standardeve të shkollimit të ndershëm.
2. Të ndjekin udhëzimet e pedagogëve në lidhje me provimet dhe detyrat në mënyrë që të evitojnë një paraqitje të keqe të punës.
3. Të jenë të sigurt që rregulla të veçanta në lidhje me dokumentimin e detyrave të kursit, të procedurave të provimit, të përdorimit të informacioneve e programeve kompjuterike, etj., janë kuptuar qartë.
4. Të evitojnë aparencën e mashtrimit (të lënit përshtypje sikur po mashtrojnë). Nëse studentët janë të bindur që praktikat e përdorura nga pedagogu janë të favorshme ndaj mashtrimit, ata mund t'ia përcjellin këtë mesazh pedagogut, përgjegjësit të departamentit, ose një anëtar të Komisionit të Sjelljes Akademike, student/pedagog (ose drejtpërsëdrejti, ose me anë të Zyrës së Dekanit të Studentëve). Nëse Komisioni i Sjelljes Akademike vendos se është vënë re sjellje e keqe akademike, atëherë Komisioni caktton ndëshkimin, i cili mund të variojë nga vërejtje disiplinore, stazh, pezullim të përkohshëm e deri në përjashtim (pushim nga puna) nga Universiteti. Përveç kësaj notat e tërhequra mund të ndryshohen në notën e

duhur numerike. Të gjitha dokumentacionet konfidenciale mbi sjelljen ruhen në Zyrën e Dekanit të Studentëve.

### **6.3. Stazhi akademik dhe përjashtimi. Informacion i përgjithshëm.**

Për të ruajtur një pozitë të mirë akademike, studentët nuk duhet të lejojnë që mesatarja e tyre e përgjithshme e notave (GPA) të bjerë nën 2.00. Disa shkolla dhe departamente përcaktojnë kritere më selektive për performancë të kënaqshme akademike brenda profileve të tyre. Studentët duhet të konsultojnë seksionin e katalogut ku flitet për profilin e tyre në mënyrë që të marrin informacion më specifik. Studentët universitarë të cilët nuk arrijnë të bëjnë progres të kënaqshëm akademik drejt një diplome do të vendosen në stazh akademik në përputhje me një nga politikat e Universitetit e cila përcakton se studentët duhet të kompletojnë me kredite shumicën e kurseve për të cilët ata regjistrohen dhe duhet ta bëjnë këtë në një shkallë të arsyeshme kompetence akademike. Studentët në stazh të cilët nuk arrijnë të përmbushin standardin minimal të progresit, siç është përcaktuar nga Senati i Universitetit, do të përjashtohen nga Universiteti. Studentët universitarë, të cilët janë përjashtuar për progres të pamjaftueshëm akademik, nuk i gëzojnë privilegjet e studentëve në pozitë të mirë akademike. Nëse studentët e përjashtuar dëshirojnë të ripranohen në Universitetin e Vlorës pas periudhës së detyruar të shkëputjes të përshkruar nga Komisioni i Pozitës Akademike dhe i Titujve të Nderit, ata duhet të aplikojnë për ripranim përmes Zyrës së Dokumentacionit Akademik. Pyetje në lidhje me politikat e Universitetit të Vlorës mbi stazhin dhe përjashtimin duhen drejtuar tek Qendra e Mjeshtërive Akademike.

**Parime dhe Praktika** Politika e Përjashtimit dhe e Stazhit Akademik administrohet nga drejtori i Qendrës së Mjeshtërive Akademike për Komisionin e Pozitës Akademike dhe Titujve të Nderit të Senatit të Universitetit. Politika bazohet në parimet dhe praktikat e mëposhtme:

1. Pjesa më e madhe të shpenzimeve të studentit për shkollim sigurohet nga qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe është përgjegjësia e Universitetit të përkujdeset që këto fonde të përdoren në mënyrën e duhur. Në rast se studentët nuk arrijnë të bëjnë progres të kënaqshëm akademik drejt një diplome, vendime për përjashtim duhet të merren nga Komisioni i Pozitës Akademike dhe e Titujve të Nderit.

2. Studentët duhet të marrin vendime me përgjegjësi për sa u përket progresit të tyre edukativ. Studentët, të cilët nuk po përfitojnë në masën e duhur nga mundësitë që u vihen në dispozicion në Universitet këshillohen që të konsiderojnë të tjera alternativa.

3. Disa studentë të cilët janë të rinj në Universitet (përfshirë studentët e transferuar) kanë nevojë për një periudhë ambjentimi, si rrjedhim asnjë student nuk do të përjashtohet në fund të semestrit/sezoni të parë në Universitet. Përveç kësaj, studentët nuk do të përjashtohen pa qënë më parë të vendosur në stazh në semestrin/sezoni e mëparshëm.

4. Studentët duhet të kenë një mesatare GPA 2.00 në momentine diplomimit. Studentët me më pak se 81 kredite për diplomim dhe me një GPA nën 2.00 normalisht janë të lejuar të vazhdojnë studimet e tyre në stazh, në rast se është e arsyeshme të pritët se ata mund ta rrisin në mënyrë të mjaftueshme mesataren e tyre të përgjithshme GPA. (Shih Politikën e Stazhit dhe të Përrjashtimit).

5. Studentët që marrin lajmërim për përjashtim pas një semestri këshillohen që të bëjnë apel për përjashtimin në rast se janë të bindur se kanë arsye të vleshme për t'iu anuluar përjashtimin. Komisioni i Pozicionit Akademik dhe i Titujve të Nderit i Senatit të Fakultetit do të rishikojë apelet e paraqitura brenda një afati prej dhjetë ditësh kalendarike dhe studentët do të lajmërohen në lidhje me vendimin e komisionit me anë të postës.

**6.4. Politika e Stazhit dhe Përrjashtimit.** Politika e mëposhtme e Stazhit Akademik me Përrjashtimit aplikohet për të gjithë studentët universitarë dhe për ata të cilët synojnë një diplomë të dytë.

1. Studentët me një mesatare të përgjithshme GPA nga 2.00 e lart, ose që kanë një mesatare të përgjithshme GPA të papërcaktuar konsiderohen në pozitë të mirë akademike. (Shih pikën 4 më poshtë).

2. Studentët në pozitë të mirë akademike do të vendosen në stazh në fund të semestrit/ sezonit atëherë kur meatarja e përgjithshme GPA e tyre është nën 2.00. Ata do të lejohen të qëndrojnë në Universitetin e Vlorës në gjendje stazhi për të paktën një semestër/ sezon.

3. Në fund të semestrit/sezonit studentët:

a. do të rikthehen në pozitë të mirë akademike në rast se mesatarja e përgjithshme GPA e tyre është nga 2.00 e lart,

b. do të vazhdojnë në stazh në rast se kanë tentuar të paktën 48 kredite dhe mesatarja e tyre GPA është nga 2.00 e lart, edhe pse ata mund të mos jenë në gjendje të plotësojnë detyrimet minimale në tabelën e mëposhtme, ose

**MAT 265 Metodike Matematike:** Konceptet kryesore te didaktikes, dokumentacioni shkollor, program mesimor, Plani mesimor, tekstet e matematikes ne C.U. Metodat kryesore t emesimdhënies se matematikes; Format e pergatitjes ditore te mesuesit; Faktet kryesore te mbledhjes dhe veprimeve te tjera aritmetike; Problemat matematike, tipet, metodat e zgjidhjes; Standartet e permbajtjes se matematies ne C.U. Standartet e arritjeve te programit te matematikes ne C.U. Sistemi i matjes dhe vleresimit te arritjeve te nxenesve ne formimin matematike.

**MAT 275 Algjebra Lineare:** Studimi i hapësirave te pergjithshme vektoriale, sistemeve lineare te ekuacioneve, transformimeve dhe kompozimeve lineare, eigenvalues, eigenvectors, diagonalizimi, modet dhe ortogonaliteti. Siguron nje kalim ne matematiken formale. Lende paraprake: MAT 154.

**MAT 290 Topologji:** Topologjia e drejtezes dhe planit. Hapesirat topologjike dhe funksionet e vazhdueshme. Hapesirat metrike, topologjia ne hapësirat metrike. Hapesirat kompakte, kompaktesia sipas B Arel-Lebegut. Kompaktet ne hapësirat metrike.

**MAT 433 Metodot Numerike:** Shtimi i gabimeve, parafrimi dhe interpolimi, integrimi numerik, metodat per zgjidhjen e ekuacioneve, metodat Runge - Kutta dhe supozim - korrjimit. Lende paraprake MAT 275, MAT 155, MAT 250.

**MAT 462 Strukturat Gjeometrike:** Nje studim i temave nga gjeometria Euklidiane, gjeometria projektive, gjeometria jo- Euklidiane dhe gjeometria e transformimeve. Ofrohet cdo semester dimri.

**MAT 472 Teoria e Numrave me Kriptografine:** Struktura e numrave te plote, faktORIZIMET prime kongruencat ( ngjashmerite ), funksionet prodhuese, rrenjet primitive dhe dyanshmeria kuadratike, aplikimet e zgjedhura duke perfshire kriptografine. Lende paraprake MAT 155 .

**MAT 475 Algjebra Abstrakte:** Grupet, nengrupet, homeomorfizmat, unazat dhe idealet; fushat sferat, dhe shtrirja e fushave. Aplikimet. Ofrohet cdo semester dimri.

### 3. Departamenti i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale (03)

**ME 211 Mekanike Inxhinierike 2:** Lënda "Mekanikë Inxhinierike 2" studion esencialisht kinematikën e pikës materiale dhe trupit të ngurtë, d.m.th. gjeometrinë e lëvizjes dhe parametrat e saj: pozicionin, shpejtësinë dhe nxitimin, në tre tipe koordinatash: karteziante, trajektoriale dhe cilindrike; dinamikën e pikës materiale dhe trupit të ngurtë, d.m.th. sjelljen e trupit të ngurtë në lëvizje nën veprimin e sistemeve të forcave dhe momenteve mekanike sipas këndvështrimit të Ligjit të dytë të Njutonit, metodave energjitike dhe të impuls-momentit. Një vend i posaçëm i kushtohet lëvizjes satelitore, si aplikim i ligjit të dytë të Njutonit dhe metodave të impuls-momentit në koordinata cilindrike, ekuacioneve të Euler-it, si bazë e studimit të lëvizjes hapësinore, dhe mekanikës vibracionale, si rast specifik i dinamikës së pikës materiale nën efektin e forcave që ndryshojnë harmonikisht me kohën.

**ME 212 Shkenca E Konstruksioneve:** Mekanika e trupit të deformueshem: sforcimet/deformimet, klasifikimi i sjelljes së materialeve, përgjithësimi i ligjit të Hukut. Aplikimet inxhinierike: ngarkesat aksiale, relacionet sforcim/deformim në 2D dhe 3D, përdredhja, përdredhja e shufrave dhe tubave rrethor, teoria e perkuljes për trarë, perkulja dhe sforcimet preresë në trarë, deformimi i trarëve, transformimet e sforcim/deformimeve, hyrje në lodhje, diagramat Smith dhe Hajg, hyrje në teorinë e pllakave dhe membranave, perkulja e pllakave të holla, detyrë kurse.

**ME 213 Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve:** Teknologjia e proceseve të shkrirjes gëzës dhe çelikut. Metodat e prodhimit të detaleve. Metalurgjia e lidhjeve dhe metaleve me ngjyra. Teoria e deformimit plastik. Praktika e përpunimit plastik të metaleve. Teknologjia e cilindrimit. Procesi i presimit. Procesi i telëzimit. Procesi i farkëtim-stampimit. Struktura kristalore e metaleve, parametrat, strukturat më të përhapura në metale. Termodinamika dhe kinetika e kristalizimit të metaleve. Mikroskopia. Dilatometria. Diffractometria. Bazat e përpunimit termik të metaleve. Praktika e përpunimit termik. Pjekja. Normalizimi. Kalitja. Riardhja. Përpunimet kimiko-termike. Përpunimet termike sipërfaqësore. Përpunimi termik i metaleve me ngjyra.

**ME 215 Fizike Teknike:** Konceptet baze të termodinamikës. Gazet reale. Ndryshimet fazore të substancave. Ligji i parë dhe i dytë i termodinamikës. Sistemet e hapur dhe të mbyllur. Konsideratat baze në analizen e proceseve dhe të cikleve. Rritja e efektivitetit të cikleve. Frigoriferet dhe makinat e fuqisë. Termodinamika dhe transmetimi i nxehtësisë. Transmetimi i nxehtësisë me përcjellshmëri, konveksion, rrezatim dhe në forme të përgjithshme. Llojet e këmbësve të nxehtësisë. Koeficienti i transmetimit të nxehtësisë. Analiza e këmbësve të nxehtësisë.

**ME 216 Mekanike Fluidesh:** Mekanika e fluideve studion ligjet themelore të ekuilibrit dhe të lëvizjes së lëngjeve në përgjithësi. Ligjet e Njutonit, për grimcën me masë dhe të ruajtjes së masës (ligji i vazhdueshmërisë dhe ai i ruajtjes së energjisë) të cilët formojnë bazën e mekanikës së lëngjeve, ashtu sikundër veprojnë edhe në mekanikën e trupit të ngurtë. Mekanika e lëngjeve të kohës së sotme së pari bazohet në kombinimin e drejtë të analizës fizike themelore dhe të një rëndësie të vecantë për zgjidhjen e problemeve që merren në studim. Mekanika e lëngjeve të kohës së sotme së pari bazohet në kombinimin e drejtë të analizës fizike dhe provave laboratorike dhe së dyti jep mundësi të mesohen ekuacionet fizike themelore të cilët janë të një rëndësie të vecantë për zgjidhjen e problemeve që merren në studim. Mekanika e fluideve, ka gjithashtu të bëjë me

percaktimin e bazes teorike nga studimet inxhinierike navale, te perdorimit te saj si shkence me modelimet hidraulike me projektimin dhe ndertimin e veprave te industrise, bujqesise, vendburimeve te naftes, transportit ne pergjithesi dhe lundrimet e detarise ne vecanti.

**ME 223 Mekanika e Aplikuar ne Makina:** Njohuri per makinën dhe çiftin, ekuacionet kryesore të dinamikës, teorema e lëvizjes së qendrës së gravitetit, teorema e energjisë kinetike. Sistemet e reduktuara dhe ato ekuivalente. Fuqia, rendimenti si dhe rezistenca e një makine. Ç'është grupi? Kushtet e regjimit, shkalla e çrregullsisë së periodës. Përcaktimi i momentit të inercisë dhe i masës së një volani. Dimensionimi i një volani. Karakteristikat mekanike të një makine. Rregullimi dhe grada statike, rregullatorët centrifugal dhe ekuacionet karakteristike të tyre. Ekuacionet kryesore në formë matricore dhe matrica e rotullimit. Çbilancimi statik dhe dinamik i një rotorit. Forca dhe çifti kinematik për shkak të çbilancimit. Efektet e çbilancimit, shpejtësia kritike. Lëkundjet e sistemit me një gradë lirie, lëkundjet e lira. Lëkundjet e sistemit me një gradë lirie dhe me shuarësperiodik dhe joperiodik. Lëkundjet e detyruara që shuhen. Ekuacionet e lëkundjes, paraqitja vektoriale, koeficienti i përforcimit dinamik. Lëkundjet e sistemit me shumë gradë lirie. Studimi i lëkundjes periodike përkulëse të boshteve të makinave. Boshti me një masë të përqëndruar dhe me  $n$ -masa të përqëndruara. Metoda Dunklerley për përcaktimin e frekencave vetjake të lëkundjes. Lëkundjet përdredhëse të një boshti makine.

**ME 224 Makina:** Cikli i punës së motorit alternativ. Organet kryesore të motoreve. Ciklet real të punës së motorëve. Diagramat e presioneve. Diagrama e presioneve. Parametrat dhe përmasat kryesore të motorëve. Bilanci termik. Fuqitë e motorit. Presionet e mesme të trupit të punës. Rendimentet. Konsumet specifike. Ndikimi i ciklit të punës në parametrat e motorit. Bilanci termik i motorit. Karakteristikat e punës së motorit. Forcat dhe momentet gjatë punës. Balancimi terorik dhe real. Kërkesat që shtrohen përpara tij. Kërkesat teknike dhe parametrat kryesor të motorit. Karakteristikat kryesore të ndërtimit të motorit Koka e motorit. Kushinetat e boshtit motorik. Elementet puthitës. Vibrimet e motorit.

**ME 250 Bazat e Inxhinierise Termike:** Parimet e termodinamikes klasike dhe transmetimit te nxehtesise, ligji i pare dhe i dyte i termodinamikes, parametrat termodinamike dhe marredheniet midis tyre, aplikimet ne proceset dhe sistemet inxhinierike, kushti i gjendjes se qendrueshme dhe kalimtare te trupave, relacionet e transmetimit te nxehtesise me konveksion.

**ME 308 Vizatimi me Ndhimen e Kompjuterit:** Perdorimi i software inxhinierike ne projektim dhe ne analiza te tilla si: GDT, modilimi i elementeve te nje makine si trupa solide, percaktimi i pamjeve ne hapësirën e letres, njohurite baze ne projektimin parametrik, vizatimi permbledhes i nje nyje apo makine, vizatimi i siperfaqeve, percaktimi dhe krijimi i materialeve, projektimi i strukturve, hyrje ne metoden e elementeve te fundem, optimizimi inxhinierik, analizimi i hapsires dhe zbulimi i carjes, permbledhje te mekanikes dhe kinematikes, menaxhim projekti.

**ME 322 Mekanika inxhinierike:** Statika dhe dinamika e pikes materiale dhe trupave te ngurte: analiza e kapriatave, frame, traret, centroidet dhe momentet e inercise; kinematika, ligji II i Newton, puna dhe enregjia, momentet lineare dhe kendore. Me laboratore.

**ME 331 Hyrje ne transportimin e energjise termike dhe fluidike:** Principet kryesore te mekanikes se fluideve dhe te transmetimit te nxehtesise, principet e ruajtjes dhe transformimit te energjise, rryma viskoze dhe jovicke, rryma laminare dhe turbulente, hyrje ne teorine e shtresave kufitare termike dhe viskoze, karakteristikat e transmetimit te nxehtesise me perciellshmeri nje dimensionale dhe koeficientet pa permase te tranmetimit te nxehtesise me konveksion, aplikime ne problemet inxhinierike.

**ME 361 Mekanika e Materialeve:** Hyrje ne mekaniken e trupave te deformueshem: shperndarja e sforcim/ deformimeve ne trare, boshte, kollona, mjetet nen presion dhe elemente te tjere strukturor, koeficienti i sigurise, kriteri i rrjedhshmerise dhe i thyerjes se materialeve dhe aplikime te tyre ne projektim. Laboratore qe perfshijne projektimin me kompjuter te sistemeve dy- dimensional me elemente shufra dhe trare. Ofrohet ne vjeshte, dimer.

**ME 372 Teknologjia e Materialeve:** Struktura e ngurta kristalore, molekulare dhe atomike, analizat me reze x e lidhjeve midis tyre, metalografia dhe metodat e tjera te studimit te strukturave kryesore, lidhjet midis struktures dhe vetive elektrike, magnetike dhe mekanike te trupave te ngurte. Lenda realizohet me laboratore dhe vrojtime duke zoteruar njohuri te domosdoshme nga fizika dhe kimia.

**ME 398 Projekti Final:** Nje projekt kerkimor i cili punohet per nje kohe te gjate. Temat duhet te aprovohen para regjistrimit. Studentet duhet te punojne ne grup,jo me pak se dy veta.

**ME 456 Analiza dhe Projektimi i Sistemeve Energjitike, 9:**

**ME 421 Vibrimet dhe Kontrolltet:** Kunderpergjigja e sistemit me nje dhe disa grade lirie, lineare, te lire dhe te detyrurara. Ekuacioni i levizjes i sistemeve diskrete. Izolimi i vibrimit, ç'balancimi rrotullues dhe absorbuesit e vibrimit. Funkzioni i transferimit dhe metodat e modelimit te sistemeve dinamike state-space. Analiza e domainit te kohes dhe frekuences dhe projektimi i sistemeve te kontrollit. Perdorimi i MATLAB.

**ME 482 Projektimi i Sistemeve Termike dhe Fluidike:** Studimi i sistemeve duke perfshire fenomenet termike dhe fluidike te tilla si shnderrimi i energjise, transportimi i energjise termike dhe fluidike. Analiza e sistemeve dhe komponenteve te tij me qellim optimizimin e projektit duke perdorur teknikat e modelimit te parametrave variabel integral dhe diferencial. Kursi fokusohet ne proceset projektuese duke perdorur prova laboratorike.

**ME 486 Projektimi i Sistemeve Mekanike:** Studimi i sistemeve duke perfshire elementet mekanike. Analiza e tensioneve, fortesise, shmangieve, sigurise. Konsideratat ekonomike dhe sociale. Kriteret e optimizimit dhe metodat. Analiza dhe projektimi i lidhjeve, sustave, saldimit, kushinetave, transmetimi i fuqise dhe elementet perkates. Analiza e strukturave komplekse nen veprimin e ngarke-save statike dhe dinamite. Programi perfshin dhe nje detyre komplekse projektimi.

**ME 487 Aplikimi i kompjuterave ne Inxhinierine Mekanike:** Hyrje ne perdorimin e teknologjise me elemente te fundem ne analizat inxhinierike mekanike. Bazat e grafikes kompjuterike, modelimit te trupave solide, modelimit me elemente te fundem, dhe vizatimit nderperserites. Analiza dhe vleresimi sitemeve mekanike lineare statike dhe dinamike. Ketu permbahen: Perdorimi i CATIA

ne aspekte te ndryshme te proceseve prodhuese. Analiza GDT dhe tolerancat, vizatimi i siperfaqeve, pikat karakteristike te objekteve ne vizatim, simulimi i kinematikes se instrumentave te makines, punimi i siperfaqeve ne makina 3 aksiale, instrumentat e vizatimit, analiza CMM dhe e te dhenave te matura, analiza strukturale dhe simulimi i nje montimi, dhe projekttime/vizatime te ndryshme.

**NE 210 Hidrostatike dhe Stabiliteti i Anijes:** Kushte të ekuilibrit.Kushte të ngarkimit.Diagramat e stabilitetit.Ndikimi i bordit të lirë dhe gjerësise në diagramat e qëndrueshmërisë.Efekti i sipërfaqeve të lëngëshme dhe ngarkesave të vecanta në diagramat e qëndrueshmërisë.Spostimi dhe ngarkimi i peshave,efekti mbi diagramen e qëndrueshmërisë.Qëndrueshmëria simbas teorisë së qëndrave të zonës.Qëndrueshmëria në lëvizjen valore.Kritere të qëndrueshmërisë.Kontrolle(IMO).Prova e qëndrueshmërisë. Efekti i çarjes mbi qëndrueshmërinë.Shtrirja e çarjes dhe numri i paratijeve interesuese.Llogaritjet për ndarjen në dhomezat të anijes.Gjatësia e lagshme.Përcaktimi i planit të WL të ekuilibrit me çarje të ndodhur.Metoda me ngakim peshash dhe me heqje të një pjesë të karenes.Qëndrueshmëria gjatë lagies.Norma për ndarjen në lokale të anijes dhe qëndrueshmëria në rast të çarjes(IMO).

**NE 214 Konstruksion Anije:** Gjeometria e anijes,materialet që përdoren në drejtimin e anijeve,provat e materialeve,klasifikimi;shoqëritë e klasifikimit,shoqëritë e sigurimit,uniformiteti në projektimin strukturorë,qëndresa si bazë e klasës etj,përkufizime dhe detaje strukturore,percaktimi i termave të tjerë të përdorur në ndërimin e anijeve,elementët strukturor,tipet e mjeteve,praktikat në kantierët naval,mirëmbajtja e anijeve,detyrë kursi.

**NE 223 Teori Anije:** Konceptet baze mbi gjeometrine e anijes.Karakteristikat e fluideve.Principet e Arkimedit.Ekuilibri dhe stabiliteti.Te dhenat hidrostatike dhe llogaritja e tyre.Efekti i siperfaqes se lire te lengut dhe i peshave te varura.Diagrama e stabilitetit statik.Stabiliteti gjate leshimit te anijes ne uje,dhe ne kushte te ndryshme lundrimi.Fuqia efektive.Llojet e rezistencave.Momentet dhe forcat ne helika.Karakteristikat e helikes.Analiza e karakteristikave gjate kthimit.Sistemi drejtues,timonat e anijes.Forcat dhe momentet ne timon.Manovrueshmëria e anijes.

**NE 310 Teknologjia E Ndërtimit Të Anijeve:** Teknologjitë e anije ndërtimit.Proceset e prodhimit gjatë ndërtimit të anijeve (shënimi, prerja, deformimi, saldimi i detaleve,seksioneve dhe bllok seksioneve e tjera).Problemet speciale që lidhen në materialet e ndërtimit të anijeve:thyerja e brishtë,lodhja, e tjera.Korrozioni dhe mbrojtja e strukturave detare.Metodat moderne të saldimit dhe klasifikimi i tyre.Proceset fizike gjatë saldimit.Tensionet mbetëse të saldimit.Deformacionet e strukturave të salduara.Defektet e tegeteve të saldimit dhe influenca e tyre në sjelljen e strukturave të salduara.Elementet e kontrollit dhe monitorimit të saldimeve.

**NE 312 Konstruksione Navale 1:** Projektimi strukturorë racional-baze,projektimi paraprak dhe i detajuar,aplikimi në projektimin naval,aplikimi në struktura të tjera,analiza strukturore e strukturave të trupit të anijes dhe offshore,konsiderime mbi ngarkesat dhe materialet,analiza e perkuljes primare të trupit të anijes dhe e seksionit të midelit,sistemet frame,sforcimet sekondare dhe të nivelit të

trete në përbërësit e pllakave të përforcuara, analiza e perkuljes së trupit të anijes për traun joprizmatik, hyrje në teorinë e lodhjes për humbjen e qëndrueshmërisë; gjendjet e kombinuara të sforcimit; lodhja dhe thyerja brittle, detyrë kursi.

**NE313 Impiantet e Levizjes së Anijes 1:** Njohuri të përgjithshme mbi serite e helikave. Shqyrtimi i serive "Frude", "Schaffrau", "Taylor", "Gawn" etj. Studimi i helikave mbas karene, funksionimi i tyre, rryma nominale dhe rryma efektive. Ndikimi i skafit në rendimentin total të helikes. Njohuri të përgjithshme mbi shtytesat e anijes. Rrotat shtytëse dhe gjeometria e tyre. Shtytesit Cikloidale dhe me hedhje uji. Shtytja me anen e helice tipet e tyre. Llogaritja e elikes në funksion të fuqisë së motorit. Elementet gjeometrike të helices. Profili i fletës së helices dhe sipërfaqja e faqes aktive të saj. Konstruksioni i helikave dhe pamja e përgjithshme e helikes. Teknologjia e remontit të elikave dhe plotësimi i dokumentacionit teknik të nevojshëm gjatë riparimit. Teoria e impulsive e funksionimit të helikes dhe teoria e elementit të fletës. Provat me helike të izoluar dhe ndertimi i karakteristikave të funksionimit të helikes. Helika me pike fikse, helika me forçe shtytëse zero, helika e bllokuar. Zgjidhja e problemit të helikes me ndihmën e diagramave Kavitationi i helikave, erozioni kavitativ i helikave. Mbrojtja kundër kavitationit. Përputhja e helikës me instalimet mekanike. Motori. Diagramat e Pampelit.

**NE 320 Konstruksionet Navale:** Projektimi strukturor racional-bazë, analiza strukturore e strukturave të trupit të anijes dhe offshore, konsiderime mbi ngarkesat dhe materialet, analiza e perkuljes primare të trupit të anijes dhe e seksionit të midelit, sistemet frame, sforcimet sekondare dhe të nivelit të trete në përbërësit e pllakave të përforcuara, analiza e perkuljes së trupit të anijes për traun joprizmatik, hyrje në teorinë e lodhjes për humbjen e qëndrueshmërisë; gjendjet e kombinuara të sforcimit; lodhja dhe thyerja brittle. Modelimi strukturor dhe teknikat analizuuese të aplikuara në komponentet strukturor të anijes dhe strukturat detare, regjistrat naval të klasifikimit, pllakat e përforcuara dhe kompozite, gjerësia efektive në pllakat e përforcuara, metodat energjitike, hyrje në analizën me elemente të fundem, analiza plastike e trareve, konsiderimi mbi materialet e përforcuara me fibra xhami dhe konstruktimin e mjeteve të vogla, llogaritje mbi leshimin, aspekte të optimizimit të strukturave, detyrë kursi.

**NE 321 Konstruksione Navale 2:** Modelimi strukturor dhe teknikat analizuuese të aplikuara në komponentet strukturor të anijes dhe strukturat detare, regjistrat naval të klasifikimit, pllakat dhe membranat, strukturat e pllakave të përforcuara, gjerësia efektive në pllakat e përforcuara, perkulja e pllakave, teorite e perkuljes së deformimeve të vogla dhe të mëdha të pllakave, ekuacionet Von Karmen për pllakat, analiza plastike e frames dhe aplikimi në rare dhe pllaka, teknika e elementeve të fundem për traret, frames dhe pllakat, aplikimi i teknikes së elementeve të fundem në problemet trare, pllaka, frame, konsiderimi mbi materialet e përforcuara me fibra xhami dhe konstruktimin e mjeteve të vogla, llogaritje mbi leshimin, aspekte të optimizimit të strukturave, detyrë kursi.

**NE 323 Sistemet Energjetike Detare:** Sistemet e makinave energjitike të anijeve ka për qëllim të njoh studentin me makinat dhe sistemet e prodhimit të energjisë dhe të forcës në anijet që përdoren sot. Ato mund të jenë me motorë me djegie të brendshme të lidhura me gjeneratorët e rrymës së vazhduar ose alternative në vartësi të paisjeve ndihmuese dhe naviguese që përdor anija dhe me gazoturbinë. Për përvetësimin e kësaj lënde, studenti duhet

të marrë njohuri të plota në termoteknikë dhe aparatet e shkëmbimit të nxehtësisë, gjeneratorët e avullit dhe të gazit, motorat me djegie të brendëshme dhe lëndët e shkencave ekzakte dhe elektronike. Makinat energjitike detare. Ballanca termike dhe motorat diezel. Sistemet me motorat diezel. Makinat energjitike me gazoturbinë. Sistemet e makinave G.T.D. Vetitë konstruktive të makinave me G.T.D. Makinat energjitike që përdoren në anijet e shpejta me krahë të nënujshëm (AKN). Sistemi i lëshimit elektrik. Sistemi i drejtimit. Sistemi i rregullimit. Pulti i komandimit. Provat e makinave energjitike.

**NE 324 Praktike:** Njohje me strukturat dhe detyrat e strukturave portuale, me dokumentacionin teknik të një anije dhe me organikat e saj, me strukturat dhe repartet e një kantjeri të riparimit të anijeve. Vëzhgimi i sektorëve kryesorë prodhues të një kantjeri që merret me ndërtimin e anijes, i pllazit të anijes, i punimeve matëse, i procesit teknologjik të përgatitjes të detaleve të trupit, i repartit të montim - saldimeve, i procesit teknologjik të punimeve riparuese në skafin e anijes, i procesit teknologjik të lëshimit të anijes në ujë, i paisjeve mekanike, elektroteknikë dhe të navigimit në një anije konkrete.

**NE 330 Makinat dhe Impjantet e Levizjes ne Anije:** Rrjedhja e trupit të anijes gjatë lëvizjes, shtresa kufitare të trupit të anijes, rrjedhja në sipërfaqet jo të lëmuara, valëformimi gjatë lëvizjes, forcat dhe momentet hidrodinamike, kuptimi dhe përmbajtja e masave të bashkëngjitura. Përbërësit e rezistencës gjatë lëvizjes, ekzistenca e fërkimit dhe përcaktimi i madhësisë së saj, rezistenca e pjesëve të dala, rezistenca e ajrit. Modelimi i anijes, vaskat eksperimentale, teoria e ngjashmërisë, përlogaritja e fuqisë në rimorkim. Gjeometria e helikës, konstruksioni dhe elementët përbërës të saj, karakteristikat dhe bashkveprimi i saj me skafin, shtytja, momenti dhe KPD regjimet e punës, kurbat e veprimt, kavitacioni, projektimi i helikës, kontrolli në kavitim. Mënyrat e transmetimit të fuqisë tek helika, skemat e linjave të aksit, reduktorët kuzhinat mbështetëse dhe shtytëse, tubi i dejtitudit, aksi i helikës dhe akset e ndërmjetëm. Projektimi i helikave.

**NE 340 Hidrodinamika e Anijes:** Hidrodinamika e anijes ka për synim të njoh studentet me bazat klasike të hidrodinamikës navale. Gjithashtu ky program synon që ti jap studentit elementet themelore të ambientit detar, projektimit hidrodinamik të anijes, mjeteve lëvizës të saj, si dhe të efekteve hidrodinamike që veprojnë ndaj anijes gjatë manovrueshmërisë së saj. Tematikat Kryesore të programit janë: Elementet e ambientit detar. Bazat e rezistencës në levizje të anijes. Bazat Hidrodinamike të Teorisë së Levizësve. Bazat e teorisë së drejtimit

**NE 350 Sistemet dhe Mekanizmat e Anijes:** Valvolat, tubacionet. Pompat dhe sistemet e pompimit. Sistemi i drejtimit në anije, timonat. Sistemet e ftohjes. Ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit. Pajisjet e kuvertës, Pajisjet e ngarkimi-shkarkimit të çisternave të naftës dhe të gazit. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri. Sistemet dhe pajisjet e stabilizimit në anije.

**NE 360 Projektim Anije:** "Projektim Anije" synon që ti jap studentit në kursin e diplomit 3 vjeçar në inxhinierinë navale bazat klasike të projektimit naval. Studentet e këtij niveli diplomimi duhet të jenë në gjendje të lexojnë dhe të zëvendësojnë një projekt naval, si dhe të zhvillojnë në vijë të përgjithshme një projekt të ri duke u bazuar në të dhënat e anijeve të ngjajshme ose të serive të mëparshme të anijeve. Tematikat kryesore të programit janë: Metodatat dhe të dhënat e projektimit të anijes, ambientit i kerkesave projektuese Ekuacionet e projektimit. Zhvillimi i projektit mbi bazën e njohjes së peshave, vëllimeve, sipërfaqeve. Llogaritja e



dimensioneve dhe raporteve te ndryshme te anijes.Llogaritja e elementeve te ndryshem qe perbene dislokimin e anijes.Projektimi i vijave teorie te anijes. Llogaritjet e stabilitetit te anijes.Metodat dhe Normativat.Llogaritja e fuqise qe duhet instaluar ne bordin e anijes duke perdorur metoda te ndryshme:Metoda e Taylor,Metoda Ayre'S,Metoda Moor,Metoda Gulddhammer,Metoda Holtrop-Mennen.Zgjedhja e makinerise.Bazat e projektimit te planeve te pergjitheshme

**NE 398 Teze Diplome:** Punim i studentit mbi nje tematike te caktuar te miratuar nga DIMN pa kerkesa per origjinalitet te vecante.

**NE 512 Legjislacioni Detar:** Lënda e Legjislacionit Detar me studentët e vitit V inxhinjeri përfshin një përmbledhje të shkurtër të së drejtës detare ndërkom-bëtare dhe asaj kombëtare, konventave kryesore për detin me karakter teknik, kodeve dhe rezolutave që kanë të bëjnë kryesisht me standardet e projektimit dhe të sigurisë së anijes. Thelbin e lëndës e përbëjnë njohja e kërkesave kryesore të kon-ventave SOLAS 74/78, MARPOL 73/78, STCW 78/95, kodeve dhe rezolutave të fundit të IMO's për çështjet detare si edhe çështjeve të Avarisë së Përgjithëshme dhe asaj te veçantë. Lënda synon pajisjen e studenteve me kulturrën e nevojshme të ligjit të detit.

**NE 514 Projektim Anije 3:** Llogaritjet dhe ndertimi i diagramës së stabilitetit të anijes sipas metodës së ndarjes me dy kategori (bord i lartë, bord i ulët).Llogaritja dhe ndërtimi i diagramës së stabilitetit të anijes sipas metodës Krillov-Darni.Ndërtimi i diagramë së stabilitetit statik të anijes mbi bazën e kurbave të stabilitetit të formës.Ndërtimi dhe llogaritjet e diagramës së stabilitetit dinamik.Ndërtimi i kurbave të lundrueshmërisë mbi bazën e të dhënave të llogaritura në pjesën e parë.Llogaritjet e mosmbythshmërisë së anijes.Mbytja e cdo lokali vecmas.Mbytja e grup lokaleve.Metoda e lokalit ekuivalent.Llogaritjet dhe zgjedhja e e fuqisë së motorrit që duhet instaluar në bord.Llogaritjet e elementeve të helikës optimale.Llogaritjet dhe projektimi i linjës së aksit.Llogaritjet dhe projektimi i pallës së timonit.Llogaritjet dhe ndërtimi i diagramës së ngarkesave,forcave pre-rëse,momenteve përkulëse.Llogaritjet e stacionit elektrik të anijes.Informacione mbi stabilitetin të parashikuar në regjistra të ndryshëm detar.Metodika e llogaritjeve te sistemeve te tubacioneve te anijes.

**NE515 Impiantet e Levizjes se Anijes 2:** Karakteristikat dhe klasifikimi i anijeve. Pjeset perberese te impjantit levizes se anijes Sigurimi i shpejtesise se levizjes se anijes Zgjedhja e tipit, fuqise te motorit kryesor per nje anije ne funksion te rezistencave dhe permasave te anijes Llogaritja e elikave konstruktive dhe e forcave qe veprojne ne te .Llogaritja e elikes ne funksion te fuqise se motorrit. Linjat e aksit te anijeve. Llojet,elementet perberes te tyre,Perdorimi ne skema te ndryshme te impjantit levizes.Llogaritja ne soliditet e linjave te ngarkuar me momentet perdrethes dhe perkules per shpejtesi kritike.Menyrat e centrimt dhe montimit te linjave 10.Llogaritja e ngarkesave dhe tensioneve suplementare.Kuzhinetat mbeshtetese rreshqitese dhe rrokullisese qe perdoren ne transmesionin e levizjes se anijes, llojet,llogaritja . Bazat e projektimit te linjave te aksit. Makinat e forces Llojet,parametrat kryesore,zgjedhja e tyre,shtrirja e tyre ne anije ne bashkim me sistemet per funksionimin e tyre . Vibracionet e anijes si rezultat i punes se imjantit levizes dh amortizimi i tij.

**NE 516 Sigurimi i Anijes:** Parimet e përgjithshme të mosmbythmërisë së anijes. Masat konstruktive dhe organizative për ruajtjen e mosmbythmërisë së anijes. Fenomeni i djegies. Klasifikimi i materialeve sipas temperaturës së ndezjes. Përcaktimi i shkaqeve të rënies së zjarreve në anije. Impiantet dhe mjetet zjarrëfikse. Masat që merren për fikjen e zjarreve. Fikja e zjarreve me anë të ujit, pluhurit, shkumës dhe gazit. Normativat e projektimit dhe të vendosjes së makinave kryesore dhe ndihmëse në anije. Mjetet e shpëtimit. Llojet, karakteristikat konstruktive të tyre. Konventat kryesore ndërkombëtare për detin dhe aspektet që mbulojnë ato. Shoqëritë e klasifikimit dhe të survejimit. Konventa SOLAS 74 -78. normat e sigurisë së anijeve dhe aplikimet e ligjit kombëtar. Metoda e analizës së rreziqeve, evitimi i tyre. Komiteti i sigurimit i IMO-s dhe detyrat e tij. Detyrat e survejorëve dhe organeve portuale. Memorandumi i Parisit për procedurat e kontrollit portual dhe kontrollit shtetëror. Kontrollat e paisjeve të sigurisë së anijes sipas SOLAS. Kontrolli fizik i paisjeve të anijes dhe kontrolli i çertifikatave të tyre. Rregullat e shërbimit në port. Rregullat e shërbimit në lundrim. Rregullat e N.P.P.A.D. -72.

**NE 522 Praktike Profesionale 4:** Njohje me strukturat dhe detyrat e strukturave portuale, me dokumentacionin teknik të një anije dhe me organikat e saj, me strukturat dhe repartet e një kantjeri të riparimit të anijeve. Vëzhgimi i sektorëve kryesorë prodhues të një kantjeri që merret me ndërtimin e anijes, i pllazit të anijes, i punimeve matëse, i procesit teknologjik të përgatitjes të detaleve të trupit, i repartit të montim - saldimeve, i procesit teknologjik të punimeve riparuese në skafin e anijes, i procesit teknologjik të lëshimit të anijes në ujë, i paisjeve mekanike, elektroteknikë dhe të navigimit në një anije konkrete. Montimi i paisjeve dhe mekanizmave të anijes dhe i linjave të akseve të anijes. Riparimi i sistemit boshtor të lëvizjes së anijes. Ndërtimi struktural i instalimit të timonit dhe mënyrat e montimit dhe të riparimit të tyre. Vëzhgimi i provave të dorëzimit të anijes. Përgatitja e anijes për lëshim/ndalim. Mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i instalimit anijor të fuqisë dhe i sistemeve dhe mekanizmave të anijes.

#### 4. Departamenti i Navigacionit (04)

**N211 Siguria E Jetës Dhe Anijes Në Det:** Lënda duke pasur si qëllim rritjen e sigurisë së jetës e të anijes në det synon të pajis navigatoret e ardhshëm me njohuritë baze lidhur me llojet, sasine dhe kërkesat që shtrohen për mjetet e shpëtimit në anije në përputhje me standartet e Konventes SOLAS dhe përdorimin e tyre me efektivitet në rastet e emergjencave detare që ndodhin në det. Po kështu trajtohen edhe problemet që kanë të bëjnë me operacioneve të kerkim-shpëtimit që zhvillohen në det. Shkaqet dhe parandalimi i rënies së zjarrit në anije. Mjetet dhe sistemet e shuarjes së zjarrit në përputhje me kërkesat e Konventes SOLAS, si dhe përdorimi i tyre në rastet e rënies së zjarrit në anije. Njohuritë baze të dhenies së ndihmës së parë mjeksore në bordin e anijes.

**N212 Meteorologji dhe Oceanografi:** Kjo lëndë ka për qëllim të pajisi studentet e degës navigacion me njohuritë baze të rrymave dhe presjonet detare, me karakteristikat e erërave të ndryshme në det, me vëllimet dallëse, forcën e tyre. Gjithashtu ajo jep njohuri për oqeanet, karakteristikat e tyre, me përberjen e fundit të deteve, oqeanëve duke u bërë të mundur navigatorëve të bëjnë parashikimet e tyre për motin për të realizuar një lundrim të sigurt.

**N213 Hartografia Lundrimore:** Trajton teorinë e projeksioneve hartografike. Paraqitjen e sferës tokësore në hartë. Llojet e hartave detare, elementet dhe simbolet e

tyre. Percaktimi i drejtimeve dhe distancave ne hartat detare. Kataloget e hartave detare dhe botimet e tjera per lundertaret. Organizimi i punes ne anije per sistemimin, korigjimet, dhe renditjen e hartave datare. Hartat e perdorimit per qellime speciale.

**N221 Drejtim anije:** Lenda ka per qellim te japi njohurite dhe konceptet baze te artit te drejtimit te anijes dhe synon te pajis navigatoret e ardhshem me intuiten per tu dhene zgjidhjen e duhur e te sigurt te gjitha situatave te ndryshme e te papritura qe mund te krijohen ne det. Disa nga problematikat kryesore qe trajtohen jane parimet e drejtimit te anijes, faktoret qe ndikojne ne drejtuesmerine e anijes, bashkepunimi i grupit helike-timon, bregezimi e qendrimi i anijes ne spirance, lundrimi ne kanale e thellesi te vogla, lundrimi ne mot te keq, rimorkimi, renia e nxjerrja e anijes nga cekina etj. Gjithashtu nje kapitull i rendesishem eshte ai qe ka te beje me njohjen dhe interpretimin e drejte per tu zbatuar te Rregullave Nderkombetare te Parandalimit te Perplasjeve ne Det me qellim shmangien e pasojave te renda qe ato mund te kene.

**N222 Teori Anije:** Kjo lende synon ti jap konceptet themelore mbi gjeometrine, stabilitetin dhe dinamiken e anijes me qellim te nje menaxhimite mire dhe te shpejte te situatave te ndryshme te ekuilibrit, stabilitetit dhe manovrushmerise se mjeteve detare ne kushte te ndryshme lundrimi dhe shfrytezimi.

**N223 Radari dhe Radiondihmat per Navigacionin:** Nepermjet kesaj lende studentet duhet te pervesojne bllok skemen e radarit, frekuencat ose bordet qe aplikon radari fuqine fiktive te trasmetimit, distancen minimale e maksimale te zbulimit dhe ekuacionit te radarit. Faktoret qe ndikojne ne largesimatjen e radarit. Radari me efekt duple, radari ne rregjim impulsiv dhe radari i ndjekjes se shenjave, radar kerkimi, radar pergjegjes, SARTI dhe radari si mjet perplasje.

**N224 Lundrim Detar:** Pajis studentet me njohuri praktike te jetes dhe organizimit te punes ne anije. Fiton shprehite detare lundrimore gjate sherbimit ne lundrimin dhe ne porte. Njihet me operacionet e perpunimit te anijes ne porte, manovrat per bregezim ç'bregezim dhe qendrim ne spirance. Njihet me pajisjet, mjetet dhe agregatet e anijes. Perdorimin praktik dhe sherbimet ndaj tyre.

**N225 MTL 1:** Kjo lende synon te shpjegoje teorite baze te ndertimit, funksionit dhe perdorimit te aparaturave te levizjes se anijeve, per te marre informacionin e nevojshem per vendodhjen e anijes, shpejtesise dhe levizjes se saj.

**N227 Mbrojtja nga zjarri ne anije:** Lenda synon te jap informacionin e nevojshem se si te mbohemi nga zjarri ne anije, shkaqet dhe masat paraprake. Venia e zjarrit dhe se si do te organizoheni per te fikur zjarrin brenda ne anije.

**N311 Navigacion:** Trajton gjeresisht lundrimin ne afersi te bregdetit. Barazvijat lundrimore dhe gjeometrine navigacionale ne percaktimet pamore te pozicionit te anijes. Gabimet dhe analiza e tyre. Njehsimi analitik dhe grafik i rruges te anijes. Planifikimi dhe zbatimi i rruges te anijes. Punim ne hartat detare. Trajton gjeresisht lundrimin ne det te hapur dhe ne oqean. Pajisjet dhe sistemet radionavigacionale. Sistemet navigacionale hiperbolike, sistemet satelitore, radiofeneret, trupat qiellore dhe shfrytezimi i tyre ne percaktimin e pozicionit te anijes ne det te hapur dhe oqean etj.

**N312 Astronavigacion:** Lenda synon dhenien e njohurive e koncepteve baze te orientimit e percaktimit te vendndodhjes se anijes me metoda astronomike larg pamjes nga bregu. Ne funksion te ketij qellimi jane shqyrtimi i ceshtjeve qe kane te bejne me sferen qiellore dhe koordinatat sferike, levizja e vertete dhe e dukshme e trupave qiellore, Sistemi Diellor, Hena, yjet dhe yjesite. Koha yjore e diellore, koha ne meridian te ndryshem, aparatet mates te kohes. Almanaket astronomik detare, globi yjor e yllkerkuesi, sekstanti. Menytrat e matjes se lartesis se trupave qiellore dhe korrigjimi i tyre. Korrigjimi i busulles me metoda astronomike. Menytrat e percaktimit me trupa te ndryshem qiellore me ane te dy-tre e me shume vijave lartesore te vendndodhjes si dhe me anen e matjen e njepasnjeshme te lartesis te Diellit. Saktesia e percaktimit te vendndodhjes se anijes me metodat astromike.

**N314 Teknologjia E Perpunimit Te Anijes:** Kjo lende trajton gjeresisht njohurite lidhur me teknologjine e perpunimit te anijeve te transportit detar ne pergjithsi dhe ne vecanti ato te ngarkesave te pergjithshme, te mallrave rifuxho, te mallrave te rrezikshme, dhe te transportit te kontainerve. Trajtohen njohuri mbi tipet e anijeve qe perdoren ne transportin detar, si dhe manualet e ndryshme per ruajtjen e stabilitetit dhe qendrueshmërisë së anijes ne lundrim.

**N316 Mbrojtja e mjedisit:** Kjo lende ka per qellim tju jape studenteve njohuri per te drejtat administrative ne zonen bregdetare ku transporti detar ka nje rol te rendesishem ne ekonomine e atij vendi, duke ecur paralel edhe me demet qe i sjall faunes dhe flores.

**N321 Menaxhim Anije:** Teoria e Menaxhimit te anijeve jep njohuri per parimet themelore te organizimit dhe planizimit te masave per drejtimin e sigurt te anijeve te transportit detar. Trajtohen njohuri mbi standartet nderkombetare per administrimin dhe drejtimin bashkekohore te kompanive te menaxhimit te anijeve, dhe ruajtjes se ambjentit detar nga ndotjet.

**NP322 E Drejta Detare:** Nepermjet kesaj lende studentet do te marrin njohurite e nevojshme mbi konventat e ndryshme detare si edhe me te rejat me te fundit qe aplikohen sot nepermjet buletineve te IMO-s dhe shteteve te ndryshme qe jane pjesemarrese ne keto konventa. Gjithashtu do te merren njohuri mbi legjislacionin detar aktual si me te rejat me te fundit ne kete fushe.

**N324 Radio-Kounikimi ne Det:** Kjo lende ka si qellim tju prezantoje studenteve pajisjet e sistemit te radio-komunikimit, tregues te ndryshem, stacionet bregdetare te komunikimit me aparatura te ndryshme qe perdoren ne anije per kete qellim.

**NP214 Ihtiologji dhe Perpunim Peshku:** Nepermjet kesaj lende studentet e peshkimit do te marrin njohurite e nevojshme mbi llojet e ndryshme te peshqeve qe jetojne ne ujerat territoriale te vendit tone me karakteristikat e tyre ndertimore, jetesen, ushqyerjen. Gjithashtu studentet do te studiojne metodat kryesore qe aplikohen ne anijet e peshkimit lidhur me perpunimin e ruajtjen e peshkut sa me te fresket ne anije.

**NP221 Biologji dhe Ekologji Detare:** Nepermjet kesaj lende studentet e peshkimit do te marrin njohurite e nevojshme rreth mjedisit detar me faunen e floren detare, me mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar.

**NP222 Teknika Peshkimi:** Nepermjet kesaj lende studentet e peshkimit do te marrin njohurite e nevojshme rreth teknikave te peshkimit qe aplikohen sot ne peshkimin detar,me teknologjine e peshkimit fundor,rrethor dhe ate te levizshem.Gjithashtu do te njihen me anijen e peshkimit,kushtet e punes ne anijen e peshkimit,me mjetet e peshkimit si edhe me ndertimin e tyre.

**NP322 Menaxhim Peshkimi:** Nepermjet kesaj lendestudentet e peshkimit do te marrin njohurite e nevojshme mbi menaxhimin e peshkimit,mbi kontrollin epeshkimit,e survejimin e monitorimin e anijeve ne peshkim.Gjithashtu do te njihen me konceptet baze temenaxhimit te zonave te mbyllura ne peshkim, ruajtjen e biodiversitetit si edhe menaxhimin e hapësirës ujore ne territorin e vendit tone.

**N215 Rreg. Parandalimi Perplasje ne Det:**

**N229 Drejtim Anije 1:**

**N226 Shpetimi i Jetes ne Det:**

**N228 Praktike Lundrimore 2:**

**N214 Navigacion 2:**

**N240 Navigacion 3:**

**N310 Navigacion 4:**

**N330 Legjislacion Detar:**

**N315 M.T.L. 2:**

**N328 Navigacion 5:**

**N329 Drejtim Anije 2:**

**N325 MTL 3:**

**N326 Praktike Lundrimore 3:**

**N327 Provim Final:**

**NP211 Biologji e Pergjithshme:**

**NP218 Teknikat Baze te Peshkimit:**

## 5. Departamenti i Fizikës

## 6. Departamenti i Bio-Kimisë

**CHEM 143 Kimi e Përgjithshme dhe Inorganike:** Konceptet themelore. Simbolet. Formulatat dhe ekuacionet. Stekiometria. Termokimia. Struktura e atomit dhe ligji periodic i elementeve.Lidhja kimike. Struktura e molekules dhe hibridizimi.Gjendja e gazte dhe teoria kinetike .Gjendja e lenget treset-sirat, treset-sirat koloidale. Kinetika kimike.Ekuilibrat kimike.Koceptet per acidet dhe bazat Ekuilibrat jonike dhe elektrolitet e dobet.Tretshmeria dhe produkti i treshmerise.Termodinamika kimike. Energjia e lire.Elektrokimia dhe reaksionet redoks.komponimet komplekse. Vetite periodike te elementeve. Jo metalet,hidrogjeni halogjenet, oksigjeni squfuri. Jo metalet e grupit te peste, karboni, gazet e ploget.Lidhja metalike.Metalet. Metalet kalimtare te brendshem dhe te jashtem. Elementet gjysem percues. Teorie e bandave.Elemente gjysem percues.

**BIO 143 Botanika e Pergjithshme:** Qeliza bimore: ndertimi dhe funksioni.Perberja kimike, plastet muri qelizor, vakuola dhe lengu qelizor, berthama.Indet bimore: klasifikimi, ndertimi dhe funksioni.meristemat paresore dhe dytesore.Ndertimi morfollogjik; profotitet, tallofitet comofitet.Riprodhimi seksual dhe aseksual. Lulja struktura dhe funksioni. Lulesat. Mikrosporogjeneza dhe makrosporogjeneza.Pjalmimi dhe fekondimi. Farat dhe frytet.

**BIO 145 Histologji:** Histologjia dhe metodat e studimit te saj. Qelizat dhe kulturat indore, indi epitelial; indi lidhor: fibrat, tippet e indit lidhor; indi dhjamor; kartilagjte; Kocka; qelizat dhe matriksi i kockes, histogjeneza, rritja dhe rimodelimi struktura e brendeshme e kockes. Neuronet, dhe sistemi nervor qendror, nervat, degjenerimi dhe rigjenerimi i indit nervor. Indi muskular; musklatura skeletike rigjenerimi i indit muskular; qelizat e gjakut sistemi imun dhe organet limfoide; trakti digjestiv; sistemi respirator; lekura; sistemi urinar; hipofiza; sistemi i riprodhimit te mashkullit; tek femrat; sistemi i fotoreceptoreve dhe audoreceptoreve.

**BIO 250 Zoologjia:** Konsiderata ekologjike. Ndryshshmeria ne boten e kafsheve. Klasifikimi i intervertebroreve. Protozoaret. Efektet ne mjedis, permasat e trupit menyra e egzistences. Organelat dhe pershtatja fiziologjike. Evolucioni i protozoareve, flagellatet, amebat, spor-formues. Sfungjeret dhe plakozoaret. Knidaret dhe ktenofores. Kafshet me simetri bilaterale. Askeleminet. Molusqet. Krimbat unazore. Pogonofora. Kembenyjetuarit. Krustacete. Insektet. Lekure gjemboret Lofoforatet.

**CHEM 245 Kimia Organike:** Karakteristikat e komponimeve organike. Lidhja kimike ne komponime organike. Orbitalet, rezonanca, efekti i induktivitetit, izomeria, mezomeria. Reaksionet e radikaleve. Alkanet. Alkenet. Alkadienet, alkinet. Halogjenuret e alkileve. Alkolet. Izomeria optike. Eteret, aldehidet, ketonet. Acidet karboksilike Hidrokarburet aromatike. Benzeni. Reaksionet SE. Nitrokomponimet aromatike. Fenolet. Aminat aromatike Karbohidratet. Izopreni. Komponimet heterociklike. Acidet nukleike. Aminoacidet, proteinat. Polimeret.

**BIO 252 Sistematika E Bimeve:** Cryptogamet: Hyrje, Bakteret, alget kepurdhat, likenet: vetite citologjike dhe morfologjike; Bryophitet dhe Pteridophytet; Klasifikimi tipet kryesore; ekologjia, lidhjet filogjenike. Phanerogamet. Gjimmosperrat vetite kryesore. origjina, klasifikimi; lidhjet filogjenike perhapja. Angjiospermat; vetite kryesore. Origjina klasifikimi; familjet dhe tippet kryesore shqiptare. perhapja gjeografike; vlerat ekonomike.

**BIO 255 Mikrobiologji:** Veshtrim i pergjithshem per mikrobiologjine. Biologjia e qelizes prokariote dhe eukarote; Organizimi i AND, endosporet. Te ushqyerit dhe metabolizmi; fermentimi dhe frymemarrja, konsrvimi i energjise. Diversiteti metabolik i mikroorganizmave. Rritja mikrobike, rritje e popullates. Kontrolli i rritjes mikrobiale. Gjenetika mikrobike; struktura dhe replikimi i ADN. Ekologjia mikrobike, habitatet ujore mjediset tokesore. Evolucioni mikrobik, sistematika dhe taksonomia. Viruset; karakteristikat e prgjithshme bacteriofaget, viruse e kafsheve. Konceptete e immunologjise, immunogjenet dhe antigjenet, imuniteti qelizor.

**BIO 260 Fiziologji:** Fiziologji bimore dhe regjimi ujqor. Kiokimia bimore. Rritja dhe zhvillimi. Ekofiziologjia. Parimet baza te fiziologjise shtazore. Molekulat, energjia dhe biosintezat. Membranat kanalet dhe transporti perms membranesh. Struktura e neuronit. Gjendrat dhe hormonet. Tkurrja muskulare. Gjaku zemra hemodinamika, Osmorregullimi ne mjediset ujore dhe mjedis tokesor. Veshkat e gjitareve dhe jo gjitareve. madhesia trupore rregullimi i temperaturës se trupit.

**BIO 262 Biologjia Molekulare dhe Qelizore:** Membrana plazmatike dhe fluiditeti i shtrese bilipidike. transporti aktiv transporti pasiv endocitoza e ndermjetesuar nga receptoret. mekanizmat e lindjes dhe te perhapjes se potencialit te veprimt. Organelet me membrane te dyfishte; paketimi i ADN e kromozome,

transkriptimi i AND ne prokaryote dhe eukaryote, sinteza a ARN, dyfishimi i AND; bazat molekulare te mitoses, mekanizmat e gjeneve rregullatore.

**CHEM 265 Kimia Fizike:** Termodinamika kimike.termokimia: Entropia,entalpia.potenciali termodinamik.Ekuilibri kimik, fazat e ekuilibrit kimik.Elektrokimia.Percjellshmeria elektrolitike. Kinetika dhe Kataliza.Shkalla e reaksionit kimik dhe rendi molecular i reaksioneve. Kataliza homogjene dhe heterogjene.Kimia kolodale.Sistemet dispers, aerosolet, emulsionet. Substancat makromolekulare.

**BIO 312 Gjenetika:** Gjenetika dhe organizmat.Transmetimi gjeneve. Ndarja qelizore dhe teoria kromozomike.e trashegimise.Lidhja e gjeneve dhe ndertimi i hartave gjenetike ne eukariotet. Mutacionet gjenetike.Mutacionet kromozomike.Rikombinimi te bakteret dhe viruset e tyre .ADN materiali gjenetik.Funksioni i AND dhe kodi gjenetik.Kontrolloi i shprehjes ghenetike.Elementet gjenetike te transport ueshem. Gjenetike e zhvillimit.fati i qelizave dhe plani i zhvillimit te trupit.

**BIO 320 Bazat e Ekologjise(v):** Metodatat studimit te Ekologjise.Faktoret ekologjike.Klima. Roli ekologjik i temperatures.Lageshtia.Drita.faktoret sekondare ekologjike.Ushqimi si faktor ekologjik. ,sasia dhe cilesia e ushqimit. Faktoret demografike. Faktoret Biotik.Faktoret interspecifike.Ekosistemet dhe biocenozat.Biomasa.Biosfera.Ekuilibrat e natyres.Mbrojtja e natyres.

**BIO 330 Biokimia:** Uji dhe vetite e tij.Aminoacidet, proteinat, enzimat, inhibitorët. Struktur e DNA dhe RNA. Vitaminat dhe koenzimat. Ligjet Bioenergjitike. Glikolisa. Menyra Pentose fosfatit. Cikli i acidi Citrik acid. Degradimi i aminoacideve. Fotosinteza. Biosinteza. Biosinteza e proteinave dhe roli i RNA. Kodi gjenetik. Aspekte biokimike te reaksioneve hormonale.

**BIO 325 Bioteknologji:** Bioteknologjia klasike dhe molekulare. Organizmat e perdorura ne bioteknologji. Teknologjite e perdorura ne bioteknologji. Fermentimi:bioreaktoret. Biokonvertoret, teknologjia e enzimave.bioteknologjia e aplikuar. Bioteknologjia dhe mjeksia.vaksinat. Prodhimi industrial i hormoneve. Metodatat bioteknologjike ne ekstraksionin e metaleve, joneve etj.mikroorganizmat industriale.

**BIO 350 Teoria e Evolucionit:** Historia e biologjise. Lamarck dhe Darwin. Principet e teorise se evolucionit. Mikrevolucioni. Faktoret e evolucionit.Speciet.makroevolucioni. Origjina e jetes dhe e njeriut.

**BIO 340 Anatomia Njeriut:** Studimi i trupit te njeriut dhe sistemeve te tij. Skeleti.Artikulacionet.Muskujt, tipet, funksioni dhe pozicioni. Aparati Digjektiv. Aparati respirator. Aparati Urinar.Aparati gjenital femeror. Aparati gjenital mashkullor. Sistemi i qarkullimit te gjakut.Sistemi Nervor qendror. Truri Sistemi nervor autonom.Lekura. Sistemi endikrinik.Hormonet.

**CHEM 370 Kimi Analitike dhe Metodatat Instrumentale te Analizes:** Acidet dhe bazat.Elektrolitet. Titrimit Acid-baze. Precipitimi. Gravimetria, volumetria, kompleksometria. Reaksionet e Oxido-reduckimit, potenciali Oxido-reduktues. Metodatat Optike te analizes. Metodatat: Elektroanalitike Kromatografike.Metodatat speciale te amalizes.Potenciometria.





## Fakulteti i Shkencave Shoqerore dhe Edukimit

### 1. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

**ALB 131 Hyrje Në Gjuhësi:** Trajtimet e kësaj lënde i kalojnë kornizat e trajtimeve tradicionale, për t'iu afruar trajtimeve të kohës në gjuhësinë e sotme. Një vend të rëndësishëm zë shtjellimi i koncepteve F. de Sosyrit dhe të N. Çomskit. Zënë vend çështje që kanë të bëjnë me vendin e gjuhësisë në shkencat shoqërore, veçoritë dhe funksionet e saj, informacione të detajuara për disiplina të ndryshme të gjuhësisë si: fonetika, gramatika, semantika, si edhe klasifikime të ndryshme të gjuhëve dhe lidhja mes gjuhës dhe shoqërisë.

**ALB 132 Letërsia e Vjeter dhe e Rilindjes Kombetare:** Kursi i ligjeratave synon njohjen dhe pershkrimin në sensin kronologjik e tematik të dy periudhave të rëndësishme të Letërsisë Shqipe, Letërsisë së Vjeter dhe Letërsisë së Rilindjes Kombetare Shqiptare. Letërsia e Rilindjes Kombetare perkufizohet si letërsi e një periudhe me fizionomi komplekse, që njejetosi, zhvilloi e konsolidoi elemente qendrore të qenies kombetare, me funksione polivalente dhe që determinoi pothuaj të gjitha rrjedhat e zhvillimit kulturor e stilistik të mevonshëm.

**ALB 150 Gjuhe Shqipe:** Kjo lëndë jep njohuri të plota rreth pjesëve të ligjeratës, kriteret e klasifikimit të tyre, si edhe veçoritë leksiko-gramatikore të tyre. Gjithashtu përfshihen aspekte të ndryshme të gjuhës që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me karakterin analitues e fjalëformues morfologjik, me veçoritë leksikore-gramatikore të pjesëve të ndryshme të ligjeratës, kuptimin e përgjithshëm kategorial etj.

**ALB 151 Letërsi e Mesjetës:** Lënda synon ta pajisë studentin me njohuri për karakteristikat e letërsisë së kohës së mesme, elementet e kësaj letërsie, letërsinë kalorsiake, eposin gjerman, spanjoll, francez, rilindja europiane me përfaqësues: Dante Aligieri, Bokaçio, Petrarca, Servantesi, Shekspiri, si edhe epoka e klasicizmit, parimet, autorët: Pjer Kornej, Zhan Rasin, Molier. Letërsia gjermane e shekullit XVIII: Gëtja, Shileri.

**ALB 155 Hyrje në Shkencën e Letërsisë:** Lënda synon njohjen e disa nocioneve themelore mbi shkencën e letërsisë dhe disiplinat e saj përbërëse, objektin e shkencës për letërsinë: teorinë mbi veprën letrare artistike, natyrën dhe funksionin e letërsisë, problemet e kuptimit dhe interpretimit të tekstit letrar. Gjithashtu synohet njohja e teorive të ndërtimit të tekstit letrar, stili letrar dhe figurat stilistike: metafora, metonimia, sinekdoka, ironia, alegoria, simboli, paradoksi; figurat e intonacionit poetik dhe figurat e sintaksës poetike, elemente të metrikes, sistemet e vargëzimit, tipologjitë strukturore të veprave letrare dhe nocionin e gjinisë.

**ALB 165 Leksikologji:** Shkencë gjuhësore që studion fjalët si njësi leksikore dhe leksikun. Lënda trajton një sistem pak a shumë të plotë dijeshe për leksikologjinë dhe leksikografinë shqipe. Ajo studion lidhjet ndërmjet formës gjuhësore e përmbajtjes së saj në njësinë e fjalës a të frazeologjisë, si edhe dinamikën e zhvillimit

të pandërprerë të leksikut. Studiohen nga njësia më e vogël a themelore (fjala ose përbërësi kuptimor) drejt njërive më të mëdha (fjalët e pathjeshta, frazeologjia, leksiku, ligjërimi e stili ose kuptimi, struktura kuptimore, polisemia, grupet paradigmatiske)

**ALB 231 Fonetika:** Lënda përmes një sistemi koncetrik-linear jep njohuri shkencore për strukturën tingullore të ligjërit të shqipes, për tingujt (konkretisht për njëtimin dhe veçoritë e tyre). Në të zërthehen: sistemi fonologjik i shqipes, ai i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve, parimet e klasifikimit dhe përshkrimi i tyre njëtimor e akustik, kundërvëniet e zanoreve, diftongjet, korrelacionet e bashkëtingëlloreve dhe formantet e tyre, ndërrimet e fonemave të shqipes, rrokja, theksi, drejtshqiptimi e drejtshkrimi etj.

**ALB 251 Dialektologji:** Ka karakter kryesisht të përgjithshëm, informues e formues. Në të janë parashtruar një numër konceptesh dhe vlerësimesh rreth dialektologjisë dhe të dhënave të dialekteve për studimin e plotë e të thelluar të gjuhës, duke e shtrirë kundrimin edhe jashtë caqeve të dialektologjisë shqiptare. Gjithashtu trajtohen ndarjet dialektore të gjuhës shqipe, tiparet dalluese fonetike dhe gramatikore, si edhe marrëdhëniet e dialekteve me gjuhën letrare.

**ALB 289 Psikologji:** Kjo lende prezanton studentin me shkencën e psikologjisë dhe zhvillimet e fundit të psikologjisë. Pas marrjes së informacionit të nevojshëm studenti do të analizoje proceset e rritjes dhe zhvillimet emocionale (pune me shkrim/ diskutim në grup)

**ALB 290 Popullsia Perendimore:** Kjo lende është një prezantim i ideve, institucioneve dhe ngjarjeve që ndodhen në periudhën moderne në Europën Perëndimore, përqendruar në Europën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut por gjithashtu një rëndësi i jepet edhe marrëdhënieve midis perëndimit dhe pjesës tjetër të botes.

**ALB 310 Semiotikë teksti:** Kursi synon të thellojë njohuritë bazë për semiotikën si: shenja, kod, modeli bazë i komunikimit, për të kaluar pastaj të analiza e tekstit në prozë, konceptet bazë të narracionit, koncepti i historisë, koncepti i tregimit si diskurs, analiza e tekstit poetik. Gjejnë vend strukturat diskursive: thënia, aktorët, këndvështrimi, aspektet, kontributi i Propp-it, Greimas-it, Eco-s, Genette-it, Lotman-it, Geninaska-s, në semiotikën e tekstit.

**ALB 321 Letërsi e huaj e shek. XIX:** Kursi i ligjeratave ofron përshkrimin dhe analizen në rrafshin universitar të disa orientimeve themelore për letërsinë botërore të shekullit XIX, nënrymat përkatëse, veçanërisht në letërsinë evropiane, njohja me procesin letrar kompleks, dukuritë estetike e etike në kontekst të cilave u materializua ajo letërsi dhe përfaqësuesit kryesorë të saj. Kursi synon ndertimin e një sistemi konceptual të qartë mbi prurjet stilistike e kontekstin tyre ideologjik e social gjatë kësaj periudhe.

**ALB 323 Letërsi moderne shqipe:** Kjo lëndë ofron një informacion të plotë rreth procesit letrar gjatë periudhës mes dy luftërave botërore, informacion që lidhet me zhvillimet, me rrymat dhe drejtimet letrare që karakterizojnë këtë periudhë. Bën objekt në mënyrë të detajuar profilin biografik të autorëve më përfaqësues të kësaj letërsie, karakteristikat dhe tiparet e krijimtarisë së tyre letrare, si dhe krijon idenë e qartë të një analize të thellë shkencore të teksteve letrare të autorëve përkatës.

**ALB 325 Sociolinguistikë:** Përmban të dhëna mbi objektin, fushat e zbatimit dhe marrëdhëniet e sociolinguistikës me shkencat e tjera. Jepen disa përkufizime dhe vlerësime të përgjithshme të bashkësisë shoqërore dhe asaj gjuhësore, nivelet e analizës sociolinguistike etj. Me marrëdhëniet e sotme të dialekteve me gjuhën letrare standarde, përkundërime sociolinguistike të shndërrimeve semantike të fjalëve për motive jashtëgjuhësore etj.

**ALB 342 Praktikum:** Nëpërmjet kësaj lënde studentët të pajisen me njohuri për çështjet gramatikore, veçanërisht për çështje të normës morfologjike dhe sintaksore, me njohuri për normën drejtshkrimore të gjuhës standarde dhe për pikësimin e fjalisë dhe të periudhave me bashkërenditje dhe me nënrenditje.

**ALB 355 Teori e letërsisë:** Kursi i Teorisë së Letërsisë ofron në pikëpamje konceptuale, pastaj edhe metodike, një organon qendrimesh mbi natyrën e letërsisë, funksionin e saj, studimin e saj të jashtëm, mënyrën e ekzistencës etj. Përgjithësisht ky program u përmbahet qendrimeve të ngurtësuar teorike mbi përfshirjen e Teorisë së Letërsisë në konceptin Studim i Letërsisë, studimeve paraqitese mbi aplikimin e metodave deterministe, pikëpamjeve fenomenologjike, hermeneutike etj. Në diakroni e sinkroni programi perpiqet të vendosë raporte të pershatshme e koherente për të mbërritur në një qendrim të domosdoshëm sistematik.

**ALB 361 Letërsi bashkëkohore shqipe:** Kjo lënde nënkupton një tërësi analizash, studimesh dhe konkluzionesh, të shtrira në dy pjesë, poezi dhe prozë. Lënda propozon analiza, vlerësime, përkufizime dhe sinteza historiko-letrare mbi tendencat, fenomenet dhe individualitetet poetike të poezisë së sotme shqipe (pjesa e parë) dhe fizionominë e autorëve kryesorë dhe veprat përfaqësuese, tendenca dhe prirje letrare të verifikuara e të pranuar tashmë nga kritika dhe historiografia jonë letrare.

**ALB 401/411 Mesimdhënie e Letërsisë dhe Gjuhës:** Kjo lënde ka për qëllim t'ju japë studenteve njohuri rreth teknikave të përdorura në ciklin e ulet dhe atë parashkollorë, për të kuptuar konceptet baze të teorisë së gjuhës dhe letërsisë bazuar në temat e lëndës.

## 2. Departamenti i Histori-Gjeografisë

### 3. Departamenti i Edukimit

**EDU 131 Hyrje Në Psikologji:** Lënda synon t'ju japë studenteve koncepte dhe njohuri kryesore të psikologjisë dhe parime të ndryshme që gjejnë zbatim në jetën e përditshme. Në të do të trajtohen teoritë e zhvillimit të individit, emocioni, motivacioni, kujtesa, marrëdhëniet ndërpersonale etj.

**EDU 135 Edukimi Figurativ Dhe Didaktike:** Lënda synon formimin e pershkalëzuar të studentit me artin pamor për të njohur, krijuar, dhe analizuar vepra artistike për të komunikuar ide dhe për t'i zbatuar ato në procesin mesimor.

**EDU 220 Administrim Arsimit:** Synimi i modulit është të njohesh studentet me elementet e menaxhimit, karakteristikat e menaxhuesit dhe liderit si dhe të aftësohen në këto drejtime.

**EDU 231 Metodologji Mesimdhënieje:** Kjo lënde synon të pajis studentet me njohuri mbi metodat dhe modelet e mesimdhënies, menaxhimit të klasës, organizimit

e ores se mesimit,planet mesimore,programet,plan ditaret si dhe te pajis me njohuri praktike dhe teorike si mesues fillestare.

**EDU 232 Psikologji Zhillimi:** Ky program u mundeson studenteve njohuri mbi femijerine e hereshme,moshen parashkollore,moshen shkollore deri ne adoleshence dhe teorite e ndryshme psikologjike mbi zhvillimin e moshes.

**EDU 233 Psikologji Edukimi:** Ne kete program jepen njohuri per rolet e subjekteve te ndryshme qe marrin pjese ne procesin e edukimit, percaktime te mesimdhënies, dhe te atyre te nxenit ne kendveshtrimin psikologjik, ne menaxhimin e klases dhe komunikimin.

**EDU 234 Edukim Muzikor Dhe Didaktike:** Me ane te njohurive qe prezanton kjo lende studenti perveteson elemente te artit muzikor si ritmi,tingulli,vlerat e notave,kohet e ndryshme,menyren e organizimit te nje ore te edukimit muzikor ne ciklin e ulet dhe ate parashkollor.

**EDU 252 Histori E Popullit Shqiptar:** Ky program synon t'i pajis studentet e mesuesise me nje rreth te caktuar njohurish mbi historine e popullit tone qe nga prehistoria deri ne ditet e sotme.Programi u jep mundesi studenteve te gjykojne e te mbajne qendrim per shume probleme te historise tone antike,mesjetare,te re dhe bashkekohore.

**EDU 325 Edukimi Fizik E Didaktike:** Ky program u ofron studenteve lojera levizore, lojera vemendjeje, praktike funksionale etj.Gjithashtu fitojne njohuri si te organizojne ore mesimi si ne edukimin parashkollor dhe ne ciklin e ulet.

**EDU 330 Edukim Mjedisor:** Te realizoje nepermjet njohurive mjedisore nje koncept te sakte mbi mjedisin dhe elementet e tij perberes,lidhjet e tyre dhe marredheniet e ndersjellta me njeriun.Ne kete ciklet leksionesh trajtohet organizimi funksional i biosferes, ciklet biogjeokimike.Vend kryesor ze studimi i kimise se atmosferes dhe problemet shqetesuese,si "Vrima e O3",efekti sere dhe ngrohja globale,shiu acid dhe smogu fotokimik.Studentet njihen me ekosistemet ujore,dukurine e eutrofikimit te ujerave.Vend te rendesishem i kushtohet zhvillimit te qendrushem dhe burimeve energjitike.Lenda merr rendesi te vecante per faktin qe studentet diplomohen si mesues dhe se ne shkollat shqiptare lenda e edukimit mjedisor ze vend te vecante ne kurrikulat shkollore.

**EDU 331 Teori Dhe Filozofi Edukimi:** Synon te pajis studentet te kuptojne se njeriu terhiqet ne menyre te vetedijeshme nga filozofia dhe se filozofia spjegon boten qe na shfaq.Jepen probleme te demokracise,vlerat themelore si dhe edukim i mesueseve te rinj ne nje shoqeri demokratike.

**EDU 333 Edukim Teknologjik:** Programi i ben studentet te shvillojne aftesite baze dhe te krijojne shprehi praktike e teknike per pergatitjen e mjeteve dhe objekteve mesimore si dhe me artin e mesimdhënies ne shkollë.

**EDU 334 Edukate Qytetare:** Moduli jep njohuri mbi institucionet dhe dokumentat kryesore mbi te drejtat e njeriut,pjesemarrjen qytetare konfliktet ne shoqeri,ligjet,e drejta familjare dhe e punes.

**EDU 335 Psikologji Loje:** Synon te pajis studentet me njohuri mbi shpjegimin e elementeve te perbashket te lojerave dhe rendesine e eksperiences loje per

femijet, te diskutojne mebi teorite e ndryshme te lojes, te identifkojne stadet neper te cilat kalon loja etj.

#### 4. Departamenti i Gjuhëve të Huaja

##### **ENG 131 Gjuhë Angleze :**

**ENG 151 Mjeshtëri të Gjuhës Angleze:** Qëllimi i kursit është të përgatisë studentët për nivelin FCE Proficiency. Studentët vënë në praktikë të katërta mjeshtëritë: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit. Pjesët e leximit janë tekste nga jeta e vërtetë, të cilët reflektojnë një shumëllojshmëri regjistrash dhe stilesh gjuhësorë. Materiali audio shoqërohet me transkripte të plota ose të pjesshme. Studentët praktikojnë të dëgjuarit për idenë kryesore, pikat kyçe, detajet dhe hollësitë.

**ENG 152 Gramatikë e Gjuhës Angleze II:** Qëllimi i kursit është të ndihmojë studentët të përdorin Gramatikën Angleze për të komunikuar kuptimin e duhur në lloje të ndryshme ligjëratash, si dhe të shprehë vet veten në mënyrën e duhur. Mënyra e organizimit të këtij kursi nis nga aspektet e rëndësishme të morfologjisë angleze dhe sintaksës, deri tek struktura e fjalive dhe analizës stilistikore.

**ENG 170 Arti i të Shkruarit:** Ky kurs do t'u paraqesë studentëve rregullat bazë të të shkruarit. Studentët do të njihen me taktika bazë, si titullimi, përqëndrimi, skematizimi, ndarja në paragrafem etj, të cilat janë të domosdoshme për hartimin e eseve të shkurtra.

**ENG 171 Shkrim Akademik:** Studentët do të marrin mësim mbi fusha si prezantime gojore, dokumentim i burimeve të mbledhura, metoda të planifikimit të eseeve, mënyra të drejta e të gabuara të shkrimit argumentativ etj. Duke pasur së pari studiuar rregullat bazë në vitin e parë, viti i dytë do të përqëndrohet në mënyrën si duhen shkruar esetë akademike.

**ENG 193 Fonologji e Gjuhës Angleze:** Ky kurs ka për qëllim t'i pajisë studentët me bazat praktike dhe teorike të fonetikës dhe fonologjisë së gjuhës angleze, si dhe për t'u dhënë në veçanti studentëve bazat e njohurive mbi tingujt e gjuhës angleze. Synimi është që të ndihmojë studentët të krahasojnë fonemat angleze me ato shqipe në mënyrë që të përmirësojnë shqiptimin e tyre.

**ENG 255 Hyrje në Linguistikë:** Kjo lëndë i ndihmon studentët të kuptojnë "qarqet magjepsëse" të linguitikës. Qëllimi i tij është të shpjegojë në ç'mënyrë linguitika ndryshon nga studimet gramatikore, si dhe të saktësojë cilat janë nëndarjet kryesore të fushës. Gjuha dhe tipologjia linguitike, si dhe idetë e Chomsky-t mbi gramatikën do të përfshihen në të.

**ENG 262 Kulturë Britanike:** Ky kurs eksploron qytetërimin bashkëkohës britanik, nëpërmjet trajtimit të temave të rëndësishme të shoqërisë dhe identitetit të Britanisë së Madhe. Një spektër i gjerë temash dhe tekstesh do të trajtohen. Temat do të përfshijnë rolin e mass medias, të kulturës popullore, urbanizimit, të lëvizjeve sociale, si dhe të globalizimit në formimin e karakterit kulturor britanik. Tekstet përfshijnë artikuj, ese akademike, shkrime politike, si dhe elemente kulturorë, si filma, muzikë, shfaqje, reklama, imazhe dhe arte figurative. Kursi do të hedhë piketat interpretative për të analizuar domethënien sociale, politike dhe historike të teksteve.

**ENG 264 Studime në Kulturën Amerikane:** Ky kurs ofron një hyrje në studimet e kulturës amerikane. Fokusi do të jetë mbi zhvillimet e temave dhe ideve më kryesore në formimin e kulturës amerikane që nga vitet 1920 e deri më sot. Duke përdorur metodat interdisiplinore të studimeve amerikane, do të mbulohet një spektër i gjerë temash dhe tekstesh. Temat do të përfshijnë rolin e mass medias, të kulturës popullore, urbanizimit, të lëvizjeve sociale, si dhe të globalizimit në formimin e karakterit kulturor amerikan. Tekstet përfshijnë artikuj, ese akademike, shkrime politike, si dhe elemente kulturorë, si filma, muzikë, shfaqje, reklama, imazhe dhe arte figurative. Kursi do të hedhë piketat interpretative për të analizuar domethënien sociale, politike dhe historike të teksteve.

**ENG 265 Histori Amerikane:** Historia amerikane përmes temave të rëndësishme të shoqërisë dhe identitetit amerikan. Studentët do të njihen me një panoramë të historisë amerikane. Një hyrje do t'i bëhet gjithashtu edhe figurave dhe ngjarjeve kyçe të popullit amerikan.

**ENG 266 Histori e Gjuhës Angleze:** Ky kurs synon paraqitjen e epokave kryesore të zhvillimit të gjuhës angleze, që nga fillimet e saj e deri në ditët e sotme. Zhvillimet dhe diversiteti i gjuhës angleze do të trajtohet, së bashku me diskutime rreth debateve mbi gjuhën dhe rëndësisë së tyre në zhvillimin e gjuhës së sotme angleze, duke i dhënë një panoramë të shkurtër jetës politike e kulturore gjatë kësaj periudhe.

**ENG 281 Hyrje në Studime Letrare:** Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me informacion mbi letërsinë dhe veprat letrare, t'i nxisë ata të eksplorojnë proceset e krijimtarisë letrare si një mjet që të çon drejt të kuptuarit e motiveve të autorit, interpretimit të veprës, zhanrit letrar, kritikës, figurave letrare, etj.

**ENG 341 Semantika:** Ky kurs hulumton parimet bazë të semantikës, studimit të kuptimit. Studentët do të eksplorojnë mënyrën në të cilën gjuha organizohet dhe shprehet me fjalë, pjesë të fjalëve dhe fjali. Përveç kësaj lënda trajton lidhjet e fjalëve me fjalë të tjera, si dhe lidhjet e fjalive me të tjera fjali.]

**ENG 356 Linguistikë e Përgjithshme:** Kursi do të trajtojë zhvillimet e linguistikës, që nga kohët e Romës së lashtë dhe Greqisë, përmes studimeve të mesjetës, Rilindjes dhe linguistikës bashkëkohëse moderne.

**ENG 358 Sociolinguistikë:** Kursi synon që të kombinojë e të diskutojë një shumëllojshmëri të gjerë konceptesh, metodash e hulumtimesh të rëndësishme në këtë disiplinë. Sociolinguistika dhe lidhjet e saj me natyrën dhe funksionin e gjuhës janë në qendër të këtij kursi. Tjetër qëllim është që të identifikojë e të qartësojë imazhin dhe rolin e sociolinguistikës, si dhe ndërveprimin midis linguistikës dhe sociolinguistikës. Sistemi gjuhësor do të trajtohet në këndvështrimin e Sociolinguistikës me shkencat e tjera, me shoqërinë, kulturën dhe gjuhën.

**ENG 364 Stilistika Letrare:** Qëllimi i kësaj lënde është të informojë studentët që stilistika mund të trajtohet si një lidhje midis linguistikës dhe studimeve letrare. Ajo paraqet studimet teorike dhe përshkruese, të cilat përcaktojnë më qartë qëllimin e stilistikës si një mënyrë dinamike për ndërmjetësim midis linguistikës dhe kritikës letrare, e cila reflekton strukturën retorike dhe linguistike të teksteve letrarë të përdorur për qëllime stilistikore.

**ENG 375 Të Folurit në Publik:** Aftësia për të folur me vetëbesim dhe për të dhënë një mesazh persuaziv është një mjeshtëri thelbësore për profesionistët e kohëve të sotme. Ky kurs u jep studentëve mundësinë për të përmirësuar mjeshtëritë e veta të të folurit në publik duke praktikuar e duke dhënë fjalime dhe prezantime në një mjedis miqësor dhe me vlerësime individuale.

**ENG 377 Interpretim:** Kursi i interpretimit u jep studentëve një hyrje mbi interpretimin për konferenca, duke u përqëndruar në mjeshtëritë që nevojiten për interpretim konsektiv dhe interpretim simultan. Në interpretimin konsektiv, studentët mësojnë të identifikojnë organizimin e brendshëm të një fjalimi ekstemporan duke paraqitur dhe interpretuar fjalime të këtij lloji. Ky kurs do të përforcojë aftësinë e studentëve për të perceptuar thelbin e kuptimit dhe do të zhvillojë teknikat e mbajtjes së shënimeve. Kursi vë theks në qartësinë e të shprehurit, në stilin dhe gramatikën e saktë, në diksionin e duhur, si dhe në dhënien e rrjedhshme të mesazhit. Studentët do të zgjerojnë gjithashtu bagazhin e tyre gjuhësor, duke punuar me terma dhe idioma të përdorura gjerësisht në fjalimet ekstemporane. Në interpretimin simultan, studentëve do t'u paraqiten strategjitë bazë për të interpretuar në mënyrë simultane në një kabinë interpretimi. Fillon me një hyrje të përgjithshme dhe vijon me një seri ushtrimesh parapërgatitore, të cilat i ndihmojnë studentët të zhvillojnë përqëndrimin e duhur për të dëgjuar e folur në të njëjtën kohë, për të zotëruar luhatjet e zërit, si dhe për të përvetësuar teknika për një të folur të rrjedhshme. Në fund të kursit, studentët do të jenë në gjendje të interpretojnë fjalime që zgjasin nga tetë deri në dhjetë minuta.

**ENG 381 Letërsi Angleze:** Qëllimi i këtij kursi është të pajisë studentët me njohuri të thella mbi origjinat, Epokën e Mesjetës, Epokën e Rilindjes, kohët moderne dhe madje një metodë për të përcaktuar renditjen gjenetike të letërsisë angleze, e cila korrespondon me fazën e gjerë të historisë morale dhe sociale të Anglisë, duke u bazuar në harmoninë natyrore të faktorëve socialë dhe atyre intelektualë.

**Letërsi Amerikane:** Ky kurs është përpiluar si një hyrje e përgjithshme në temat dhe figurat kryesore të skenës letrare amerikane, që nga kohët e kolonializmit deri në ditët e sotme, si një shprehje e karakterit dhe eksperiencës amerikane. Karakteristikat e shkrimtarëve amerikanë studiohen në kontrast me ato të shkrimtarëve evropianë.

**ENG 398 Projekti Final:** .....

**ITAL 131 Mjeshtëri të Gjuhës Italiane I:** Ky kurs ndahet në disa module për një total prej 90 orësh, secila prej tyre me një synim: të përshkruajë një tekst nga ana gjuhësore (përmbajtjen, funksionet dhe tipologjinë e tekstit); të ndihmojë studentët të zhvillojnë një mënyrë globale të të menduarit dhe të të shprehurit ndërsa analizojnë një tekst; të zbulojnë domethëniet kulturore të ngjarjeve e të personazheve, si dhe të rafinojnë mjeshtëritë e të shkruarit.

**ITAL 132 Mjeshtëri të Gjuhës Italiane II:** Ky kurs ka për synim të ndihmojë studentët të zhvillojnë një mënyrë globale të të menduarit ndërsa analizojnë një tekst, pjesë të veçanta veprash letrare dhe poezie, si dhe të përmirësojnë mënyrën e të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

**ITAL 151 Gramatikë e Gjuhës Italiane I:** Ky kurs ka për qëllim të mbulojë aspektet e përgjithshme të morfologjisë së gjuhës italiane, si dhe të specifikojë rregullat e saj në kontekstin e një komunikimi të saktë gjuhësor në situata të përcaktuara. Përveç analizës në detaj të kategorive të ndryshme të ligjëratës, ky kurs synon t'i japë studentit elementet bazë përmes teksteve më prestigjioze për këtë fushë, si dhe me ndihmën e një sërë ushtrimesh të bazuara në materiale origjinale.

**ITAL 152 Gramatikë e Gjuhës Italiane II:** Ky kurs ka për qëllim të mbulojë aspektet e përgjithshme të morfologjisë italiane, si dhe të specifikojë rregullat e saj në panoramën e një komunikimi të saktë linguistikë në situata të caktuara përveç analizës në detaj të kategorive të ndryshme gjuhësore ai synon të mbulojë elementët bazë të gramatikës duke përdorur tekstet më prestigjioze të gjuhës italiane, si edhe me ndihmën e ushtrimeve të ndryshme praktike të bazuara në materiale origjinale.

**ITAL 170 Kompozim:** Ky kurs ka për synim rafinimin e artit të të shkruarit dhe të parimeve të tij gramatikore, logjike dhe sintaksore duke përdorur mjeshtëritë dhe imagjinatën e studentit në mënyrë që rrëfimi të bëhet më i kuptueshëm dhe tërheqës.

**ITAL 171 Shkrim Akademik:** Ky kurs ka për synim rafinimin e artit të të shkruarit dhe të parimeve të tij gramatikore, logjike dhe sintaksore duke përdorur mjeshtëritë dhe imagjinatën e studentit në mënyrë që rrëfimi të bëhet më i kuptueshëm dhe tërheqës.

**ITAL 193 Fonologji e Gjuhës Italiane:** Ky kurs shtrihet gjatë gjithë vitit. Synon të parashtrijë parimet bazë të teorisë së Fonetikës dhe Fonologjisë Italiane, si edhe të analizojë problemet kyçe që një student has në shqiptim.

**ITAL 231 Mjeshtëri të Gjuhës Italiane III:** Kjo lëndë synon të zhvillojë mjeshtëritë gojore dhe dëgjimore të studentit. Elementet e gjuhës trajtohen përmes leksionesh tematike dhe të integruara që theksojnë dhe përforcojnë katër mjeshtëritë gjuhësore të të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit në një nivel mesatar.

**ITAL 232 Gjuhë Italiane:** Ky kurs ndahet në disa module për një total prej 90 orësh, secila prej tyre me një synim: të përshkruajë një tekst nga ana gjuhësore (përmbajtjen, funksionet dhe tipologjinë e tekstit); të ndihmojë studentët të zhvillojnë një mënyrë globale të të menduarit dhe të të shprehurit ndërsa analizojnë një tekst; të zbulojnë domethëniet kulturore të ngjarjeve e të personazheve, si dhe të rafinojnë mjeshtëritë e të shkruarit.

**ITAL 255 Gjuhë Latine:** Kursi ka për synim t'i japë studentit fillestar një hyrje të përgjithshme në fjalorin dhe gramatikës latine. Latinishtja është një gjuhë për të cilën ne kemi të dhëna të shumta, që nga mbishkrime mbi gurë në gjuhën latine nga shekulli i VI para Krishtit, dhe deri tek pjesët e shkruara në latinisht të ditëve të sotme. Ky kurs synon t'i mësojë studentit stilin e gjuhës latine që përdorej midis anëtarëve më të arsimuar të shoqërisë romake të periudhës së fillimit të shekullit të I para Krishtit deri në shekullin e II pas Krishtit, latinishten e autorëve romakë si Ciceroni, Çezari, Katundus, Virgjili, Horaci, Kuintiliani, Juvinali dhe Apoleiusi, për të përmendur disa prej tyre. Njëkohësisht kursi do të shtrojë një themel të fortë për studimin e latishtes së të gjitha periudhave dhe



stileve, përfshirë latinishten e lashtësisë dhe të mesjetës, latinishten ekleziaste dhe shkencore.

**ITAL 262 Histori e Italisë:** Ky kurs synon të trajtojë: studimin e kulturës italiane, shoqërisë dhe familjes, historisë së medias, radios, televizionit dhe kinemasë italiane që na viti 1924 deri në ditët e sotme; studimin e jetës italiane si edhe aktivitetet dhe veprat më të rëndësishme letrare nga shtëpitë botuese më të njohura në Itali.

**ITAL 263 Kulturë Italiane:** Ky kurs synon të trajtojë: studimin e kulturës italiane, shoqërisë dhe familjes, historisë së medias, radios, televizionit dhe kinemasë italiane që na viti 1924 deri në ditët e sotme; studimin e jetës italiane si edhe aktivitetet dhe veprat më të rëndësishme letrare nga shtëpitë botuese më të njohura në Itali.

**ITAL 264 Kulturë Bashkëkohore Italiane:** Ky kurs synon të trajtojë: studimin e kulturës italiane, shoqërisë dhe familjes, historisë së medias, radios, televizionit dhe kinemasë italiane që na viti 1924 deri në ditët e sotme; studimin e jetës italiane si edhe aktivitetet dhe veprat më të rëndësishme letrare nga shtëpitë botuese më të njohura në Itali.

**ITAL 273 Punë me Projekte:** Ky kurs do t'u paraqesë studentëve rregullat bazë të të shkruarit. Studentët do të njihen me taktika bazë, si titullimi, përqëndrimi, skematizimi, ndarja në paragrafe, etj., të cilat janë të domosdoshme për hartimin e eseve të shkurtra.

**ITAL 331 Linguistikë Teksti IV:** Kursi diskuton modelet e tipologjisë së tekstit dhe të standarteve tekstuale, si p.sh. kohezioni, koherenca, qëllimshmëria, pranueshmëria, informimi, rrethanat dhe intertekstualiteti. Kursi përqëndrohet në tekste të shkruara dhe trajton çështje si ideologjia dhe pushteti në prodhimin e tekstit, të kuptuarit dhe interpretimi, teoria e skemave, njohuri bazë, strategji për komunikim efektiv dhe manipulim. Ndërsa kursi mundohet të përqsasë teorinë me praktikën, ai analizon tekste të shkruara të pafabrikuara dhe vë në dukje rolin e corpus linguistics. Kursi gjithashtu eksploron kontributet e ndryshme që linguistika e tekstit u jep fushave të tjera si përvetësimi i gjuhës, mësimdhënia dhe përkthimi.

**ITAL 341 Semantikë:** Synimi i këtij kursi është të japë disa koncepte bazë të studimit të kuptimit në linguistikë dhe në fushat e lidhura me të (kryesisht shkenca kognitive dhe psikologjia). Fokusi primar do të jetë në kuptimin e fjalës (semantika leksikore) si dhe një hyrje do t'i bëhet edhe semantikës sentenciale dhe pragmatikës. Tema e përgjithshme e kursit do të jetë si të përshkruash sa më mirë kuptimin në gjuhën njerëzore.

**ITAL 342 Metoda të Mësimdhënies:** Ky kurs do t'u japë studentëve metodat e ndryshme të mësimdhënies. Qëllimi i tij është të bëjë të mundur të kuptuarit e të gjitha teknikave të mësimdhënies nga ana e studentëve, si dhe mënyrat me të cilat këto teknika duhen aplikuar në mënyrë që studentët të kualifikohen si mësues të rinj në të ardhmen.

**ITAL 356 Linguistikë e Përgjithshme:** Qëllimi i këtij kursi është të pajis studentët me një panoramë të përgjithshme të zhvillimit të shkencës së linguistikës, që nga antikiteti (Roma e Lashtë dhe Greqia) deri në Epokën e Mesjetës, linguistikën moderne, si edhe linguistikën e këtij shekulli. Shkollat e ndryshme

të mendimit lingvistik, si edhe lingvistët më të mirënjohur të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e lingvistikës si shkencë do të trajtohen gjerësisht në orët e leksioneve. Përveç pjesës teorike, do të zhvillohen edhe seanca të ndryshme lingvistikë me ushtrime dhe analiza të problemeve të ngritura gjatë leksioneve.

**ITAL 364 Histori e Gjuhës Italiane:** Ky kurs synon të paraqesë epokat kryesore të zhvillimit të gjuhës italiane, që nga fillimet e saj - gjuha latine - deri në ditët e sotme duke dhënë të përbashkëtat midis të kaluarës dhe të tashmes. Zhvillimet dhe diversiteti i gjuhës italiane do të trajtohen në këtë kurs, duke u përpjekur të jepet një panoramë e plotë e gjuhës italiane gjatë viteve '200, '300, '400 e deri në vitet '900. Debate të famshme mbi gjuhën dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin e gjuhës së sotme italiane do të diskutohen, duke dhënë një panoramë të shkurtër të jetës politike dhe kulturore në këtë periudhë.

**ITAL 365 Teori e Komunikimit:** Teoria e komunikimit i familiarizon studentët me përvojën bazë të folurit që ata do të hasin në profesion, në komunitet dhe në jetën e tyre shoqërore. Ata do të studiojnë teorinë e komunikimit, do të përmirësojnë aftësitë e të dëgjuarit, do të analizojnë audiencat, do të marrin pjesë në një seri aktiviteteesh gojore interpersonale dhe intrapersonale, do të organizojnë material të grumbulluar me punë kërkimore, do të dallojnë qëllimet pas çdo lloj fjalimi dhe do të japin prezantime të përshtatshme për të tilla qëllime.

**ITAL 375 Përkthim:** Ky kurs synon të rafinojë konceptet bazë dhe teknikat e përkthimit nga gjuha burimore në gjuhën e synuar, duke punuar me tekste letrare (poezi dhe prozë), tekste të stilit teknik dhe gazetaresk. Studentët do të ndërgjegjësohen në lidhje me aspektet strukturore të tekstit burimor dhe të tekstit të synuar me ndihmën e ushtrimeve praktike të përkthimit. Në fund të procesit të përkthimit do të ketë diskutime, sespe ato janë konceptuar si një analizë e problemeve të ngritura gjatë përkthimit nga origjinali. Këto ushtrime do t'i japin studentit mundësinë që të arsyetojnë mbi zgjedhjet e tyre dhe të mendojnë mbi rezultatet e arritura gjatë orëve të diskutimit. Motivimi i zgjedhjeve të bëra nga objektivat dhe rezultatet e strategjive të përkthimit, që nga mikroanaliza deri tek analiza e tekstit, do të përbëjnë themelet e mjeshtërive të tyre në përkthim.

**ITAL 381 Letërsi Italiane:** Ky kurs ka qëllim të shpalosë njohuritë themelore mbi historinë dhe antalogjinë e letërsisë italiane; aspektet themelore të një teksti letrar në një periudhë të caktuar, që nga Tasso deri në ditët e sotme, nëpërmjet analizës së veprave të rëndësishme letrare dhe dhënies së koncepteve të përgjithshme mbi zhvillimin e këtyre veprave letrare, interpretimi kritik dhe autonom i konceptit 'terza rima' mbi subjekte të përcaktuara në diskutime grupi.

**ITAL 398 Projekt Përfundimtar:**

## Fakulteti i Ekonomise dhe Drejtësisë

### 1. Departamenti i Administrim Biznesit

**ACC 113 Kontabiliteti per Fakultetin e Drejtësisë:** Kjo lende ka synim te pajise studentet me njohuri te reja dhe te thelluara ne fushen e kontabilitetit, perforcon dhe stabilizon njohurite per perberjen dhe ndertimin e PF individuale dhe te konsoliduara sipas rregullave te caktuara kontabel. -Thellohen njohurite dhe merren njohuri te reja ne lidhje me vleresimin, njohjen dhe rregjistrimin e veprimeve kryesore ne lidhje me aktivet, detyrimet, kapitalin e pronarit, te ardhurat dhe shpenzimet. Do te mund te sigurohen aftësite per organizimin e kontabilitetit per shoqerite e mesme dhe te medha si dhe per ndertimin e PF te tyre.

**ACC 211 Kontabiliteti:** (Moduli i Kontabilitet Financiar + Moduli i Kontabel Kosto dhe Drejtimi) Moduli i Kontabilitet financiar Pjesa e parë trajton hyrje në kontabilitetin financiar si ndihmë në marrjen e vendimeve Për përdoruesit e jashtëm të pasqyrave financiar. Studentët mësojnë si te masin dhe regjistrojnë të dhënat kontabël, përgatijten e pasqyrave financiare dhe analizimin e informacionin e publikuar te kontabilitetit financiar. Moduli i Kontabel kosto dhe drejtimi Pjesa e dytë e modulit trajton analizat e metodave kontabel duke siguruar të dhëna për marrjene e vendimeve menaxheriale optimale, zbatimin dhe kontrollin. Temat përfshijne shpërnadrjen e koston, marrëdhënien sasi dhe cmim për koston, kontabilitetin e koston se produktit dhe sistemin e kontrollit, buxhetimin e kapitalit dhe të operacioneve si dhe aspekte të përpunimit të informacionit.

**ACC 212 Parimet Baze te Kontabilitetit:** Ka synim kryesor te pajise studentet e vitit te dyte, dega biznes me njohurite baze ne fushen e kontabilitetit. Ne hartimin e programit eshte marre parasysh fakti qe studentet marrin njohuri per here te pare ne fushen e kontabilitetit dhe se kjo lende do te jete baza per lendet e kontabilitetit si : kontabiliteti financiar dhe kontabiliteti i koston dhe i drejtimit qe zhvillohen me vonë . Programi perfshin dhenien e njohurive ne lidhje me kuptimin dhe rendesine e kontabilitetit si sistem informacioni,organizimin e tij,pasqyrat financiare qe pergatiten nga ky sistem,mjetet dhe metodat baze te përpunimit te te dhenave,rregjistrimin e veprimeve ekonomike,ndertimin e pasqyrave financiare dhe njohurite baze ne fushen e kontabilitetit te drejtimit dhe te koston.

**ACC 312 Kontabilitet Kosto-Drejtimi:** Qellimi i lendes eshte qe studenti te njohe koston e funksioneve te ndryshme te ushtruara prej njesive te ndryshme . Te percaktoje bazat e vleresimit te disa elementeve te bilancit ,te spjegojte rezultatet duke llogaritur koston e prodhimeve ,punimeve ,sherbimeve,per te llogaritur kontributet ne rezultatin e pergjithshem te njesise ekonomike . Te lehtesoje pergatitjen e llogarive parashikuese ,te ndjeke te kontrolloje realizimin

e parashikimeve të bera dhe të nxise veprimet që mundesojnë të veprohet mbi shmangiet e konstatuara. Sistemi I Kontabilitetit të Kostos dhe Drejtimit prodhon informacion për përdoruesit e brendshëm të tillë si menaxheret, drejtuesit, punetoret.

**COM 201 Komunikimi:** Objekt analize në këtë disiplinë do të jetë organizata me qëllimin e krijimit të një vizioni të ri për të dhe interpretimit të proceseve që ndodhin dhe formojnë atë nën dritën e parimeve të procesit baze të shoqërisë njerezore, atë të komunikimit. Lënda përmban njohuri dhe aftësi të pazevendësueshme të formimit manaxherial duke synuar orientimin operativ dhe zhdergjelltesinë në aplikimin e njohurive të marra në kursin e plotë të studimit të kryer gjatë katër viteve prej studenteve.

**ECN 170 Ekonomiks:** (Moduli Mikroekonomi + Moduli Makroekonomi) Moduli i mikroekonomisë Pjesa e parë siguron një hyrje në konceptet kryesore të mikroekonomisë. Ajo egzaminon operacione të tregjeve, teorinë e kërkesës konsumatore, elasticitetit, organizimi i firmës, prodhimi dhe kostoja në periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë, konkurrenca, faktorët e jashtëm, dështimet e tregut, mjedisi ligjor dhe rregullues i biznesit dhe ekonomiksi ndërkombëtar. Moduli i makroekonomisë Pjesa e dytë egzaminon një shkallë të gjerë të koncepteve makroekonomike siç është përcaktimi i të ardhurave kombëtare, fluktacione në ekonomi, politikat fiskale dhe monetare, paraja dhe bankingu, inflacioni dhe papunësia dhe ekonomiksi ndërkombëtar. Po ashtu në këtë pjesë përfshihen dhe disa koncepte mikroekonomike si për shembull skarciteti, kosto oportune, kërkesa dhe oferta dhe proceset e tregut.

**ECN 272 Ekonomiksi Manaxherial:** Eksploron teorinë mikroekonomike dhe aplikimin e saj në vendim-marrjen manaxheriale. Egzaminon sjelljen konsumatore, vlerëson koston dhe prodhimin, optimizimin, vendosjen e cmimeve në tregjet konkurrenciale dhe jo-konkurrenciale, vendimmarrja në kushte pasigurie dhe buxhetimi i kapitalit.

**FIN 315 Ekonomi dhe Organizim Ndermarrje:** Lënda "Ekonomi dhe Organizim Ndërmarrje", në 60 seanca teoriko-aplikative, studion aspektet ekonomike të aplikimeve inxhinierike; konceptet themelore të ekonomisë, koston, kontabilitetit dhe manaxhimit; formulat e interesit dhe të llogaritjes së ekuivalencës; analizën ekonomike të procesit vendimmarrës ndërmjet alternativave të ndryshme projektuese; estimacionin e vendimmarrjen në kushtet e riskut e të pasigurisë; analizën ekonomike të manaxhimit operacional.

**ECN 371 Analiza e Modeleve Ekonometrike:** Lënda trajton vlerësimin dhe testimin e modeleve ekonomike duke përdorur teknikat e regresionit. Lënda Analiza e Modeleve Ekonometrike është një zhvillim i mëtejshëm i metodave të përpunuara nga statistika, të bazuara në aritmetikën e matematikës së zbatuar. Vendosja në programin e lendeve të Degës së Administrimit Biznesit justifikohet me faktin që modelet ekonometrike janë mjaft të rëndësishme si për ekonomistët e mëdhenjë dhe për politikberesit, ashtu edhe për ekonomistët e thjeshtë. Për një formim me të plotë profesional do të ishin të nevojshme dhe njohuritë që do të mërnin nëpërmjet kësaj discipline.

**ECN 372 Ekonomiks Pune:** Qëllimi i kësaj lende është të njoh studentet me njohuritë e kërkesës së punës, ofertës së punës, ekuilibrit të pagave dhe oreve të punës, papunësinë dhe tipet e saj. Lënda sqaron strukturat e ndryshme të

tregjeve te punes dhe ekuilibrat ne keto tregje. Mbas perfitimit te njohurive te Ekonomiksit te Punes studentet thellojne dhe njohurite e marra ne lendet e meparshme si Hyrje ne Ekonomii, Mikroekonomi, Makroekonomi. Duke qene lende me zgjedhje ajo tenton qe me njohurite qe percjell te rrise formimin profesional te studenteve te deges Biznes dhe te rrise kompetivitetin e tyre ne tregun e punes.

**FIN 222 Financa :** Lenda trajton gjeresisht elementet baze te finances manaxheriale. Studentet ne pjesen e pare (Bazat e finances) do te njihen me sistemin financiar ne gjithe gjeresine e perberesve te tij, do te analizohen menytrat e financimit te ndermarrjes do te marrin njohuri mbi tipet e ndryshme te letrave me vlere, funksionimin e institucioneve financiare, koston e kapitalit, buxhetimin e kapitalit. Pjesa e dyte (Drejtim Financiar) fokusohet mbi njohuri te thelluara te finances manaxheriale te cilat kane te bejne me elementet baze te drejtimit financiar, si teknikat e buxhetimit te kapitalit, analiza dhe strukturat financiare, koston e kapitalit, drejtimin e kapitalit punues, dhe drejtimin financiar nderkombetar.

**FIN 321 Investime:** Ne kete lende u kushtohet nje rendesi e vecante tregjeve te investimeve. Ne te studiohet tregu i aksioneve, obligacioneve, tregjet e opsioneve, tregjet e kontratave te ardhsheme si dhe tregjet e pasurive te palujtshme. Nje rendesi e vecante i kushtohet strategjive te investimeve dhe mbrojtjes nga risku. Diversifikimi, arbitrazhi, maksimizimi i fitimit jane pjese te rendesishme te kesaj lende. Analiza e portofolit dhe menaxhimi i riskut japin nje pergjigje jo vetem per studentet por dhe per te gjithe te interesuarit ne keto fusha.

**FIN 322 Institucionet Financiare dhe Tregjet e Kapitalit:** Kjo lende fokusohet ne strukturen dhe operacionet e ndermjetesve financiare, ne analizat e instrumentave inovative financiare Analiza e tregjeve financiare dhe menaxhimi i riskut te normave te interesit do te zene nje vend te vecante.

**FIN 323 Paraja dhe Banka:** Kjo lende eshte nje permbledhje e leksioneve rreth parase, bankes, dhe tregut financiar. Kjo lende eshte shume e rendesishme sepse trajton tema qe kane lidhje te drejtperdrejte me jeten tone te perditshme dhe me vendimet qe ne marrim. Gjithashtu na jep ne mundesine per te kuptuar ne menyre te qarte fenomenet ekonomike qe diskutohen neper media te cilat jane te reja dhe fazat neper te cilat kalojne jane ne hapat e pare. Objektivat e kesaj lende jane qe tu pergjigjen pyetjeve si: Cilat jane lidhjet ndermjet sektoreve real dhe financiar, "Cfare influencone sektorin financiar dhe ate real?", " Cilat jane politikat qe mund te perdoren qe sektori real te influencoje ne ate financiar, domethene se si nje produkt influencohet nga manipulimi i lekeve qe ofrohen."

**HRM 242 Manaxhim i Burimeve Njerezore:** Manaxhimi i Burimeve Njerezore eshte i rendesishem per cdo firme private si dhe per cdo institucion shteteror. Nese ne organizate ne kontribojme ne zgjedhjen e mire te burimeve njerezore, ne formimin dhe ne mbajtjen e tyre ne organizate ne ndikojme ne rritjen e vleres se pergjithshme te produktit te cilen organizata ofron si dhe ne qendrueshmere ose uljen e koston se pergjithshme. Ne kete menyre per cimin e ofruar ne i lejojme organizates qe nepermjet strategjive te saj te ndikojne ne fitimet e organizates si dhe te pjeses te cilen klientet perfitojne ne organizate.

**MGT 141 Manaxhim Biznesi:** Lenda e Manaxhim Biznesi zhvillohet ne vitin e pare te deges Biznes dhe synon te trajtojte mundesite dhe sfidat me te cilat perballet sot menaxhimi. Mundesite me te medha per rritjen e efektivitetit

ne kuadrin afatgjate dhe jo vetem ne biznes gjenden tek vete puna dhe para se gjithash tek cilesia e manaxhimit. Eshte pikerisht manaxheri ai qe me punen e tij percakton nese organizata funksionon sipas parashikimeve dhe nese shfrytëzime racionalisht apo i keqperdorim talentet dhe burimet disponibel. Ne kete lende do te trajtohen ceshtje te tilla si planifikimi , organizimi, motivimi, udhëheqja dhe kontrolli.

**MSI 201 Sisteme te Informacionit te Manaxhimit:** Kjo lende ben nje hyrje te koncepteve baze te MIS . Lenda perfshin njohuri te tipeve te sistemeve , te perpunimit te transaksioneve, DSS, hardware , software, networkeve, manaxhimit te te dhenave etj.Kjo lende synon te transmetoje njohuite sesi teknologjia e informacionit mund te perdoret ne zgjidhjen e problemeve te biznesit. Menaxhimi i sistemeve te informacionit ne turizem ( MIS) Lenda Sisteme te Informacionit te Menaxhimit eshte nje lende qe nderthur dy fusha te rendesishme ne jeten e sotme te organizatave, Sistemet e Informacionit me elementet e tyre perberes: hardëare, softëare, telekomunikim etj. dhe Menaxhimin. Veçantia e kesaj lende eshte se ka nje aspekt praktik shume te gjere i cili gjendet ne jeten e perditshme te njerezve sot ne vendet e zhvilluara, por po behet gjithnje e me prezente edhe ne vendet ne zhvillim, madje shihet ketu si nje instrument per ecjen perpara te tyre. SI ne turizem ka vecantite e veta, sidomos ne aspektin aplikativ. Ne dy dege te industries se turizmit, ate te pritjes dhe industrine e udhetimit, temat do te perqendrohen jo vetem ne aspekete e pergjithshme te sistemeve ne turizem dhe tippet e tyre, por edhe ne aplikimet e ndryshme ne keto dy fusha. Njohurite e softëareve speciale, te cilet jane te bazuar kryesisht ne menaxhimin e bazave te te dhenave dhe rrjetat, do te pasurojne kete kurrikule.

**MGT 335 Manaxhim Strategjik:** Kjo lende mbulon konceptet , metodologjine dhe mjetet analitike te perdorur nga manaxheret per te formuluar dhe implementuar strategjine e nje firme. Kjo lende gjithashtu eksploron kompleksitetin e mjedist te brendshem dhe te jashtem te firmes dhe aplikon njohurite marra nga ekonomiks, finance , POM Marketing < Burime njerezore dhe sjellje organizative per te kuptuar sjelljen konkuruese te firmes dhe performancen e firmes.Lenda synon te njoh studentet me konceptet e manxhimit strategjik dhe aplikimin e tyre si dhe te analizoje hollesisht procesin e planifikimit strategjik.

**MGT 402 Marrje, Optimizim Vendimesh:** Lenda e Marrje dhe Optimizim Vendimesh eshte pjese e kurrikules se deges Biznes Kjo lende synon tju ofroje studenteve njohuri mbi marrjen e vendimeve manaxheriale dhe perdorimin e teknikave sasiore dhe metodave cilesore ne marrjen e vendimeve.Lenda ju ofron studenteve njohuri mbi procesin e marrjes se vendimeve.Lenda e trajton procesin si nje proces nderdisiplinor dhe I integruar, duke perfshire shkencat e sjelljes dhe metodat sasiore.Lenda,ju krijon mundesine studenteve , manaxhere te ardhshem , te bejne vleresim alternativash, dhe te marrin vendime eficente .Lenda synon rritjen e profesionalizmit te manaxhereve te ardhshem ne perdorimin e teknikave sasiore dhe cilesore te vendimarrjes.

**ORG 230 Sjellje Organizative:** Krijimi i nje vizioni te integruar per organizaten dhe komponentet e saj, analizimi dhe kuptimi i lidhjeve, ngritja dhe perdorja e teorive per spjegimin dhe parashikimin e sjelljes se anetareve, grupeve si dhe reagimit te strukturave, jane mekanizmat dhe njohurite me te cilat zgjerohet bagazhi i drejtuesve te ardhshem te cilet ndjekin kete disipline. Ata jo vetem jane ne gjendje keshtu te njohin me mire organizatat e tyre por kompletohen me nje sere aftesish te cilat do ti ndihmojne te permbushin teresine e pergjegjesive

qe rrjedh nga pozicioni i tyre ne organizate, te cilat konvergojne ne permiresimin e performances se pergjithshme te saj permes nje perfshirje me te gjere dhe te frytshme te anetareve te saj.

**ORG 331 Lidershipi dhe Performanca e Grupit:** Lenda do te trajtoje nje ekzaminim te plote te te teorive te lidershit. Lenda do te vere theksin tek arritjet dhe aplikimet e teorive ne rastet e studimit qe perfshijne sjelljen e lidershit dhe funksionimin e grupit. Do te trajtohen tipet e ndryshme te lidershit, kakarakteristikat qe duhet te kete nje lider efektiv etj

**ORG 332 Marredheniet e Punes:** Marredheniet e punes do te analizojne relacionet e punes ne sektorin privat dhe publik. Ceshtjet kryesore do te perfshijne partneret social si shteti, punedhenesit dhe punemarresit. Evolucioni i sindikatave, organizimi aktual dhe drejtimi i tyre, do te gjenin nje pasqyrim te vecante. Njekohesisht do te studiohen edhe marreveshjet kolektive te punes, politika publike te punesimit etj.

**ORG 336 Biznes Nderkombetar:** Lenda synon te trajtoje mundesite dhe sfidat me te cilat perballen sot menaxheret nderkombetar. Mundesite dhe sfidat qe hasin sot manaxheret nderkombetar jane me te medha dhe te larmishme se me pare. Rendesia e nje lende te tille rritet me nje mjedis mjaftes dinamik ku ndryshimet ekonomike, politike, juridike dhe sociale ne dhjetevjecarin e fundit jane te shumta. Ndryshimet ekonomike, politike dhe sociale qe kane ndodhur ne dhjetevjecarin e fundit kane komplikuar mjaft terrenin e biznesit nderkombetar.

**POM 343 Manaxhim Operacionesh:** Ne kete lende do te behet nje studim i plote mbi operacionet ne organizatat e prodhimit dhe te sherbimit. Do te trajtohen ceshtje te tilla si planifikimi kapaciteti, percaktimi i lokacionit, planifikimi i kerkesave per materiale, skedulimi dhe parashikimi. Keto ceshtje do te perfshijne aspekte te etike, ligjore dhe nderkombetare te ceshtjeve te mesiperme.

**LEG 152 Legjislacioni:** Ketu mbulohen tema te ligjeve per sektorin privat bazuar ne Kodin Tregtare. Kontratat, agjensite, pronat dhe sigurimet, transaksione te sigurta dhe letra tregtare. Detyrime legale te licensave profesionale.

**FIN 275 Ekonomi Transporti Detar:** Roli qe ka transporti ne ekonomi. Kerkesat e shoqerise se sotme ndaj transportit. Tregu i transportit, konkurrenca mes llojeve te transportit dhe metodat e percaktimit te tarifave. Karakteristikat e transportit te sotem detar dhe planifikimi i shfrytezimit te mjeteve ne transportin detar. Analiza e veprimtarise ekonomike te punes se flotes. Treguesite baze te efektivitetit ne transport, projektimi i transportit dhe kontratat ne transportin detar.

**STAT 122 Statistike e Zbatuar:** Eshte lende e formimit baze per studentet e Fakultetit te Ekonomise. Ajo synon t'u jape studenteve qofte metodologjine e nevojshme per zbatim praktik te fenomeneve te fushes ekonomiko-sociale, qofte nje formim kritik te domosdoshem per te bere perzgjedhjen e metodave me te pershtashme, si dhe per modifikimin e mundshem te vete metodave, me qellim pershtatjen e tyre per rastet konkrete.

## 2. Departamenti i Turizmit

**HT 214 Ekonomiks i Transportit:** Kjo lende trajton koncepte te menaxhimit te kerkeses dhe ofertes se transportit turistik, rolin e qeverise dhe politikave

publike ne krijimin e lehtesirave per permiresimin e elementit baze te produktit turistik.

**HT 215 Bazat e Kulinarise:** Njerezit thone se bota po behet me e vogel. Sigurisht, Bota nuk po "hyn ne uje", por udhetime me te rehatshme, familjariteti me njerezit nga toka te largeta, dhe nje komunikim efektiv bejne qe destinacionet me te largeta te duken me te aferta. Qellimi i kesaj lende eshte te sigurohet nje kuader i kuzhinave te perdorura net e gjithë boten duke paraqitur informacion rreth ushqimit dhe kultures po aq mire sa edhe per recetat. Shpjegimi fokusohet mbi zhvillimin e seciles kuzhine, duke bere si rrjedhim qw evoluimi te duket logjik ashtu edhe natyror.

**HT 221 Baza Turizmi:** Lenda "Bazat e Turizmit" ka si qellim kryesor te jape nje informacion te pergjithshem mbi fenomenin turistik. Objekti I kesaj lende eshte kuptimi i dukurise turizem, perkufizimet dhe llojet e tij, kuptimi I turizmit si system, faktoret e zhvillimit te turizmit dhe funksionet e tij, aspektete ekonomike dhe joekonomike t eturizmit, modele te zhvillimit si dhe aspekte te se ardhmes dhe zhvillimit te qendrueshem.

**HT 223 Turizmi Kulturor dhe Trashegimia:** Lenda "Turizmi Kulturor dhe Trashegimia" qe zhvillohet ne degen e turizmit te Fakultetit te Ekonomis dhe Drejtesis permbledh nje cikël te gjere leksionesh, ne te cilen studentet marrin njohuri mbi qyteterimin e hershem te popujve dhe zhvillimin bashkohor te kultures se tyre. Studentet kane interes te vecant ne kete lende per faktin se zhvillimet e sotme turistike kryesisht ne Mesdhe, Europe, dhe vende te tjera jane ngritur mbi nje varg vendebanimesh, qendrash arkeologjike, muzeale, historike, etnografike, institucionale dhe kulturore te cilat jane te pranishme ne zhvillimet turistike. Krahas turizmit detar dhe malor kjo pasuri kulturore dhe monumentale shfaq ne syte e turisteve interesa mjaft te gjera te tyre per te mesuar per historin, kulturen dhe jeten e popujve .

**HT 235 Gjeografi Turistike:** Nisur nga fakti per rendesin qe ka kudo ne bote turizmi si nje nga aktivitetet me te rendesishme te ekonomise boterore dhe me efekte te shumanshme ekonomike, sociale, mjedisore etj. Rendesin po merre edhe studimi gjeografik i turizmit, e pasqyruar edhe ne aspektin e brendise. Kjo per faktin se gjeografia eshte shkencë qe studion ne lidhje dhe bashkveprim gjith problemet qe kane te bejne me zhvillimin e turizmit, duke vendosur sidomos theksin ne analizen e transformimeve mjedisore, ekonomike, kulturore e sociale qe pesojne apsirat gjeografike si rezultat i zhvillimit te turizmit ne to.

**HT 243 Ekonomiksi i Turizmit:** Lënda "Ekonomiksi i Turizmit" është programuar për studentët e vitit të tretë të degës së Turizmit. Materiali didaktik i përdorur për këtë lëndë ka për qëllim të përgjigjet nevojës për sistemimim e Ekonomisë së Turizmit, lindur nga kërkesat e ekonomistëve si edhe administratorëve privat dhe publik të okupuar në sektorin e Turizmit. Kjo nevojë synohet të plotësohet si duke trupëzuar idetë e lindura nga vëzhgimi i një fenomeni shumë të pasur me fakte ekonomike siç është turizmi, ashtu edhe duke seleksionuar nga Ekonomia Politike dhe Politikat ekonomike ato modele teorike të cilat mund të ofrojnë skema të vlefshme interpretative të sjelljes së tregjeve turistike. Materiali është i ndarë në tre pjesë: Pjesa e parë, e konsideruar si hyrëse trajton definicionet e nevojshme për konturimin dhe matjen e përmasave të fenomenit turistik, proces ky i veshitire per nje sektor te tille. Në të kundërt, dy të tjerat i referohen modeleve interpretative. Pjesa e dytë trajton konceptet



mikroekonomike të turizmit; (konsumi, kërkesë-oferta, prodhimi dhe tregu turistik). Pjesa e tretë trajton konceptet kryesore makroekonomike; (kontabiliteti kombëtar, e ardhura dhe zhvillimi kombëtar, turizmi ndërkombëtar dhe roli i shtetit në zhvillimin e tij).

**HT 290 Ndermarrjet Turistike Pritese:** Lenda ofron nje vizion te gjere mbi aktivitetin e ndermarrjeve qe operojne ne sektorin turistik, duke u perqendruar ne veprimtarine e ndermarrjeve pritese te strehim-akomodimit dhe ndermarrjet e restorantere. Tipologjite dhe klasifikimet e ketyre ndermarrjeve, repartet kryesore operative dhe pergjegjesite e punes per secilin prej tyre do t'i pajisin menaxheret e ardhshem te turizmit me njohuri baze mbi funksionimin e ketij sektori. Po keshtu, perqendrimi ne termat cilesore te sherbimeve akomoduese dhe politiken konkurruese te cmimeve do jene ne funksion te pozicionimit dhe diferencimit te ndermarrjeve te kesaj tipologjie ne industrine turistike.

**HT 311 Shoqerite Ajrore:** Lenda jep njohuri per shoqerite ajrore si anetare te Shoqates Nderkombetare te Transportit Ajror (IATA). Ajo synon te njohe studentet me rregulloren e IATA-s, kodet e perdorura ne te gjithë boten per shoqerite ajrore, qytetet, shtetet, llojet e udhetimeve, ndertimin e çmimeve per keto lloje udhetimesh, si dhe njohurite per plotesimin e biletës standarte qe perdoret ne industrine e transportit ajror. Eshte nje lende e cila ndihmon studentet per te marre njohurite e nevojshme per punen ne nje shoqeri ajrore dhe /ose agjensi turistike.

**HT 312 Rezervimi ne Ndermarrjet Turistike:** Lenda jep njohuri per procesin e rezervimit ne ndermarrjet turistike (hotele, shoqeri ajrore, agjensi turistike). Ajo synon te njohe studentet me procedurat e rezervimit ne keto ndermarrje, jep njohuri per llojet e ndryshme te rezervimit, raportet qe dalin nga ky proces, shume te rendesishme per menaxhimin e nje ndermarrjeje, sistemet kryesore on-line dhe zhargonin apo kodet e perdorura ne kete fushe.

**HT 321 Sjellje e Konsumatorit Turist:** Kjo lëndë trajton studimin e faktorëve që influencojnë sjelljen konsumatore, përdorimin strukturor dhe menaxherial të modeleve të marrjes së vendimit. Egzaminon variablat social, psikologjik dhe ekonomik të sjelljes blerëse duke përfshirë mësimin, motivimin, qëndrimin, personalitetin, dinamikën e grupeve të vogla, faktorët demografik dhe ekonomik si dhe kulturën.

**HT 351 Drejtimi i Ndermarrjeve Turistike Pritese:** Turizmi është një fenomen i karakterizuar nga një dinamizëm i lartë që ka lejuar një rritje shumë të madhe të këtij sektori vitet e fundit. Në këtë mënyrë ndërmarrjet turistike janë gjithmonë nën ndikimin e faktorëve që janë në ndryshim të vazhdueshëm, duke e bërë më kompleks aktivitetin e tyre dhe sidomos procesin e drejtimit. Kjo lende trajton në mënyrë të qartë dhe sistematike argumenta të shumtë që kanë të bëjnë me funksionimin dhe drejtimin e ndërmarrjeve turistike pritëse. Objektivi kryesor i saj është të bëjë të qartë në masën më të madhe të mundshme argumentat e ndryshëm të trajtuar, duke përdorur një gjuhë të përshtatshme me natyrën e argumentave dhe tërësisht të pranueshme për studentët e turizmit.

**HT 352 Ekonomi Ambienti:** Ekonomia e Ambientit synon t'ju japi njohuri studenteve si duhet ta perdorin ambientin natyror derisa ai te mund te luaj rolin e tij ne mbeshtetje te sistemit ekonomik qe eshte dhe burim i nje niveli me te mire te jetes. Lenda zhvillohet me studentet e vitit te katert turizem, pasi

kane mare njohuri te mjaftueshme per ekonomine dhe turizmin. Ne kete kuader njohja me burimet natyrore, karakteristikat e tyre dhe perdorimin efciente te tyre permirson ne menyre cilesore stokun dhe sherbimet e burimeve natyrore te cilat perbejne oferten turistike.

**HT 353 Psiko-sociologjia e Turizmit:** Kjo lende synon te ofrooje nje informacion komplet rreth ceshtjeve qe lidhen me elementet e rendesishem te biznesit dhe te botes afektive sociale te individit. Kjo do te konsiderohet si nje lehtesi per studentet per te patur me teper argumenta ne shpjegimin sipas tendencave dhe orientimeve te tanishme dhe moderne socio-psikologjike, fenomenet dhe ngjarjet e rejane turizem. Temat qe do te trajtohen ne kete lende do te pefshijne ceshtje qe prekin pjesen sociologjike te turizmit dhe aspektet me te rendesishme psikologjike ne eksperiencat dhe tendencat e turizmit.

**HT 354 Menaxhim i Destinacioneve dhe Udhetimeve Turistike:** Lenda synon t'u ofroje studenteve nje kulture turistike mbi destinacionet kryesore turistike, duke u fokusuar ne trajtimin dhe analizen e tre aspekteve kryesore te tyre: geografi turistike, histori arti dhe kulinari. Evidentimi dhe analiza e specifikave, resurseve dhe avantazheve te ketyre tre aspekteve te destinacioneve turistike do te plotesojne kuadrin e formimit profesional te studenteve te kesaj dege. Lenda synon te pajis menaxheret e ardhshem te turizmit me njohuri mbi operatoret kryesore te industries turistike duke u ndalur vecanerisht tek agjensite e udhetimit dhe tour operatoret si prodhuesit dhe shperndaresit kryesore te paketes turistik. Po keshtu ajo fokusohet ne etapat e formimit te paketes turistike, planifikimin, politikat e percaktimit te cmimeve dhe shitjen e paketes turistike si dhe politikat kryesore te marketingut miks turistik.

**HT 364 Strategji Turizmi:** Turizmi perben nje nga aktivitetet me te rendesishme sociale dhe ekonomike sot ne bote. Politikat jane ende nje komponent themelor shpesh i injoruar per zhvillimin e turizmit dhe studimet turistike. Perderisa turizmi perben nje aktivitet ende te ri per mjaft destinacione turistike, do te kete jo pak shembuj se si rritja e paplanifikuar dhe e pakontrolluar e turizmit mund te sjelle rezulatate negative dhe aspak te qendrueshme, te shoqeruara jo rralle me demtime te pakthyeshme te ambientit dhe vlerave social - kulturore te shoqerise. Qellimi i kesaj lende eshte realizimi i nje analize te plote te te gjithe procesit te vendimarrjes ne lidhje me zhvillimet aktuale dhe te ardhshme ne nivele kombetare e rajonale.

**HT 398 Projekti Final:** Projekti final do te realizohet mbi bazen e stazhit qe studentet e deges Turizem do te zhvillojne ne ndermarrje te ndryshme turistike. Mbi bazen e kontratave te lidhura me keto ndermarrje studentet do te kene nje periudhe stazhi prane departamenteve te ndryshme te ketyre ndermarrjeve dhe Zyrave te turizmit ne Bashkite e Qarkut Vlore dhe punimi i tyre do te fokusohet ne punen konkrete dhe problematiken e evidentuar nga vete ata.

**HT 401 Promocion Turizmi:** Kjo lende siguron nje baze ne marketingun e sherbimeve turistike dhe ne menyre te vecante ne variablat promocionale te tyre, duke ofruar gjithashtu mbeshetje per aplikimin e tij per ndermarrjet e sektorit turistik nga nje perspektive menaxheriale. Materialet bazohen me teper ne fokusin menaxherial, duke i orientuar menaxheret e ketij sektori drejt konsumatoreve, si pjese e produktit qe keto ndermarrje ofrojne. Lenda mbeshetet gjithashtu ne nje trajtim me te thelle te parimeve dhe koncepteve te ilustruara me shembuj nga industria hoteliere dhe ajo e udhetimit, duke treguar vendimet

kryesore me te cilat menaxheret e ketij sektori perballen ne perpjekjet e tyre per te pershtatur objektivat dhe burimet e organizates me diversitetin e nevojave konsumatore dhe tregun global.

**HT 421 Menaxhimi i Ngjarjeve dhe Konferencave:** Kursi paraqet nje eksplorim te rendesishem te parimeve qe aplikohen ne fushen e Menaxhimit te Konferencave dhe Ngjarjeve, qe po peson nje perhapje te shpejte. Ai i familjarizon studentet me aktoret kryesore si te kerkeses, ashtu dhe te ofertes ne fushen e industrise hoteliere dhe trajton rolin e PCO (Organizatat Profesionale te Kongreseve) ne pershtatjen e dy aneve te tregut dhe ne mbeshtetjen e aktiviteteve te tyre. Ato perdorin ekspertizen dhe njohurite e shume eksperteve aktive te industrise dhe mbulojne ceshtje qe radhiten qe nga planifikimi, organizimi, drejtimi dhe kontrolli, shoqatat nderkombetare dhe rolin e tyre dhe probleme korrente nderkombetare ne menaxhimin e ngjarjeve dhe konferencave.

**HT 422 Menaxhimi i Kohes se Lire:** Leksionet trajtojne ne menyre te permblendhur lidhjen e pamohueshme te turizmit me sociologjine dhe psikologjine, pasi inisiativa per levizje dominohet ndjeshem nga nxitje te brendshme, nga pritshmeri te karakterit psikologjik apo social, nga preferenca e shije, motivime e terheqje emocionale ndaj vendeve, burimeve natyrore e kulturore te caktuara, me teper sesa nga deshira per te konsumuar. Relaksi fizik, psikik e shpirtoror jane tendencat kryesore qe i shtyjne njerezit te levizin; elementet e cilesite e shoqerise e kultures se masave, krijojne karaktere te vecanta te strukturave pritese e mbeshtetese, te cilat jane themeli i imazhit turistik per klientelen turistike, si pjese e fenomenit, por edhe per vete vendet e zonat e destinuar per turizem. Njohja e elementeve te sociologjise e psikologjise, ndihmon klientelen qe te jete e selektuar bindshem per motivet dhe destinacionet e levizjes, tregon raporet e mundshme midis turisteve e banoreve vendas, si dhe ndihmon vete stafin e punesuar ne industrine e turizmit, ne njohjen e situatave, individeve, teknikave te sjelljes e qendrimeve, per te qene te pozicionuar suksesshem nga pikpamja humane dhe ekonomike.

**MIS 301 Menaxhimi i Sistemeve te Informacionit ne Turizem:** Lenda Sisteme te Informacionit te Menaxhimit eshte nje lende qe nderthur dy fusha te rendesishme ne jeten e sotme te organizatave, Sistemet e Informacionit me elementet e tyre perberes: hardëare, softëare, telekomunikim etj. dhe Menaxhimin. Veçantia e kesaj lende eshte se ka nje aspekt praktik shume te gjere i cili gjendet ne jeten e perditshme te njerezve sot ne vendet e zhvilluara, por po behet gjithnje e me prezente edhe ne vendet ne zhvillim, madje shihet ketu si nje instrument per ecjen perpara te tyre. Si ne turizem ka vecantite e veta, sidomos ne aspektin aplikativ. Ne dy dege te industries se turizmit, ate te pritjes dhe industrine e udhetimit, temat do te perqendrohen jo vetem ne aspekete e pergjithshme te sistemeve ne turizem dhe tippet e tyre, por edhe ne aplikimet e ndryshme ne keto dy fusha. Njohurite e softëareve speciale, te cilet jane te bazuar kryesisht ne menaxhimin e bazave te te dhenave dhe rrjetat, do te pasurojne kete kurrikule.

**MKT 231 Marketing :** Pjesa I: Lenda bazat e marketingut analizon principet e marketingut, konceptet marketing, tendencat dhe mardheniet e tyre me principet e tjera te biznesit. Nje rendesi te vecante i eshte dhene studimit te marketingut miks. Temat konkretizohen me raste studimi nga industria e e mikpritjes.

Pjesa II: Nje studim i aplikimeve te principeve te arketingut, koncepteve, dhe strategjive ne zgjidhjen e problemeve te biznesit dhe problemeve te tjera qe paraqitet ne ekonomine e sotme. Perdorimi i rasteve te studimit nga industria e

mikpritjes per te analizuar keto problem. Thekson manaxhimin e marketingut permes planifikimit, zbatimit dhe kontrollit.

**MKT 331 Drejtim Marketing ne Ndermarjet Turistike:** Drejtimi Marketing per ndermarjet Turistike" zhvillohet ne vitin e dyte te deges Turizem dhe ndjek " Bazat marketing". Synon te jape nje formim te pergjithshem per menyren e manaxhimit te aktiviteteve marketing qe ndermerren nga kompanite,ne menyre te vecante nga kompanite ne industrine e Turizmit nepermjet raste konkrete, me qellim kenaqjen e konsumatorit dhe arritjen e objektivave te tyre per te qene sa me kompetitiv ne treg.

**MKT 410 Kerkim Marketing:** Kjo lende siguron studentet me njohuri bazë për kërkimin marketing, si një nga fushat e marketingut që ndihmon ndërmarrjen të mbledhë informacion të shumëllojshëm dhe të domosdoshëm, ta përpunojë dhe ta analizojë atë për të nxjerre përfundime në shërbim të menaxherit marketing. Ne boten e sotme informacioni ka shume rendesi dhe kerkimi marketing eshte nje fushe e marketingut qe siguron input per strategjine dhe per te gjithë menaxheret ne kompani.

**MKT 411 Marketing Sherbimesh:** Kjo lende siguron nje hyrje ne marketigun e sherbimeve. Trajton me teper anen manaxheriale sesa ate taktike dhe paraqet ato elemente dhe ceshtje strategjike qe jane konsideruar si me te rendesishmet per marketingun e sherbimeve.

**MKT 412 Marketing i Tregjeve Te Biznesit:** Studion mardheniet midis bizneseve ne blerjen dhe shitjen e te mirave qe lehtesojne procesin e prodhimit, ose jane perdorur si komponente ne prodhimin e te mirave nga firmat blerese. Fokusohehet se si vendimet marketing midis bizneseve duhet te behen ne realizimin e nje shitje ne nje mjedis biznesi.

**Etike Dhe Komunikim:** Objekt analize ne kete disipline do te jete perseri organizata me qellimin e krijimit te nje vizioni te ri per te dhe interpretimit te proceseve qe ndodhin dhe formojne ate nen driten e parimeve te procesit baze te shoqerise njerezore,ate te komunikimit.Nisja e kesaj analize nga niveli baze i saj,pra duke e pare komunikimin si nje proces human,do te ndihmoje ne hedhjen e themeleve te qendrueshme per gjithë hulumtimet dhe abstragimet e mepasshme te cilat synojne pajisjen e menaxherit me njohuri te domosdoshme,aftesimin e tij ne perdorimin e ketyre njohurive duke i dhene gjithë sistemit fleksibilitet,qendrueshmeri ne vlera dhe aftesi pershtatese me te medha.Lenda permban njohuri dhe aftesi te pazevendesueshme te formimit manaxherial duke synuar orientimin operativ dhe zhdervjelltesine ne aplikimin e njohurive te marra ne kursin e plote te studimit te kryer gjate kater viteve prej studenteve.

**MKT 418 Shperndarje Dhe Drejtim i Forces Shites:** Në ekonomitë e sotme shumë prodhues nuk i shesin produktet e tyre direkt tek përdoruesi final.Mes tyre qëndrojnë një sërë ndërmejtësish marketing në performancën e të cilëve evidentohen role dhe funksione shumë të rëndësishmePërgjatë shumë viteve koncepti marketing ka qënë i lidhur me dy procese të ndryshme,por ngushtësisht të lidhur mes tyre,të qënit në kërkim të klientëve të rinj dhe shpërndarja fizike e të mirave. Por ky proces kërkon shumë më tepër se një mjet marketingu në shërbim të kompanive.Zhvillimet e vazhdueshme kanë zgjuar interesin e manaxhimit mbi

logjistikën, e cila udhëheq zgjidhjen e problemeve të lidhura me shërbimin konsumator, përballimin e konkurrencës dhe reduktimin e kostove. Të gjitha hallkat e sistemit të shpërndarjes përballen me nevojën e organizimit të forcës shitëse dhe adaptimin e saj si një mjet marketingu. Objektivat e vendosura për forcën shitëse influencojnë strategjitë dhe taktikat e vendimtarjes për një shitje efektive.

**MKT 419 Marketing Nderkombetar:** Ky kurs kërkon të plotësojë nevojat e studenteve me njohuri mbi çështje të ndryshme të marketingut nderkombetar. Ai thekson rëndësinë që ka strategjia e Marketingut Nderkombetar për suksesin e kompanisë në tregun nderkombetar. Ky kurs i jep informacion studenteve mbi mjedisin nderkombetar, në mënyrë që ata të jenë të orientuar për të gjitha aspektet e tij. Dimensionet ekonomike, politike, ligjore, kulturore, sociale, teknologjike etj., janë të integruar sëbashku dhe janë elemente të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në aspektin makro për kompaninë dhe menaxheret që operojnë në tregun nderkombetar. Por jo vetëm kaq, edhe elemente të vetë kompanisë si edhe të strategjisë së saj në mjedisin nderkombetar janë objekt i këtij kursi.

**MKT 421 Sjellje Konsumatore :** Është një disiplinë e aplikuar që kontribuon në kuptimin e konsumatoreve. Orientimi i saj ekonomik bazohet në studimet marketing. Lënda jep modelin më të avancuar për të kuptuar marrjen e vendimeve konsumatore, gjë që shërben si një program për suksesin e bizneseve në ekonominë e tregut. Ajo përqendrohet në atë se "Perse" dhe "Si" konsumatorët marrin vendime të vecanta dhe sillen në mënyrë të caktuar, çfarë i motivon ata, çfarë terheq vëmendjen e tyre, çfarë i bën ata shpesh të jenë besnikë të produkteve, shërbimeve dhe markave të vecanta. Sjellja konsumatore përshkruhet si proces i zhvillimit të produktit, të shërbimeve, dhe strategjive të bazuara në atë që konsumatorët dëshirojnë.

### 3. Departamenti i Drejtësisë

**DRE 110 E Drejta Romake:** Studimi në fillim përqendrohet në konceptin "E drejta romake", qëllimi i studimit, sistemet e studimit. Studimi vazhdon me historikun e zhvillimit të së drejtës romake. Më tej studion normat juridike, disa të drejta si: e drejta familjare, e drejta reale, e drejta e detyrimeve etj.

**DRE 120 Historia e Institucioneve:** Objekti i studimit të lëndës janë institucionet dhe drejtimit metodologjike të studimit të tyre, karakteristikat e institucioneve. Studimi i institucioneve si në Greqinë dhe Romën e lashtë. Studimi i institucioneve moderne, bashkëkohore dhe rëndësia e këtyre institucioneve.

**DRE 130 E Drejta Civile:** Është një nga disiplinat më të rëndësishme për formimin e baze profesionale të një juristi të ri. Trajtohen parime, institute, marrëdhënie civile, objektin, subjektin dhe përmbajtjen e saj.

**DRE 140 E Drejta Kushtetuese:** Objekti i kësaj lënde shtrihet jo vetëm në studimin e institucioneve politike e të sistemit normativ, por edhe studimin e të drejtave dhe lirive themelore si dhe mbrojtjen e tyre. Ky studim kryhet sidomos në dimensionin e të drejtës së brëndshme kushtetuese, por ai perceptohet edhe në planin krahasues dhe atë nderkombetar.

**DRE 150 E Drejta Publike:** E drejta publike studion ligjet e lindjes dhe zhvillimit të shtetit dhe së drejtës, ligjesh hoqerore që përcaktojnë vetitë, karakteristikat

dhe tiparet specifike te shteti dhe se drejtes si edhe lidhjen e dnikimt te nder-sjelltet e tyre. Ajo shtjellon konceptet themelore te shkencave te tjera te shtetit dhe se drejtes te cilat shtjellohen me tej ne lendet e tjera juridike te programit te Fakultetit te Drejtesise

**DRE 210 E Drejte Penale,pjesa e pergjithshme:** E drejta penale eshte nje nga disiplinat themelore dhe me interesante e mbeshtetur ne kodin penal,ne rrjedhen e disiplinave te tjera juridike.Karakteristike e saj (E pjeses se pergjithshme) eshte shpjegimi i vepres penale,elementet e domosdoshem te saj,marrdheniet shoqerore qe cenohen,kuptimi i fajit,dhe rendesia e denimit penal,menyres se caktimit te tij,rrethanave lehtesuese dhe renduese etj.

**DRE 220 E Drejta Familjare:** E drejta familjare e bazon studimin e saj ne Kodine e Familjes,ne ligjin "per disa ndryshime ne Kodin e Familjes" dhe ne ligjin "Per biresimet e te miturve nga shtetas te huaj dhe disa ndryshime ne Kodin e Familjes".Ajo studion institute te tilla si:Familja, martesat,pavlefshmeria e marteses,marrdheniet prinder-femije, zgjidhjen e marteses etj.

**DRE 229 E Drejta Publike e Krahasuar:** Objekti i saj eshte te studioje si dhe perse disa sisteme ligjore jane te ndryshme ose te ngjajshme. Synon te jape keshilla mbi politiken logjore.Kjo lende synon te tregojte si zgjidhet nje problem specifik ne kushte ekonomike dhe sociale specifike.

**DRE 230 E Drejta e Punes:** Synon te pajise studentet me njohuri juridike shkencore bashkekohore si dhe me pervojen perkatese te vendit tone e vendeve te tjera demokratike ne fushen e mardhenieve te punes.

**DRE 240 Lenda e Drejte Administrative:** Zhvillohet ne vitin ne dyte ne degjen e Drejtesise, si nje lende e detyrueshme. Objekti i saj shtrihet ne studimin e teresise se normve materiale dhe procedurale te se drejtes administrative,te organizimit dhe funksionimit te oragneve te administrates publike dhe te kontrollit qe ushtrohet mbi kete administrate, pergjate ushtrimit te funksioneve administrative.

**DRE 265 E Drejta Agrare:** Studion mardheniet juridike-agrare,lindjen dhe zhvillimin e prones tokesore ne Shqiperi ,rregjimin juridik te tokes bujqesore dhe asaj truall etj.

**DRE 270 E Drejta Penale,pjesa e posacme:** E drejta penale, pjesa e posacme trajton pjesen e posacme sipas Kodit te ri Penal,duke i dhene nje rendesi shume te madhe trajtimit te veprave penale kunder jetes se njeriut, krimet kunder njerezimit, veprat penale kunder prones, veprat penale kunder femijeve marteses dhe familjes, krimin e organizuar etj te gjitha keto vepra trajtohen me detaje duke i dhene mundesine studentit te vleresoje rast pas rasti nese ndodhet para kryejres se nje vepre penale.

**DRE 275 E Drejte e Sigurimeve Shoqerore:** Synon te trajtojte parimet kryesore mbi sigurimin shoqeror,konceptin e perfitimeve nepermjet llojeve te pensioneve,si dhe perfitimet e tjera qerrjedhin nga kontrata e sigurimit shoqeror dhe shendetesor.

**DRE 277 Teknike Legjislative:** Teknika legjislative si nje disiplin e vecante studion instrumentat ligjor pernje komunikim me te mire. Synon te jape nocione te qarta studentit mbi qartesine e permbajtjes se normave ligjorese dhe mjetet kryesore te hartuesit per permiresimin e permbajtjes thelbesore.

**DRE 278 E Drejte Kushtetuese e Krahasuar:** Lënda nëpërmjet një qasjeje krahasuese paraqet të drejtën kushtetuese në demokracitë e mëdha evropiane, tiparet e saj në vendet e Evropës Lindore dhe në Ballkan, analizon parimet kryesore të qeverisjes, aktet normative, dhe kontrollin kushtetues të akteve normative në këto vende, mënyrat e qeverisjes vendore.

**DRE 280 E Drejta Fianciare:** E drejta financiare eshte nje plotesim i metejshem i njohurive te studentit persa i perket te drejtes civile dhe aplikimit te saj ne jeten e perditshme, vecanerisht ne raportet qe krijohen midis shtetit dhe subjekteve te tjera te se drejtes,persa u pwerket detyrimeve qe keta te fundit duhet te paguajne ne formen e taksave dhe tatimeve.

**DRE 281 Te Drejtat e Njeriut:** Kjo lende studion ne menyre te thelluar dhe ne menyre krahasuese lirite dhe te drejtat e njeriut.Ajo studion historikun e zhvillimit te te drejtave te njeriut,i studion ne aspektin kombetar dhe ne aspektin nderkombetar si dhe aktet kryesore nderkombetare.

**DRE 282 Logjika:** Lenda e logjikes eshte nje lende e fomimit te pergjithshem dhe e domosdoshme ne formimin e nje studenti te drejtesise.Logjika eshte shkencat qe studion menyren dhe ligjesite ndertimit drejt te mendimeve.Ne kete menyre eviton paqartesite. Ndhimon ne kuptimin drejt te normave ligjore dhe per formate qe merr mendimi,si krijohet ai, konceptet, gjykimi dhe arsyetimi.

**DRE 285 E Drejta e Mjedisit:** Ka per objekt studimi kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise ne fushen e mbrojtjes se mjedisit. Si dhe sistemin institucional per mbrojtjen e mjedisit.

**DRE 310 Procedura Penale:** Kjo lende shpjegon teorikisht dhe praktikisht legjislacionin procedural penal,institutet dhe dispozitat qe rregullojne procesin penal net e gjitha fazat e tij.Ajo analizon shkencerisht sistemet procedurale penale, zhvillimin historic te legjislacionit procedural ne Shqiperi si dhe parimet demokratike me te cilat bazohet procedimi penal.

**DRE 320 E Drejte Procedurale Civile:** E drejta procedurale civile ka rendesi per formimin teorik dhe praktik te studentit. Studentet ne perfundim te ketij kursi do te kene njohuri te plota ne lidhje legjislacionin procedural civil si mbrojtjes i te drejtave te ligjshme te personave fizik e juridik.Do te njihen gjithashtu me fazat neper te cilat kalon nje proces gjyqesor civil,kuptimin e marredhenies juridike procedurale civile, subjektet, objekti dhe permbajtja e saj.Studenti do te pajiset me njohuri te se drejtes procedurale qe fillojne me legjitimin per ngritjen e padise,cilat jane mjetet e ankimit, si dhe fazen e fundit qe eshte ekzekutimi i nje vendimi gjyqesor te formes se prere.

**DRE 330 E Drejta e Detyrimeve:** E drejte e detyrimeve dhe kontratave eshte plotesimi i njohurive baze te specialistit te larte ne fushen e te drejtes civile,ne vecanti te pjeses se posacme te kesaj fushe,e cila ka te beje me marredheniet kontraktore ndermjet subjekteve te se drejtes,begatimit pa shkak dhe marredheniet e shkaktimit te demit.Kjo lende ndikon ndjeshem ne formimin

profesional te studentit dhe ne profilin e tij te ardhshem.

**DRE 340 E Drejta Nderkombetare Publike:** E drejta nderkombetare publike eshte disiplina qe i mundeson studentit njohuri te pergjithshme dhe specifike ne raportet nderkombetare midis shteteve,organizmave nderkombetare rajonal dhe universal dhe shtetasve, duke i dhene nje rendesi te madhe zhvillimit progresiv te ketyre raporteve,rendesise qe ato kane ne jeten e shteteve dhe shtetasve te tyre. Kjo disipline trajton ne nje pjese te rendesishme te saj dhe zgjidhjen e konflikteve nderkombetare dhe raportet diplomatike midis shteteve

**DRE 350 Kriminalistika:** Njohuritë që do të merren në lëndën e kriminalistikës,do tju shërbeje studentëve të Drejtësisë ne fushën e kërkimit,zbulimit,marjes fiksimit dhe ekzaminimit të provave materiale te lena nga autorët në vepra te ndryshme penale.Për këtë qëllim,vetë kjo lendë trajton mjetet teknike,taktike dhe rekomandimet metodike kriminalistike në përputhje me legjislacionin penal,atë procedural penal si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të ligjit.

**DRE 360 Avokatia ose Noteria:** Eshte nje nga disiplinat ku ben te mundur njohjen e studenteve me profesionet e lira dhe parimin e funksionit te tyre.

**DRE 361 E Drejta Tregtare dhe e Falimentimit:** Eshte qe studentet te kene njohuri te plota ne lidhje veprimtarine e tregtareve(persona fizik dhe juridik).Ne kete lende trajtohet menyra e krijimit dhe funksionimit te shoqerive tregtare llojet e ketyre shoqerive.Duke filluar me etapat e themelimit te shoqerive tregtare,administrimin e tyre,prishjen dhe likuidimin.

**DRE 365 Kriminallogji Penalogji:** Studion mendimin kriminologjik dhe rruget e zhvillimit te tij nepermjet shpjegimeve per kriminalitetin duke iu referuar teorive te ndryshme.Ka per objekt delikuenccen dhe viktimologjine.Vendin e viktimes ne sistemin e drejtesise penale,te drejtat e tij dhe asistencen qe ofrohet.

**DRE 370 E Drejta Europiane:** E drejta europiane komuniare eshte studimi juridik i bashkepunimit te zbatuar ne nje forme te vecante institucionale,fillimisht mes 6 vendeve te europes perendimore dhe me pas e shtrire ne shtete te tjera. Shqyrtimi i institucioneve aktuale europiane karakterizohet rendesia qe ato kane dhe nga kompetencat e gjera qe ushtrojne keto institucione brenda shteteve europiane.

**DRE 381 E Drejta Penale e Krahasuar:** Synon njohjen me standartette perparuara te drejtesise penalo-proceduriale qe realizohet nepermjet krahasimit te instituteve dhe te institucioneve kryesore te se drejtes penale bashkekohore te disa vendeve europiane dhe me gjere.

**DRE 388 Psikiatria Ligjore:** Studion problemet kryesore ne lidhje me eksperimentin psikiatriko ligjor gjate nje procesi,pergjegjshmerine dhe papergjegjshmerine ligjore.Po keshtu ben trajtimin e crregullimeve emocionale,organiko trunore, crregullime te personalitetit,parambetjen mendore etj.

**DRE 389 Mjeksia Ligjore:** Studion fenomenet traumologjike,kufomore ,toksikologjike, ,demitimet nga faktore te ndryshem,asfiksitate etj.Ne menyre specifike trajton menyren e kryerjes se ekspertimit mjeko-ligjor, si dhe mbajtjen e aktit te eksperimentit.



**DRE 398 Projekti Final:**



## Fakulteti i Shendetit Publik

**INF 101 Terminologji Mjekësore, Gjuhë e Hua:** Terminologjia mjekësore është një lëndë e formimit të përgjithshëm mjekësor në të cilën studentët marrin njohuri mbi termat më të përdorshme latine dhe greke, fjalëformimi në këto gjuhë, morfologji, formim I recetës si dhe përdorimi I tyre klinik.

**INF 102 Bazat Biologjike të Jetës:** Gjenetika është një lëndë në pjesën e parë të së cilës jepen njohuri mbi gjenetikën e përgjithshme, ndërsa pjesa kryesore okupohet nga gjenetika mjekësore, dhënien e njohurive bashkëkohore mbi transplantet e organeve, këshillimin gjenetik, farmakogjenetikën, ndikimin e radioaktivitetit në organizmin e njeriut etj.

**INF 110 Shkencat Humane Bazë:** Etika studion tërësinë e normave morale që karakterizojnë sjelljen e infemierit gjatë ushtrimit të profesionit. Ndërsa deontologjia studion tërësinë e normave dhe pikpamjeve juridike që rregullojnë mirë ushtrimin e profesionit të infemierit të drejta dhe detyrimet funksionale në kuadrin e një shoqërie që nga ana e saj rregullohet nga e drejta, ligji dhe morali. Psikologjia mjekësore është e ndarë në 2 pjesë: Psikologjia e përgjithshme dhe Psikologjia klinike.

**INF 120 Shkencat e Parandalimit:** Shëndeti mjedisor trajton informacionin e formimit profesional në fushën e parandalimit dhe forcimit të shëndetit, monitorimin e mjedisit si dhe evidenton faktorët riskant të tyre mbi shëndetin në komunitet. Shëndeti Publik pais studentët më njohuri të organizimit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, strukturat funksionuese të realizimit të shërbimit infemieristik bashkëkohor dhe konceptet e bazë të Shëndetit Publik.

**INF 130 Anatomi Normale:** Anatomia është shkenca që studion trupin e njeriut nga forma dhe ndërtimi. Anatomi Normale 1 trajton aparatën kockor, aparatën lidhës të kockave si dhe aparatën muskular. Anatomi Normale 2 trajton organet sipas sistemeve: sistemi respirator, sistemi digjestiv, kardiovaskular, limfatik, urinar dhe sistemi nervor.

**INF 140 Shkencat Paraklinike:** Objekti I Histologjisë është studimi në nivel mikroskopik I indeve që përbëjnë organizmin e njeriut. Objekti I Fiziologjisë është studimi I funksioneve normale të të gjithë sistemeve dhe organeve të njeriut për të bërë të mundur diferencimin midis normale dhe patologjikes më vonë.

**INF 150 Diagnostikë Klinike:** Mikrobiologjia është shkenca që merret me studimin e mikroorganizmave, strukturën e tyre si dhe sëmundjen që shkaktojnë në popullatë. Biokimia Mjekësore është degë e Biokimisë së përgjithshme e cila studion strukturën dhe proceset e shndërrimit të lëndëve që ndërtojnë organizmin e

njeriut.

**INF 160 Infemrieristikë e Përgjithshme, Praktikë Infermierore:** Infermieristika është një lëndë formuese profesionale. Bazuar në tematikën komplekse që shtjellohen në të si procedurat e emergjencës, principet shkencore, dokumentacioni infermieror, teknikat infermiere, Në këtë modul futet edhe praktika infermiere e cila në vitin e parë synon t'i njohë studentët me organizimin shëndetësor në komunitet për të kaluar në vitin pasardhës në shërbimin spitalor.

**INF 220 Kirurgji dhe Infermieristikë Klinike e Aplikuar:** Kirurgjia e përgjithshme bazohet në organizimin e punës në kirurgjinë ambulatorë dhe spitalore, parimet kryesore të asepsisë dhe antisepsisë, problemet immediate të përgjithshme si djegiet dhe traumat pa hyrë në pjesën speciale. Kirurgjia speciale ka për qëllim të përgatisë student në kujdesjet në patologjitë e ndryshme kirurgjikale.

**INF 230 Obstetrikë - Gjinekologji dhe Infermieristikë, Klinike e Aplikuar:** Obstetrikë - Gjinekologji I: trajton kujdesin gjatë shtatzanisë, taktikat që duhet ndjekur në periudhat e ndryshme të aktivitetit të lindjes. Obstetrikë - Gjinekologji II ka për objekt shtatzaninë, problemet që e shoqërojnë si dhe qëndrimin që duhet mbajtur në këto raste.

**INF 240 Terapi Intesive:** Neurologjia synon t'i japë studentit konceptet themelore të patologjive organike të sistemit nervor si dhe kujdesin infermieror në këto raste. Psikiatria jep konceptet themelore të sëmundjeve psikike, trajtimin e tyre si dhe kujdesin infermieror për të pasur një shëndet mendor të mirë në popullatë.

**INF 250 Shëndet Mendor dhe Infermieristikë Klinike e Aplikuar:** Ky modul bën pjesë në formimin profesional të studentëve të infermierisë. përbëhet nga 3 pjesë që janë: neurologjia, Psikiatria dhe infermieristika përkatëse. Neurologjia synon t'i japë studentit konceptet themelore të patologjive organike të sistemit nervor si dhe kujdesin infermieror në këto raste. Psikiatria jep konceptet themelore të sëmundjeve psikike, trajtimin e tyre si dhe kujdesin infermieror për të pasur një shëndet mendor të mirë në popullatë.

**INF 260 Ortopedi, Radiologji:** Ortopedia është një lëndë ku përfshihen nocione të vecanta për njohjen, kujdesin dhe mjekimin e pacientit të traumatizuar në aksidentet automobilistike si dhe patologjitë ortopedike të lindura. Radiologjia ka për qëllim të përgatisë studentët për njohjen e metodave ekzaminuese tradicionale dhe metodat e reja

**INF 270 Farmakologji, Anatomi Patologjike:** Farmakologjia është shkencë që merret me studimin e barnave dhe përbëhet nga farmakologjia e përgjithshme dhe farmakologjia speciale. Anatomia patologjike është shkencë mjekësore që studion procesin patogenetik, sëmundjet e indeve organeve sistemeve në nivelin makro dhe mikroskopik. Në lëndën e Anestezisë - reanimacion përfshihen nocione të vecanta për anestezinë e përgjithshme për kujdesin pre post operator. Traumatologjia është një lëndë ku përfshihen nocione të vecanta për njohjen, kujdesin dhe mjekimin e pacientit të traumatizua.

**INF 280 Dietetikë, Sëmundje Infektive:** Dietetika është një lëndë e edukimit profesional, objekti i saj është mënyra e të ushqyerit tek njeriu i shëndoshë për një jetë sa më aktive si dhe dietoterapia në patologji të ndryshme, Sëmundja

infektive përfshin ndihmën e përgjithshme dhe të vecantë në sëmundjet infektive në komunitet.

**INF 310 Metodologji e Kërkimit Shkencor, Geriatri:** Metodologjia e kërkimit shkencor aftëson studentët për të realizuar një projekt në kuadër të aktivitetit profesional. Geriatria Trajton patologjitë kryesore që prekin moshat e treta si dhe kujdesjet kryesore që u duhen dhënë këtyre patologjive.

**INF 320 Sëmundje Brendshme dhe Infermieristikë Klinike:** Sëmundje brendshme Ky modul përfshin patologjitë kryesore të kardiologjisë, pneumologjisë, reumatologjisë, alergologjisë, gastro-hepato-enterologjisë, nefrologjisë, endokrinologjisë, hematologjisë si dhe kujdesin infermior në të gjitha këto patologji.

**INF 330 Pediatri dhe Infermieristikë Klinike:** Pediatri Zhvillimi:Kjo lëndë ka për qëllim të trajtojë ecurinë dhe ndjekjen e fëmijës përgjatë zhvillimit të tij nga konceptimi deri në moshën e adultit. Pediatria patologjike:Studentët marrin njohuritë e nevojshme për patologjitë më të shpeshta të fëmijëve, sipas sistemeve dhe organeve të organizmit human, të detajuara sipas etiologjisë, klinikës, diagnozës dhe trajtimit. Neonatologjia:Në këto lende trajtohet kujdesi përreth lindjes së fëmijës:Të 3 këto pjesë shoqërohen me kujdesin infermior bazë.

**INF 340 Urgjencat Infermiore, Praktikë Profesionale:** Urgjencat infermiore Formon studentët për të përballuar situatat emergjente. Praktika profesionale zgjat 4 javë. Kryhet në ambjentet spitalore, ku studenti do të aftësohet në procedurën të ndryshme infermiore.

**INF 350 Lëndë me Zgjedhje:** Okulistika përgatit personelin infermior si të kujdeset për pacientet me patologji të syrit ORL ka për qëllim të mësojë studentëve principet bazë të sëmundjeve të veshit, grykës dhe hundës. Shëndeti paliativ ka për qëllim të japë njohuri studentëve përsa I përket kujdesit që u kushtohet pacientëve që janë në gjendje terminale. Fizioterapia është një lëndë që ka për qëllim të mësojë studentëve principet bazë të fizioterapisë, Dermatologjia është një lëndë që ka për qëllim të mësojë studentëve principet bazë të sëmundjeve të ndryshme të lëkurës.